



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti I Drejtësisë

Studime Postdiplomike-Cikli I dytë

Teza:

**“Veprat penale të vjedhjes ne territorin e Gjykatës Themelore
Dibër gjatë periudhës 2015 – 2020”**

Kandidati:

Shpati Croj

Mentor:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

Tetovë 2020

Përmbajtja:

Hyrje

Qëllimi I hullumtimit

Kapitulli I

1. Kuptimi i veprave penale të vjedhjes.
2. Disa vecori të kriminalitetit kundër pasurisë.
3. Trajtime historike të veprave penale të vjedhjes.
 - 3.1 Vjedhja sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit.
4. Karakteristikat e përgjithshme të veprave penale të vjedhjes.
 - 4.1 Objekt mbrojtës i vjedhjes.
 - 4.2 Figura ligjore e veprës penale vjedhje.
 - 4.3 Teoritë për kryerjen e veprës penale vjedhje
5. Trajtimi komperativ i veprave penale të vjedhjes.
 - 5.1 Aspekte krahasimore me Republikën e Shqipërisë.
 - 5.2 Aspekte krahasimore me Republikën e Kosovës.

Kapitulli II

1. Disa lloje të veprave penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

- 1.1 Vjedhja.
- 1.2 Vjedhja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror.
- 1.3 Vjedhja e rëndë .
- 1.4 Grabitja.
- 1.5 Vjedhja grabitqare .
- 1.6 Mashtrimi.

2. Të dhëna statistikore në lidhje me veprën penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

Kapitulli III

1. Shkaqet apo faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në veprat penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.
2. Faktorët e jashtëm.
 - 2.1 Varfëria
 - 2.2 Papunësia.
 - 2.3 Krizat dhe depresionet ekonomike.
 - 2.4 Arsimimi.
 - 2.5 Profesioni .
 - 2.6 Familja.
 - 2.7 Shkolla dhe ambienti shkollor.
 - 2.8 Mjedis social.

2.9 Bixhozi.

3. Narkomania.

4. Të dhëna hulumtuese mbi punimin, disa akgjykime nga Prokuroria Themelore Publike Dibër.

Kapitulli IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale të vjedhjes.

2. Roli i shkollës në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

3. Roli i familjes në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

4. Roli i mjeteve të informimit në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

5. Roli i organizatave joqeveritare në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

6. Roli i Policisë në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

7. Roli i Prokurorisë në parandalimin e veprave penale të vjedhjes

8. Roli i gjykatës në parandalimin e veprave të vjedhjes.

9. Të dhëna hulumtuese mbi punimin, statistika të mara nga enti shtetëror për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Hyrje:

Në këtë tezë të magistraturës do të hulumtohet për një ndër format më të përhapura të kriminalitetit sic është vepra penale e vjedhjes. Domethënë do të studiohet një çështje konkrete dhe e nevojshme për opinionin publik. Veprat penale të vjedhjes janë veprat që paraqiten dhe trajtohen më së shpeshti në praktikën e gjykatës themelore Dibër.

Do të mundohem të jap një sqarim se çfarë janë veprat penale kundër pasurisë, llojet e këtyre veprave, do të analizohen karakteristikat dhe vecorit kryesore të veprave penale të vjedhjes në përgjithësi, dhe në rajonin e Dibrës në veçanti. Do sqarohet objekti mbrojtës, figura ligjore, teoritë për kryerjen e këtyre veprave, do të behet një trajtim komperativ për veprat penale të vjedhjes, do analizohen ngjajshmëtirë dhe dallimet me vendet fqinje si Republika e Shqipërisë dhe Kosovës. Në kapitullin e dytë do sqarohet dhe do paraqiten dhe do analizohen statistika reale në lidhje me veprat penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës të mara nga prokuroria themelore publike Dibër. Në kapitullin e tretë do të analizohen shkaqet apo faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në kryerjen e veprave penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës, do paraqiten dhe do analizohen dy aktgjykime dhe një aktvendim në lidhje me veprat penale të vjedhjes në Dibër. Në kapitullin e katër do sqarohen faktorët që ndikojnë në parandalimin e kryerjes së veprave penale të vjedhjes, masat preventive dhe represive, dhe do paraqiten të dhëna hulumtuese mbi punimin për këto vepra penale.

Qëllimi i hulumtimit

Është një çështje konkrete dhe e nevojshme për opinionin publik dhe është një vepër penale e theksuar, me nje numer jashtëzakonisht të madh të kryerësve, e rezikshme, që nuk është shuar asnjëherë deri sot e kësaj dite kjo është edhe arsyeja që më ka bërë ti qasem këtij studimi. Çdo shoqëri që posedon strukturë të mirëfilltë juridike demokratike dhe rend qytetar e ka obligim që t'i studiojë dukuritë negative që e kërcënojnë rendin dhe qetësinë, në mënyrë që ta bëjë vlerësimin real të gjendjes së tyre. Këtu fillon rëndësia dhe nevoja e këtij studimi . Sepse rritja e dukurive negative në shoqëri, e po ashtu edhe rritja e rasteve të veprës penale, “vjedhje”, i kërcënon vetë qytetarët pa përjashtime , sigurinë e tyre, pasurinë e tyre e të cilët në të njëjtën kohë, humbin edhe besueshmërinë në institucionet e shtetit apo te të ashtuquajturat organe të judikaturës.

Në kuadër të mbrojtjes juridike të pasurisë, mbrojtja juridike penale pa dyshim paraqet vetëm një pjesë të saj, por specifike dhe shumë të rëndësishme, se pa mbrojtjen juridike penale nuk mund të mendohet mbrojtja efikase dhe efektive e pasurisë.

Në kryerjen e kësaj vepre kanë ndikuar faktorët e ndryshëm, siç janë: papunësia në shkallë të madhe, mungesa e vetëdijesimit, përgatitja e ulët arsimore, kushtet e vështira ekonomike etj. Për këtë arsye, edhe sanksionet e parapara për veprat e tilla penale kanë për qëllim rehabilitimin dhe krijimin e kushteve jetësore, nëpërmjet të cilave, kryerësve të veprës penale, u mundësohet rehabilitim dhe risocializim, duke synuar rritjen e vetëdijes për t'i respektuar ligjet në fuqi.

Kapitulli I

1.Kuptimi i veprave penale të vjedhjes

Vepra penale e vjedhjes përkufizohet si marrje e pasurisë së huaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj për vete apo personin tjetër.¹ Në këtë mënyrë bëhet përkufizimi i përgjithshëm i vjedhjes, i cili përfshinë të gjitha elementet të cilat janë të përbashkëta për të gjitha format e kësaj vepre penale: veprimi i marrjes, sendi i huaj i luajtshëm si objekt i veprimit dhe qëllimi i kryerësit të veprimit që për vete apo personin tjetër të përvetësojë dobinë pasurore të kundërligjshme.

Vjedhja është një ndër veprat penale kundër pasurisë së personave fizik dhe juridik, e njohur historikisht në vende të ndryshme të botës dhe e përhapur kudo. Vepra konsiderohet se është kryer kur ndokush i'a merr tjetrit sendin e huaj të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë atë. Për këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë apo dënim me burgim deri në 3 vjet.²

Me kriminalitet kundër pasurisë nënkuptohen të gjitha veprimet që çenojnë dhe rezikojnë pasurinë private dhe shtetërore, në kodet penale të vendeve të ndryshme numërohen disa vepra penale e krime kundër pasurisë, por si vepra penale më të njohura gati në të gjitha kodet penale bashkëkohorë numërohen: vjedhjet e imta, vjedhjet e zakonshme, vjedhjet e rënda, vjedhjet me grabitje, vjedhjet me thyerje, fshehja e tatimeve, plackitja, vjedhja e automjeteve, marrja e gjësendeve të huaja, mashtrimi, keqpërdorimi i besimit fshehja etj.³

Mbrojtja e të drejtave pronësore më së shumti realizohen nëpërmes masave të së drejtës pronësore dhe ekonomike, ndërsa aplikimi i sanksioneve penale vetëm kur deri te cenimi apo rrezikimi ka arrit me përdorimin e dhunës, kërcënimit, mashtrimit, shtrëngimit, shantazhit ose veprimeve tjera shoqërisht të rrezikshme. Për këtë arsye në literaturën juridike shpesh theksohet se mbrojtja penalo-juridike e pronësisë ka karakter subsidiar. Po ashtu, theksohet se kjo mbrojtje është e kufizuar, sepse kryesisht ka të bëjë me cenimin e të drejtave pronësore të sendeve të luajtshme, e më pak me ato të paluajtshme, dhe për shkak se këto vepra penale më së shumti kryhen me dashje e shumë më rrallë nga pakujdesia.

Pa marrë parasysh në kufizimin e mbrojtjes penalo-juridike rëndësia e saj është e pa kontestueshme. Pa mbrojtjen penalo-juridike nuk mund të mendohet mbrojtja efikase e pasurisë dhe të drejtave të saja. Për këtë dëshmon numri i madh i këtyre veprave penale të parapara në të gjitha legjislacione penale të vendeve tjera.

Për të kuptuar më mirë nocionin dhe figurën e veprave penale kundër pasurisë, është oportune të përcaktohet nocioni i "pasurisë" si objekt i përgjithshëm mbrojtës i këtij kapitulli. Pasuria mund të përcaktohet më së thjeshti si tërësi e të drejtave të cilat i takojnë një personi për një send, vlera e të cilit mund të shprehet në të holla. Pasurisë i takojnë vetëm të drejtat, ndërsa sendet dhe të hollat mund të paraqiten vetëm si sende të asaj të drejte, do të thotë hyjnë në masën e të drejtave. Pasuria nuk është vetëm juridike por edhe ekonomike dhe kategori e kontabilitetit, për çka jo vetëm në gjuhën laike por edhe në gjuhën juridike-profesionale,

¹ Vesel Latifi Kriminalistika Prishtinë 2011 fq 429, 430

² Zejneli, Ismail, E DREJTA PENALE- PJESA E POSAÇME, Tetovë, 2007, fq.112

³ Ragip Halili Kriminologjia Prishtinë 2011 fq. 205.

ngatërrohen kuptimet e ndryshme të pasurisë, e që shkaktohet një huti në literaturë dhe legjislacion. Me pasuri në kuptimin ekonomik përcaktohet tërësia e të mirave të cilat i takojnë një subjekti. Pasuria si kategori juridike është tërësia e të drejtave pronësore të përfaqësuara me një bartës të këtyre të drejtave. Ky nocion nuk përfshin as sendet as veprimet. Sendet hyjnë në pasuri në formë të drejtave të cilat subjekti i caktuar i ka mbi sendet ndaj subjektit tjetër. Pasuria përfshinë vetëm tërësinë e të drejtave subjektive të të drejtës pronësore të një bartësi. Nga nocioni i pasurisë janë përjashtuar të gjitha ato të drejta subjektive të cilat nuk kanë karakter të pasurisë (p.sh. e drejta e votës). Sipas qëndrimeve të kaluara, pasuria si kategori e kontabilitetit është tërësia e të drejtave subjektive dhe detyrimeve të përfaqësuara nga një bartës. Përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet- (shih Vedris- Klaric, faqe 77- 79). Pronësia është tërësi e të drejtave që i takojnë një personi. Të gjitha të drejtat të cilat e përbëjnë pasurinë kanë të bëjnë me sendin, në fund do të thotë, të mira ekonomike.⁴

2. Disa vecori të kriminalitetit kundër pasurisë.

Kriminaliteti kundër pasurisë, për nga vëllimi dhe format e paraqitjes zë vendin e parë në shumë shtete, e veçmas në ato të zhvilluara. Të dhënat statistikore mbi ecuritë e krimit në tërë botën, tregojnë se numri i paraqitur, numri i akuzuar dhe numri i gjykuar i personave për këto krime është shumë më i madh se për disa lloje tjera të krimeve. Të dhënat e tilla në disa shtete të zhvilluara si: Anglia, SHBA, Gjermania etj, tregojnë se këtij kriminaliteti i afrohet vetëm kriminaliteti në trafik ose në komunikacion. Këtë kriminalitet e cilëson pjesëmarrja e lartë në numrin e përgjithshëm të kryerësve dhe krimeve në statistikat kriminale të shumë vendeve. Kjo pjesëmarrje, sipas Singerit, në kriminalitetin e përgjithshëm sillet rreth 60%.⁵ Sipas kërkimeve kriminologjike, fëmijët dhe të miturit marrin pjesë në, 45,7% të të gjitha rasteve të paraqitura për këto krime. Te disa raste, pjesëmarrja e tyre është edhe më e madhe, p.sh. te krimet e vjedhjes së zakonshme, vjedhjes së imët, vjedhjes nëpër shitore, vjedhjes së automobilave ajo arrin deri në 50%. Moshë më e vjetër e kryerësve të këtyre krimeve sillet prej 20-25 vjet. Ajo moshë merr pjesë më tepër në kryerjen e disa krimeve të tjera kundër pasurisë, p.sh. në vjedhje të rënda, vjedhje me thyerje, vjedhjet me armë, mashtrime, në fshehjen e tatimeve, në shpërdorime etj. Femra, si kryerëse e këtyre krimeve, paraqitet më tepër te disa vjedhje të imta, mashtrime, vjedhje të zakonshme e më pak te krimet e vjedhjeve të rënda, vjedhjeve me armë apo plaçkitjeve. Pjesëmarrja e femrës në kryerjen e këtyre krimeve sillet në lartësi afër 10 % të të gjithë personave të dënuar për këto krime.⁶ Sipas konstatimeve në literaturë, edhe përsëritja, respektivisht recidivizmi, është shumë i shprehur. Në këtë drejtim, dallohet një lloj i profesionalizimit dhe specializimit të kryerësve në kryerjen e krimeve të caktuara kundër pasurisë. Për shumë kriminelë dhe delikuentë, marrja me aktivitete kriminale kundër pasurisë paraqet një përcaktim të përhershëm në punën e tyre dhe burim kryesor të të ardhurave. Në kryerjen e krimeve kundër pasurisë, gjithashtu vërehet një organizim i kryerësve shumë më i madh se sa te rastet e krimeve të tjera. Kështu, fiitet për

⁴ Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS fq.889

⁵ M.Singer, vep e cit. fq. 495-496 Halili Ragip Kriminologjia Prishtinë 2011, fq.206.

⁶ M.Singer,vep. e cit. fq. 507-508

grupe dhe për rrjeta të organizatave regjionale, dhe ndërkombëtare, të cilat mirren në mënyrë profesionale me vjedhje, grabitje, transport dhe shitje nëpër shtetet e ndryshme, si vjedhja e transporti i automobilave dhe shitja e tyre nëpër vende tjera, vjedhja e eksponateve dhe vlerave artistike dhe shitja në vendet tjera, dhe shumë veprime të tjera të ngjajshme, kur mallërat vidhen në një vend ndërsa transportohen në vend tjetër dhe shiten në një vend të tretë. Gjithashtu, këtë kriminalitet e cilëson edhe prania e numrit të errët. Numri i krimeve kundër pasurisë, të kryera nga persona të panjohur, në shumë vende sillet prej 50 deri 70 %, çka nuk është rast me asnjë lloj apo forme të kriminalitetit tjetër. Nëse vështrohen pasqyrat e paraqitjes së këtij kriminaliteti nëpër disa shtete, do të hetohen disa veçori të ngjajshme. Në rend të parë, këto ngjashmëri kanë të bëjnë me vëllimin apo numrin e madh të pranisë së tij. Sipas kriminologut gjerman Kaiser, në Gjermani, gjatë viteve '90, nga të gjithë personat e dënuar në atë shtet, 37% kanë qenë për krime kundër pasurisë. Nga 4.455.333 krime të regjistruara nga ana e policisë në Gjermani, 2/3 kanë qenë krime të vjedhjes së pasurisë. Nga të gjitha krimet kundër pasurisë, vjedhjet e rënda marrin pjesë në 34,7%, vjedhjet e zakonshme me 25,8%. Krimet kundër pasurisë në Gjermani, tregojnë një trend të rritjes së vazhdueshme. Gjatë periudhës 1955 - 1977, shikuar për nga numri i personave të gjykuar për krime kundër pasurisë, ky numër është rritur për 273%, ndërsa vetëm krimi i vjedhjes së zakonshme është rritur për 131%, ndërsa krimi i vjedhjes së rëndë për 731%⁷. Sipas kriminologut amerikan Glick, gjatë vitit 1992 në SHBA janë regjistruar 12 milionë e 500 mijë, raste të krimeve kundër pasurisë. Nga kjo del se në 100.000 banorë në këtë shtet marrin pjesë 4.903 raste të krimeve kundër pasurisë. Krimet e vjedhjes, në kuadër të krimeve kundër pasurisë, marrin pjesë me 63%, vjedhjet me thyerje me 24%, vjedhje tjera me 13%. Po sipas këtyre burimeve, dëmet e shkaktuara nga krimet kundër pasurisë në këtë vit, arrijnë në 15 miliardë e 200 milionë dollarë.⁸ Në Zvicër, kriminaliteti kundër pasurisë dhe deliktet kundër pronës, në përgjithësi, në krahasim me Gjermaninë dhe vendet e tjera, nuk janë në rritje të madhe. Gjatë vitit 1990 janë evidentuar 220865 raste të krimeve kundër pasurisë, prej tyre, 14285 raste kanë qenë vjedhje të ndryshme, ndërsa 2477 raste kanë qenë huazime ose vjedhje të automobilave. Për këto krime janë dënuar gjithsej 245 persona. Siç shihet, është një numër shumë i ulët në krahasim me shtete tjera. Mirëpo, kjo pasqyrë e kriminalitetit kundër pasurisë, nuk është reale, ngase sipas dispozitave ligjore pozitive zvicerane për krime të vjedhjeve, vlera e të cilave nuk kalon shumë e 500 frangave, nuk mbahen evidenca qendrore dhe ato nuk janë të përfshira në shënimet statistikore mbi kriminalitetin në atë vend. Me të drejtë dyshohet se në atë vend, këto krime janë shumë më të përhapura se sa pasqyrohen në statistikat tilla kriminale. Në Austri, në vitin 1990 janë evidentuar 320596 raste të njohura të krimeve në përgjithësi. Nga ky numër, 77,4% janë krime kundër pasurisë. Krimi në Kosovë gjatë vitit 2003 për vepra penale kundër pasurisë janë dënuar 904 persona, prej tyre për vjedhje të zakonshme 253, për vjedhje të rënda 469, për mashtrime 67 etj.⁹

⁷ G.Kaiser vep. e cit. fq.367-368

⁸ L.Glick vep e cit fq.258-259

⁹ Halili Ragip Kriminologjia, Prishtinë 2011 fq.206-207.

3. Trajtime historike të veprave penale të vjedhjes.

Vjedhja është delikt më i vjetër i së drejtës civile i njohur qysh nga e drejta romake me termin *furtum*. Vjedhja, apo *furtum* në të drejtën romake ishte delikt, që do të thoshte cënim i pasurisë së huaj, krahas nxjerrjes së njëkohshme të dobisë për delikuentin.¹⁰

Krimet kundër pasurisë janë të njohura që nga kohërat më të lashta. Këto krime bëjnë pjesë në kriminalitetin klasik. Mirëpo kjo nuk do të thotë se format e paraqitjes së disa krimeve nuk kanë pësuar ndryshime dhe se nuk janë lajmëruar forma të reja. Fjala vjen thuhet se me zhvillimin e teknikës, elektronikës, pajisjeve më të reja elektronike e kompjuterike dhe përsosjes së industrisë bashkëkohore e veçmas asaj automobilistike, telefonisë, kompjuterëve dhe teknikës më të re të sofistikuar, është mundësuar që krimet kundër pasurisë të kryhen më shpejtë dhe të vështirësohet zbulimi i kryerësve të tyre. Paraqitja e automobilit ka ndikuar në shtimin e një vargu krimesh kundër pasurisë si vjedhjeve, rrëmbimeve, vjedhjeve nëpër shtëpi mallrash, banka dhe vjedhja e vetë automobilave. Pastaj paraqitja e kompjuterëve dhe internetit ka nxitur forma të reja të vjedhjeve që më parë nuk kanë mundur të paramendohen pra në raport me veprat penale, të cilat janë kryer në të kaluarën, veprat e sotme penale, kryesisht dallohen sipas mënyrës, formës dhe teknikës së kryerjes.

Mbrojtja juridike penale e pronës private, daton që nga koha e lindjes së shtetit dhe së drejtës. Sot vjedhjet, mashtrimet dhe veprat të tjera kryhen shpeshherë përmes futjes, fshirjes apo ndryshimit të të dhënave kompjuterike, apo programeve dhe mënyrave tjera të ndikimit në rezultatet e procedimit të përpunimit elektronik të të dhënave përmes të cilave kryhen dobi pasurore të kundërligjshme jashtëzakonisht të mëdha.¹¹

3.1 Vjedhja sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në historinë e kombit Shqiptar, Kanuni është konsideruar “kushtetutë” ku sipas rregullave dhe ligjeve të tij është zhvilluar jeta në viset shqiptare vecanërisht malore.

Kanuni ka pasur një rol tejet të rëndësishëm që nga koha e Skënderbeut, Kanuni përmban rregullat e atëhershme të mënyrës së jetesës dhe ligjeve që hynin në përdorim për të vënë rëgull në shoqërinë shqiptare të asaj kohe.

Sikurse tek e drejta moderne – pozitive që nuk e barazon të mirën juridike të pasurisë që është rrezikuar me atë të shendetit dhe jetës së njeriut, pasi që jeta e njeriut rangohet në nivelin më të lartë të të mirave juridike të mbrojtura në secilen kushtetutë dhe kod penal bashkëkohor, ashtu ishte e definuar parimisht edhe sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit Prandaj, që në fillim duhet përmendur parimin kanunor, se dëmi sipas Nenit 735 të KLD ka çmim, por jo edhe gjobë.

E drejta penale zakonore shqiptare mbron pronën private dhe atë të bashkësisë shoqërore. Krimet kundër pronës në KLD radhiten në vjedhje, grabitje – pretë dhe dëmtimi.¹²

¹⁰ Salihu, Ismet, E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009, fq. 339.

¹¹ Halili Ragip Kriminologjia Prishtinë 2011 fq.206

¹² <https://ëëë.kultplus.com/tag/kanuni-i-leke-dukagjinit/>

Definicioni i vjedhjes dhe i grabitjes sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit :

Vjedhja: Vjedhja sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit ishte vepra penale kryesore e drejtuar kundër pasurisë. Subjekti kryesor në vjedhje ishte cubi (cubi=hajni vjedhësi), simahorët ishin (bashkëpunëtorët), bukëdhënësit (ajo shtëpi ku kishin ngrënë ose kishin marrë bukë hajdutët) si dhe kjori (ai që fshehte mallin e vjedhur dhe vlente thënia: “baras cubi, baras kjori”

Sipas objektit të mbrojtjes ajo mund të emërtohej si vjedhje e shtëpisë, e vathit të shtëpisë, e carranikut, e kosharit të drithit, të thyemit e shtegut të oborrit, të arës, të veshtit, e stanit, e veglave bujqësore etj. Vjedhja ndodhte fshehtas e kryer nga cubi, i cili vjedhte me dorën e vet. Vjedhjet ndaheshin në: vjedhjet e thjeshta dhe në vjedhjet e rënda.

Vjedhjet e thjeshta (të rëndomta) konsideroheshin: vjedhja e bagëtisë, e shpezëve, e veglave bujqësore, e bletës etj. Pra, behej fjale zakonisht për vjedhjet që kryheshin jashtë murit (gardhit) të shtëpisë.

Vjedhjet e rënda drejtoheshin kundër pasurisë së personit por të njejtat veprime e atakonin drejtëpërdrejtë edhe nderin dhe dinjitetin e personit, familjes, fisit, fshatit ose institucionit të caktuar.).¹³

Ne Kanun vlente parimi se cdo kasollë apo ndërtesë: një, dy a shumë katëshe që ka vatër dhe qet tym, pa marrë parasysh se a është e varfër apo e pasur shtëpia është e paprekshme.

Sipas mënyrës së kryerjes – vjedhja në shtëpi karakterizohej për këto veprime:

Cubi hynte brenda oborrit pa thirr së pari me emër të zotin e shtëpisë,

Edhe pasi që nuk e shihte (përgjigjej) askush, nuk priste aty ose nuk largohej, e shtyente apo e hapte derën për të hyrë, që vepronte me dashje, për të arritur qellimin, që vetes ose personit tjetër t’i sigurojë një dobi pasurore.).¹⁴

Ndëshkimi për veprën penale të vjedhjes:, ndëshkimi mund të bëhej në dy mënyra. Ndëshkimi bazik (kompenzues) për këtë vepër të vjedhjes së shtëpisë ishte kompenzimi i dëmit të ajo familje, të ciles i takojnë sendet e humbura pas vizitës së tij kundërkannunore dy për një. Ndërsa, ndëshkimi i dytë shqiptohej për shkak të nderës së marrun. Ky ndëshkim ishte më i rëndë se i pari dhe mund të kapte shumën prej 500 groshesh gjobe (sa për një vrasje). Pra, kjo vepër mund të kryhej edhe me vetëm hyerje a thjesht qelje të derës së shtëpisë pa ftesë (përgjigje) të zotit të saj.

Pra vijmë në përfundim se sipas KLD-së nuk lejohej vrasja për vjedhje të rëndomtë, por kjo rregull nuk mund të themi se vlente edhe për vjedhjet e rënda, e sidomos për grabitjet apo edhe rrëmbimet. Pra, vjedhjet e thjeshta ndëshkoheshin sipas rregullës **dy për një**, vjedhjet e rënda ndëshkoheshin sipas rregullës dy për një dhe detyrimin e gjobes ndaj fshatit, ndërsa kur bëhej fjalë për veprat penale të grabitjes ato trajtoheshin si veprat më të rënda penale të drejtuara kundër pronës dhe njëkohsisht edhe nderit e dinjitetit të ndonjë personi, familje, fisi, bajraku apo institucioni fetar. Në këto raste përjashtimisht mund të tolerohej edhe vrasja për

¹³ https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.ordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf

¹⁴ <https://ëëë.kultplus.com/tag/kanuni-i-leke-dukagjinit/>

mbrojtjen e nderit kundër grabitçorit. Edhe pse mund të krijohej raporti i armiqësisë (hasmërisë) dhe shfaqej mundësia e borgjit të gjakmarrjes, gjaku mund të paguhej në një shumë **sa për një vrasje**, të cilën e paguante vrasësi – i dëmtuari, familja e tij, apo katundi edhe bajraku, meqë konsiderohej se ky e ka mbrojtur nderin e cenuar nga grabitësi.

4.Karakteristikat e përgjithshme të veprave penale të vjedhjes.

Si karakteristike themelore e numrit më të madh të veprave kundër pasurisë, është përvetësimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore.¹⁵

Këto janë të gjitha veprat penale, të cilat veçori konstituive kanë qëllimin e përvetësimit të dobisë pasurore të kundërligjshme. Veprat e tilla janë psh. vjedhjet, vjedhjet e rënda, vjedhjet grabitqare, shantazhi etj.

Objekt mbrojtës i këtyre veprave penale, është pasuria private dhe shtetërore, si dhe pasuria shoqërore e cila u takon personave juridik dhe e cila ende nuk është privatizuar. Si pasuri mund të konsiderohet sendi i luajtshëm i cili mund ta ndërrojë pozitën në hapësirë dhe me atë rast nuk e ndryshon gjendjen e as strukturën e brendshme¹⁶.

Te disa vepra penale kundër pasurisë marja e sendit kryhet vetëm me qëllim që ta mbajë në posedim të vetin, por pa pasur qëllim të përvetësimit.

Ekzistojnë vepra penale, te të cilat nuk ekziston asnjëri prej këtyre qëllimeve të përmedura, vetëm qëllimi i marrjes së sendit të huaj për shkak të shërbimit dhe përdorimit për qëllimet për të cilat është destinuar, në mënyrë që pas kësaj përsëri t'i kthehet pronarit të mëparshëm.

Vepra e tillë është e njohur edhe nga e drejta penale romake si shfrytëzim i kundërligjshëm i sendit pa qëllim të përvetësimit. Anën subjektive të të gjitha veprave penale kundër pasurisë e paraqet paramendimi, sepse përveç qëllimit si karakteristikë subjektive, këto vepra mund të dallohen edhe sipas disa rrethanave objektive. Kështu objekt të sulmit mund të renditen në dy grupe:vepra kundër sendeve të luajtshme dhe në vepra penale kundër pasurisë në përgjithësi dhe të drejtave dhe interesave pasurore. Te të parat, veprimi i kryerjes apo sulmit, përbën rrëmbimin apo përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme (vjedhje, vjedhje e rëndë, vjedhje grabitqare, grabitje etj). Derisa te veprimet të tjera, kryerja paraqitet në forma të tjera siç janë:mashtrimi, mashtrimi me subvencionet, keqpërdorimi i sigurimit, shantazhi, keqpërdorimi i besimit, dëmtimi i të drejtave të personit tjetër etj.

Në rastet e ekzistimit të dëmeve të vogla, krahas ekzistimit të rrethanave tjera, vepra kualifikohet si formë e lehtë, e privilegjuar, e shpërdorimit apo mashtrimit. Veprat penale kundër pasurisë, konsiderohen forma të rënda, të kualifikuara në rastet kur kryhet me dhunë apo me kanosje, duke përdorur armë apo mjete të rrezikshme, duke vepruar posaçërisht në

¹⁵ Sahiti Ejupi&Ismail Zejneli, “ E Drejta e Procedurës Penale e Republikës sëKosoves”Prishtinë, 2017

¹⁶ Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS fq.890

mënyrë të rrezikshme dhe të vrazhdë etj.¹⁷

Vepra penale e vjedhjes mund të kryhet edhe me urdhër të eprorit qoftë ushtarak ose civil, kryesi nuk lirohet nga përgjegjësia penale, përveç kur personi ka qenë i detyruar ligjërisht që t'i bindet urdhrorit të tillë, ose personi nuk e ka ditur se urdhri i tillë ka qenë i paligjshëm, dhe urdhri i tillë nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm që ndodhe ne vendin tone si Mashtrimi, Mashtrimi per sherbime komunale etj.¹⁸

Vepra penale e vjedhjes mund të kryhet edhe në bashkëpunim si bashkëkryreja, shtytja, ndihma, bashkim kriminal. Kjo vepër mundet të ndodhë edhe në tentativë kur kemi të bëjmë me këdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, vepër penale e mbetur në tentativë.¹⁹

Kryerës i veprës penale të vjedhjes mund të jetë çdo person pa marrë parasysh moshën, i riu, madhori, i moshuari etj. Shkaqet janë të shumta si objektive subjektive etj. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje. Dashja direkte duhet të përfshijë se kryerësi është i vetëdijshëm se sendi i luajtshëm është i personit tjetër dhe se sendi merret nga poseduesi i atij sendi. Është e nevojshme të ekzistojë dashja speciale për përvetësim të kundërligjshëm të sendit të luajtshëm. Nëse kryerësi gjendet në lajthimin e pa mënjeluar duke menduar se sendi është në pronësinë e tij, se sendin e ka gjetur, se i është besuar, është përjashtuar ekzistimi i kësaj vepre penale.²⁰

4.1 Objekt mbrojtës i vjedhjes.

Objekti mbrojtës i kësaj vepre penale është pasuria e luajtshme. Objekti i vjedhjes duhet të jetë i "huaj" i luajtshëm për të ekzistuar kjo vepër penale, do të thotë se vetëm sendi (pasuria) i huaj e luajtshme i cili gjendet në pronësi të personit tjetër fizik apo juridik, mbahet në bazë të ndonjë të drejte ose mbahet në mënyrë të kundërligjshme nga personi tjetër. Gjithashtu objekt i vjedhjes mund të jenë pjesët e sendeve të cilat sipas së drejtës civile konsiderohen si të paluajtshme, p.sh. një pjesë e një makine e cila mund të ndahet, sendet që gjenden në tokë (thëngjilli, gurët, etj.) dhe mbi tokë (frytet), pjesët përbërëse të shtëpive, ndërtesave (dritaret, dyert etj.)²¹

Në të drejtën penale si objekt i veprës penale konsiderohen të mirat ose vlerat vitale të njeriut, të një populli të një vendi dhe komuniteti ndërkombëtar që ketu hyjnë (jeta e njeriut, intergriteti i tij turpor, lirite dhe drejtat themelore të njeriut, qytetarit, siguria, paqja, barazia

¹⁷ [http://ëëë.igoar.com/Articles/37/Images/25-09-2015/178188 Elizabetha Imeraj VEPRAT PENALE KUNDEr PASURISE-001-013.pdf](http://ëëë.igoar.com/Articles/37/Images/25-09-2015/178188%20Elizabetha%20Imeraj%20VEPRAT%20PENALE%20KUNDEr%20PASURISE-001-013.pdf)

¹⁸ Vllado Kambovski – Ismail Zejneli E drejta Penale pjesa e përgjithshme Tetovë 2018.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS fq. 895

²¹ Po aty fq.891.

etj. Dmth veprat penale që janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura me sistemin juridik të një vendi dhe me të drejtën ndërkombëtare.²² Për ekzistimin e veprës penale nuk është e rëndësishme se sendi i luajtshëm është mënjeluar nga sendi i paluajtshëm apo është mënjeluar nga sendi i luajtshëm para kryerjes së veprës penale ose sendi është mënjeluar me rastin marrjes. Së këndejmi send nuk mund të konsiderohet ai send i cili nuk është në pushtetin e njeriut dhe as që mund të jenë në pronësi të askujt. Por, nëse ndonjë send, material mund të vihet nën kontrollin e njeriut dhe me atë të pronësohet, atëherë mund të konsiderohet si send, dhe të jetë objekt i vjedhjes, p.sh. ajri nën shtypje, uji i detit në basen, uji i shiut në cisterna, akulli i mbledhur në ftohës e edhe gjithë energjia e prodhuar apo e mbledhur që shërben për ndriçim, nxehtësi ose lëvizje.²³ Njeriu nuk mund të konsiderohet si send për deri sa është i gjallë, por pjesët e trupit (gjymtyrët) nëse ndahen nga trupi konsiderohen si send i luajtshëm dhe kanë ndonjë vlerë, atëherë mund të jenë objekt i vjedhjes, p.sh. flokët për prodhimin e parukave të cilat shiten në treg për përdorim, ndonjë gjymtyrë tjetër e cila ka ndonjë vlerë qarkulluese. Kufoma e njeriut nuk mund të konsiderohet si send po që se nuk ka ndonjë vlerë anatomike, shkencore, dhe çfarëdo vlere tjetër lidhur me transplantimin ose të ndonjë vlere tjetër pronësore, p.sh. marrja e veshkave, zemrës, dhëmbëve të veshur me ar, argjend, proteza të syrit e sende tjera të vendosura në organizmin e njeriut mund të jenë sende të vjedhjes. Posaçërisht, sendet e vjedhjes mund të jenë rrobat dhe sendet tjera me vlerë të cilat gjenden në trup dhe me kufomën ngase ato janë pronë e trashëgimtarëve e nëse nuk ka trashëgimtar janë pronë shoqërore- komunale konform me dispozitat e ligjit mbi trashëgiminë. Është qëndrim juridik se sendet e kufomës në varr janë objekt vjedhjes ngase nuk janë të hedhura të lëna pas dore, por janë sende të trashëgimtarit dhe janë në detencionin e tij, e nëse trashëgimtari vdes sendet kalojnë në pronë shoqërore. Me shprehjen detencion nënkuptojmë mbajtjen e sendit me dashje.

Objekt i vjedhjes mund të jenë edhe dokumentet e ndryshme në bazë të cilave mund të fitohen të drejta pronësore (vërtetimi për dhënien e sendit në ruajtje në gardërobë, për pastrim kimik, për transport-lista përcjellëse, listë-ngarkesa etj).²⁴

Pastaj edhe letrat me vlerë mund të jenë objekt i kësaj vepre penale, p.sh. çeku, librezja e kursimit, fletë-obligimi mbi huanë, kambiali, biletat e ndryshme sportive apo të artit që kanë vlerë etj. Nga gjithë kjo që thuhet rrjedhë se shprehja “pasuri e luajtshme” ndoshta është shprehja më adekuate e përdorur në figurën e kësaj vepre penale.²⁵

Sendi i humbur parimisht nuk mund të jetë objekt i veprës penale të vjedhjes, sepse ai më nuk është në mbajtje të personit i cili e ka humbur atë send.

Nëse sendi humbet në objekte të mbyllura sikurse janë; banesa, kinemaja, teatri, shitorja etj. e nëse kryerësi e dinë se i kujt ishte atëherë sendi është objekt i kësaj vepre penale e nëse nuk e dinë atëherë kemi të bëjmë me një vepër tjetër penale. Sendet e harruara, të lëna anash, të fshehura mund të jenë objekt i veprës penale të vjedhjes, ngase në

²² E drejta penal e përgjithshme. Prof, Ismet Salihu, botimi i katërt 2010, Prishtinë.

²³ Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS fq. 891.

²⁴ Po aty fq. 891.

²⁵ Po aty fq. 891.

këto raste konsiderohet se mbajtja e pushtetit faktik nuk ka pushuar për deri sa nuk konsiderohet se ai pushtet më nuk mund të vendoset mbi sendin e luajtshëm dhe sendi konsiderohet i humbur. Andaj, për të qenë sendi i luajtshëm objekt i kësaj vepre penale, ai duhet të jetë në mbajtje (detencion) të personit tjetër pa marr parasysh se ekziston ndonjë bazë juridike për mbajtje apo nuk ekziston ose në çfarë mënyre ka arrit deri te mbajtja, e për t'u marr sendi dhe vjedhë, ai send duhet të jetë në pronësi të dikujt. Kështu, sendi mund të jetë në mbajtje tek personi i cili deri te sendi ka ardhur me vepër penale, p.sh. me vjedhje, grabitje, mashtrim etj. Pra, vepra penale e vjedhjes ekziston edhe atëherë kur sendi vidhet nga vjedhësi-stërvidhet. Sendi mund të vidhet nga personi i cili atë e ka në pushtetin faktik, pa marr parasysh bazën juridike për ta pasur pushtetin faktik mbi atë send.²⁶

4.2 Figura ligjore e veprës penale vjedhje.

Nocioni i figures ligjore përfshin veçoritë ligjore me të cilat vepra penale përcaktohet si etnitet i posaçëm dhe dallohet nga veprat e tjera penale²⁷. Figurën ligjore e përbëjnë veçoritë e drejtuara rreth shkeljes të së mirës juridike.

Figura ligjore i konkretizon elementet e përgjithshme të nocionit të veprës penale sipas kriterit vlerësues të shkeljes së normës konkrete, respektivisht të së mirës juridike në mbrojtjen e së ciles është vendosur ajo. Funkzioni themelor i figurës ligjore është që ta definojë të padrejtën objektive materiale të veprës penale, ashtu që e njëjta nuk i përfshin elementet e fajit, i cili është element i posaçëm subjektiv i veprës penale.

Elementët objektivë dhe subjektivë përbërës të figurës së veprës penale janë katër: objekti i figurës së veprës penale, - ana objektive e figurës së veprës penale, - subjekti i figurës së veprës penale, - ana subjektive e figurës së veprës penale.²⁸

Kur thuhet figurë e veprës penale, duhet kuptuar se ndodhemi para një vepre penale konkrete, me elementë objektivë dhe subjektivë (të gjithë bashkë apo vetëm njëri apo disa prej tyre), të veçantë nga elementët objektivë dhe subjektivë (të gjitha bashkë apo vetëm njëri apo disa prej tyre), të cilat u përkasin veprave të tjera penale, qoftë edhe brenda të të njëjtit lloj apo kategorie²⁹. Për të përcaktuar llojin konkret të figurës së krimit të vjedhjes dhe mandej, për të gjetur dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën ajo parashikohet duhet të zbulojmë dhe përcaktojmë edhe elementët e veçantë të vetë elementëve (kryesisht të anës objektive para të cilave ndodhemi rast pas rasti). Element të tillë janë për shëmbull, **vendi** p.sh.(vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit, vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike) ; **mënyra** (vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën) dhe **mjeti** p.sh. (vjedhja me armë).³⁰

²⁶ Po aty fq 892-893.

²⁷ Vllado Kamblovski – Ismail Zejneli. E drejta Penale pjesa e përgjithshme Tetovë 2018 fq.97.

²⁸ Po aty fq.97.

²⁹ E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982, fq.79.

³⁰ Vllado Kamblovski – Ismail Zejneli. E drejta Penale pjesa e përgjithshme Tetovë 2018 fq.97 98 99

Edhe pse të gjitha këto lloje të ndryshme të veprave penale të vjedhjes kanë të përbashkët, shtënien në dorë në mënyrë të kundraligjshme, të fshehtë apo të hapur, të pasurisë së tjetrit, me qëllim për të nxjerrë prej saj përfitime materiale, për vete ose për persona të tjerë, (pra elementët e përgjithshëm: veprimin, rrezikshmërinë, kundraligjshmërinë dhe fajin i kanë krejtësisht të njëjtë). Por ato dallohen nga njëra tjetra, për shkak të dallimit që ekziston në tipare apo karakteristika të veçanta. Tipare apo karakteristika të tilla janë për shëmbull: karakteristika “vend” në veprat penale të vjedhjes, përkatësisht vjedhja në banka dhe në arkat e kursimit, si dhe vjedhja nëpërmjet lidhjes së paligjshme në rrjetin e energjisë elektrike, karakteristike kjo nga e cila përcaktohet edhe objekti i drejtpërdrejtë i secilës prej këtyre dy figurave të veçanta, të ndryshme nga njëra tjetra, (të të njëjtit lloj veprave penale, të veprës penale të vjedhjes së pasurisë). Po kështu, mënyra e përdorur për të realizuar vjedhjen e pasurisë, në vjedhjen e kryer duke shpërdoruar detyrën dhe vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune, shërben si karakteristike dalluese për ligjvënësin për të bërë veçimin e njërit lloj të vjedhjes së pasurisë, si më sipër, nga llojet e tjerë të krimit të vjedhjes së pasurisë. Po kështu, edhe mjete apo dhe pasoja që përkatësisht përdoret ose vjen gjatë vjedhjes së pasurisë. Në veprën penale të vjedhjes së pasurisë (Vjedhja me armë), mjete i shoqërimit të vjedhjes (me mbajtjen e armës apo përdorimin e saj), është karakteristika e cila e bën më specifike si figurë veprave penale, që e veçon atë nga llojet e tjera të vjedhjes së pasurisë.³¹

4.3 Teoritë për kryerjen e veprës penale vjedhje.

Vjedhja konsiderohet e kryer, atëherë kur pasuria e luajtshme merret dhe mbi të vihet pushteti faktik. Lidhur me këtë, në të drejtën penale ekzistojnë disa teori: teoria aprehenzis; teoria e ablacionit (lat. Ablatio); teoria ilacis (lat. Ilatio) dhe teoria Kontrektionit (lat. Contrectatio).

Teoria **aprehenzis** ka të bëjë me marrjen e sendit. Sipas kësaj teorie nuk është e domosdoshme që sendi i luajtshëm të nxirret jashtë hapësirës së mbyllur. Mjafton që sendi të ndahet nga sendet tjera (të vihet në xhep, valixhe, karrocë, etj.) Sipas teorisë së **ablacionit** ka të bëjë me bartjen e sendit të vjedhur nga vendi i vjedhjes. Kjo teori nuk është përvetësuar për shkak të zgjatjes kohore të momentit të kryerjes së veprës. Sipas teorisë **ilacio** do të thotë përgatitje- fshehje e sendit të vjedhur. Edhe kjo teori nuk është e pranishme për shkak të zgjatjes së tepruar të momentit të kryerjes së veprës penale. Sipas teorisë së **kontrektionit** do të thotë prekje e sendit që ka kuptimin se vepra do të ishte kryer në momentin e prekjes së sendit për ta vjedhë. Kjo teori nuk është përvetësuar për shkak se vetëm me prekje sendi nuk përjashtohet nga posedimi dhe kontrolli i poseduesit. Teoritë bashkëkohore dhe praktika në disa raste të caktuara, përveç teorisë së aprehenzionit, përvetëson edhe formën dhe modifikimin e saj. Pra, sot në biznesin tregtar shitja organizohet në depo të mëdha, minimarkete, markete, qendra tregtare etj. Marrja e sendit në këto qendra tregtare bëhet sipas zgjedhjes së konsumatorit. Këtu shtrohet pyetja, kur konsiderohet se është kryer vjedhja, a vetëm me aprehenzion (marrje) apo edhe me ablacion (bartje). Modifikimi i teorisë së aprehenzionit përbëhet me kombinimin e saj

³¹ Po aty.

me teorinë e ablacionit. Për t'u kryer vepra penale e vjedhjes nuk mjafton vetëm veprimi i marrjes (lat. apprehendo, preheni, prehensum-marrje, kapje, mbizotërim) së sendit të luajtshëm,³² por edhe mundësia e bartjes së tij pa pengesë (lat. Ablatus-me bartë, me marr me vete). Në këtë drejtim shkon edhe teoria gjermane e cila lejon kombinimin teorisë së aprehezionit dhe ablacionit.

Sipas teorisë së zgjeruar (aprehenzionit dhe ablacionit) vepra penale e vjedhjes nuk ka përfunduar derisa ende dentatori (mbajtësi) nuk e ka humbë posedimin mbi te, sepse sendi gjendet ende në hapësirën përkatëse (vetëshërbim) dhe ende nuk është krijuar situata për ta larguar nga ajo hapësirë pa pengesë.³³

5. Trajtimi komperativ i veprave penale të vjedhjes.

Sa i përket trajtimit komperativ të veprave penale të vjedhjes është metodë shkencore e cila i shërben organeve ligjvënëse për njohjen e legjislacioneve apo kodeve penale të vendeve apo shteteve të ndryshme.

Duke u njoftuar me zgjidhjet dhe të arrituarat progresive të shteteve të ndryshme në çështjet lidhur me krimet kundër pasurisë apo veprat penale të vjedhjes formohet platforma dhe akceptohen solucione konkrete për përgaditjen dhe nxerrjen e ligjeve apo kodeve penale në shtetin përkatës kështu është vepruar edhe në shtetin tonë Republika e Maqedonisë së Veriut, pra janë analizuar ligjet dhe kodet penale të vendeve të ndryshme dhe është nxjerrë kodi penal i cili është në fuqi mirëpo gjithmonë duke u bazuar në traditat dhe faktorët e ndryshëm të mbrendshëm të shtetit.

Pas analizës së shteteve të ndryshme perëndimore në disa raste edhe analizës së shteteve fqinje si p.sh. (Bullgaria, Shqipëria, Kosova, Greqia, Serbia etj.) përvetësohen të gjitha zgjidhjet progresive lidhur me veprat penale të vjedhjes që janë në funksion të mbrotjes më efikase të vlerave shoqërore dhe të individëve në luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij.

5.1 Aspekte krahasimore me Republikën e Shqipërisë.

Veprat penale të vjedhjes sipas kodit penal të Republikës së Shqipërisë janë inkriminuar në kreun III seksioni i parë, vjedhja e pasurisë.³⁴

Kodi penal i republikës së Shqipërisë i njuh këto lloje të vjedhjes: Vjedhja, Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën, Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit, Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike, Vjedhja e veprave të artit e kulturës, Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës, Vjedhja me dhunë, Vjedhja me armë,

³² Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS fq.894

³³ Po aty, fq. 895

³⁴ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë botim i qendrës së botimeve zyrtare Tiranë Gusht 2017 - Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995.

Vjedhja me pasojë vdekjen, Trafikimi i mjeteve motorike dhe sigurimi i mjeteve për vjedhje.³⁵ Vjedhja neni 134 -Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën neni 135 -Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit neni 136- Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se në herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike - Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, dëmtimi i matësit, si dhe çdo ndërhyrje tjetër e paligjshme dhe e paautorizuar në sistemin e matjes apo në rrjetin elektrik ose rrjetin telefonik, e kryer 93 me qëllim përfitimi të paligjshëm, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër penale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose nga përdoruesit jofamiljarë të energjisë elektrike ose të rrjetit të shërbimit telefonik, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 137/a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike - Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike dënohet me burgim deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës - Vjedhja e veprave të artit e kulturës dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Vjedhja e veprave të artit e kulturës me rëndësi kombëtare dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës - Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i veprave të artit dhe të kulturës, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. 94 Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 139 Vjedhja me dhunë - Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

³⁵ Po aty.

Neni 140 Vjedhja me armë - Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen - Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike - Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje - Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të vjedhur pasurinë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.³⁶

Gjithashtu ky kod e inkriminon edhe mashtrimin ku thuhet se Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtëri ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtrimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet. Kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet. 96 Kur vepra, ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.³⁷

Kurse sa i perket Republikës së Maqedonisë së veriut Veprat Penale kundër pasurisë janë inkriminuar në kodin penal në kreun XXIII dhe atë: Vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror, vjedhja e rëndë, grabitja, vjedhja grabitqare, fshehja, të shërbyerit, marja e sendeve të huaja, marrja e automjetit, dëmtim i sendeve të huaja, dëmtimi i të drejtave të huaja, ndërtimi i paligjshëm, dëmtimi i ndërtesave banesore dhe afariste dhe i lokaleve, të vendosurit (shpërngulja) e paligjshme, mashtrimi, mashtrimi i blerësve, mashtrimi gjatë së kredisë apo të volisë tjetër, mashtrim në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane, mashtrimi në sigurime, dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik, blerja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike, mashtrimi kompjuterik, keqpërdorimi i besimit, pranimi i paautorizuar i dhuratave, dhënia e paautorizuar e dhuratave, shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit, shkaktimi i falimentimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorimi i procedurës së falimentimit, dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve, detyrimi, shantazhi, fajdeja, fshehja, pendimi i veprës së krijuar, ndjekja për vepra në mes të afërmve. Vjedhja definohet në nenin 235 të këtij Kodi, në paragrafin 1 thuhet se Ai i cili nga tjetëri do të merr send të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë atë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

³⁶ Po aty neni 134 – 142.

³⁷ Po aty neni 143

Në paragrafin .2 thuhet se nese vlere e sendit te vjedhur eshte me vogel dhe kryeresi ka shkuar kah ajo qe ta pervetesoje sendin me asi vlere, do te denohet me gjobe ose me burgim deri ne nje vjet.

Paragrafi.3. ai i cili nga pylli i huaj dot merr drurë, sasia e të cilëve është më e madhe se një metër kub me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 4 thuhet se nëse vepra nga paragrafi 3 të këtij neni është kryer me qëllim që druri i prerë të shitet apo nëse vepra është kryer në pyje në rajone të mbrojtura, nëpyje të mbrojtura apo pyje tjera me qëllime të posacme kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.³⁸

Paragrafi 5. Tentativa për veprat nga paragrafët 1 2 3 dhe 4 është e ndëshkueshme.

Paragrafi 6. Ndjekja për veprën nga paragrafi 2 të këtij neni ndërmerret me padi private.

paragrafi 7. Nëse veprën nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.³⁹ Vërejmë se dënimi për veprën penale vjedhje është i njëjtë , do shqiptohet dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, por sic e shohim më lartë kodi jonë tek definimi i vjedhjes është pak më i zgjeruar sepse në nenin 235 paragrafi 3 e përfshin edhe vjedhjen e drunjve në pyll, gjithashtu në nenin 235 është e përfshirë edhe tentativa, edhe kryerja e kësaj vepre nga personi juridik. Nga ajo që shohim më lartë vërejmë se kemi disa dallime. Në kodin tonë, veprat penale të vjedhjes janë të përfshira në kreun XXII “ Veprat penale kundër pasurisë “ dhe këtu përfshihen edhe të shërbyerit,marja e sendeve të huaja,marrja e automjetit, dëmtim i sendeve të huaja, dëmtimi i të drejtave të huaja, ndërtimi i paligjshëm, dëmtimi i ndërtesave banesore dhe afariste dhe i lokaleve, të vendosurit (shpërngulja) e paligjshme, mashtrimi, mashtrimi i blerësve, mashtrimi gjatë së kredisë apo të volisë tjetër, mashtrim në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane, mashtrimi në sigurime, dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik, blerja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike, mashtrimi kompjuterik, keqpërdorimi i besimit, pranimi i paautorizuar i dhuratave, dhënia e paautorizuar e dhuratave, shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit, shkaktimi i falimentimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorimi i procedurës së falimentimit, dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve, detyrimi, shantazhi, fajdeja, fshehja, pendimi i veprës së krijuar, ndjekja për vepra në mes të afërmeve. Kurse kodi penal I Shqipërisë I ndan në 3 seksione seksioni I parë është vjedhja e pasurisë sic e përmendëm më lartë: vjedhja, vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën, vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit, vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike, vjedhja e veprave të artit e kulturës, trafikimi i veprave të artit dhe kulturës, vjedhja me dhunë, vjedhja me armë, vjedhja me pasojë vdekjen, trafikimi i mjeteve motorike dhe sigurimi i mjeteve për vjedhje. Në seksionin e dytë janë Mashtrimet dhe atë : Mashtrimi, Skemat mashtruese dhe piramidale,

³⁸ Afrim Osmani – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime botimi i dytë - Furkan 2015 kreu XXIII fq. 200 - 223

³⁹ Po aty.

Manipulimi i tregut, Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar, Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë, Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre, Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar, Fshehja e pronësisë, Tregtimi i paligjshëm i titujve, Mashtrimi kompjuterik, Mashtrimi në subvencione, Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar, Mashtrimi në sigurime, Mashtrimi në kredi, Mashtrimi për veprat e artit e të kultures, Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet, Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit, Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale, Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit.

Kurse në seksionin e tretë është shkatërrimi i pronës dhe atë: Shkatërrimi i pronës, Shkatërrimi i pronës me zjarr, Shkatërrimi i pronës me eksploziv, Shkatërrimi i pronës me përmblytje, Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera, Shkatërrimi i rrugëve, Shkatërrimi i rrjetit elektrik, Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes, Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit, Shkatërrimi i veprave kulturore, Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia, Përplasja e mjeteve të transportit masiv.⁴⁰

5.2 Aspekte krahasimore me Republikën e Kosovës.

Kodi penal i republikës së Kosovës i definon krimet kundër pasurisë në kapitullin XXVI dhe i njeh këto vepra penale kundër pasurisë: Vjedhja, Vjedhja e shërbimeve, Vjedhja e rëndë, Vjedhja grabitqare, Grabitja, Shpërdorimi i pasurisë së huaj, Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, Zjarrvënia, Mashtrimi, Mashtrimi me subvencione, Mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Ndërkombëtar, Keqpërdorimi i sigurimit, Hyrja në sistemet kompjuterike, Detyrimi, Shantazhi, Keqpërdorimi i besimit, Fajdeja, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër, Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, Cenimi i paprekshmërisë së mjeteve motorike, Fillimi i procedurës penale për veprat penale kundër pasurisë, Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes, Kurdisja e ndeshjes ose e sportit.⁴¹

Kurse në kodin penal të Republikës së Maqedonisë së veriut veprat Penale kundër pasurisë janë inkriminuar në kreun XXIII dhe atë: Vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror, vjedhja e rëndë, grabitja, vjedhja grabitqare, fshehja, të shërbyerit, marja e sendeve të huaja, marrja e automjetit, dëmtim i sendeve të huaja, dëmtimi i të drejtave të huaja, ndërtimi i paligjshëm, dëmtimi i ndërtesave banesore dhe afariste dhe i lokaleve, të vendosurit (shpërngulja) e paligjshme, mashtrimi, mashtrimi i blerësve, mashtrimi gjatë së kredisë apo të volisë tjetër, mashtrim në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane, mashtrimi në sigurime, dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik, blerja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike, mashtrimi kompjuterik, keqpërdorimi i besimit, pranimi i paautorizuar i dhuratave, dhënia e paautorizuar e dhuratave, shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit, shkaktimi i falimentimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorimi i procedurës

⁴⁰ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë botim i qendrës së botimeve zyrtare Tiranë Gusht 2017 - Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995. KREU III.

⁴¹ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË 1 KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS kapitulli XXVI.

së falimentimit, dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve, detyrimi, shantazhi, fajdeja, fshehja, pendimi i veprës së krijuar, ndjekja për vepra në mes të afërmve.⁴²

Kodi Penal i Kosovës vjedhjen e definon në nenin 313 vjedhja - 1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.⁴³ Sipas këtij përkufizimi ligjor, objekti mbrojtës, të vepra penale e vjedhjes është pasuria e luajtshme e personit tjetër. Pra këtu ligjdhënësi nuk e përdorë termin (sendin) por e përdorë termin pasurinë e luajtshme e cila mund të shprehet në forma të ndryshme. (përveç sendeve në formë materiale, termi pasurinë e luajtshme, për shembull mund përfshi energjinë elektrike, impulset telefonike e tjera). Edhe pse të vepra penale e vjedhjes është parapa dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri tri vjet (ligjdhënësi) e ka parapa dhe tentativën e vjedhjes, në rastet kur ndërmerret veprimi i kryerjes por nuk përfundohet ose nuk shkaktohet pasoja. Po ashtu, ligjdhënësi të vepra penale e vjedhjes ka parapa mundësin e lirimit nga dënimi në rastet kur kryerësi pasurinë e vjedhur e kthen para se të jetë njoftuar se ndaj tij ka filluar ndjekja penale.⁴⁴

Kurse Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut e definon në nenin 235 dhe atë : Ai i cili nga tjetëri do të merr send të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë atë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Në paragrafin .2 thuhet se nëse vlera e sendit të vjedhur është me vogël dhe kryerësi ka shkuar kah ajo që ta përvetësojë sendin me asi vlere, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

Paragrafi.3. ai i cili nga pylli i huaj dot merr drurë, sasia e të cilëve është më e madhe se një metër kub me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 4 thuhet se nëse vepra nga paragrafi 3 të këtij neni është kryer me qëllim që druri i prerë të shitet apo nëse vepra është kryer në pyje në rajone të mbrojtura, nëpyje të mbrojtura apo pyje tjera me qëllime të posacme kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Paragrafi 5. Tentativa për veprat nga paragrafët 1 2 3 dhe 4 është e ndëshkueshme.

Paragrafi 6. Ndjekja për veprën nga paragrafi 2 të këtij neni ndërmerret me padi private.

paragrafi 7. Nëse veprën nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.⁴⁵

⁴² Afrim Osmani – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime botimi i dytë - Furkan 2015.

⁴³ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË 1 KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS neni 313.

⁴⁴ Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

⁴⁵ Afrim Osmani – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime botimi i dytë - Furkan 2015 neni 235.

Nga ajo që shohim më lartë vërejmë se me shohim me Kodin Penal të Kosovës kemi shumë ngjajshmëri me disa dallime të vogla, kodi penal i Kosovës e definon shumën e vjedhjes, nëse ia vjedhim tjetrit dicka me vlerë 50 euro ose më shumë do dënohemi me gjobë dhe burgim deri në tre vjet, kurse kodi jonë nuk e definon shumën me shifër sikurse në kodin penal të Kosovës, por thotë “ai i cili nga tjetri do mer sen të luajtshëm”- si send i luajtshëm llogaritet edhe cdo energji e prodhuar apo e grumbulluar për dhënien e dritës, ngrohtësisë, apo lëvizjes si dhe impulset telefonike dhe mjetet tjera për transmetim të zërit, fotografisë apo tekstit në largësi, apo shërbimeve kompjuterike, ujë i mbledhur dhe i distribuuar i pijshëm dhe sende tjera në përdorim të përgjithshëm, por dënimi ngelet i njëjtë me gjobë ose burgim deri në tre vjet, nëse vlera është më e vogël se 50 euro në Kosovë do dënohej me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj, kurse tek ne me gjobë ose burgim deri në një vit.

Unë mendoj se më i perfeksionuar dhe më efikas sa i përket veprës penale vjedhje është kodi penal i Kosovës për shkak se e definon shumën 50 euro, dhe nuk ka hamendje gjatë shqiptimit të sanksionit. Kodi penal i republikës së Kosovës gjithashtu i ka të përfshira tek veprat penale kundër pasurisë edhe shpërdorimin e pasurisë së huaj, Uzurpimin e paligjshëm të pronës së paluajtshme, Zjarrvënien, Keqpërdorimin e sigurimit, Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, dhe Kurdisjen e ndeshjes ose e sportit.

Kapitulli II

1. Disa lloje të veprave penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

Në kodin penal të Republikës së Maqedonisë së veriut veprat Penale kundër pasurisë janë inkriminuar në në kreun XXIII⁴⁶ dhe atë: Vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror, vjedhja e rëndë, grabitja, vjedhja grabitqare, fshehja, të shërbyerit, marja e sendeve të huaja, marrja e automjetit, dëmtim i sendeve të huaja, dëmtimi i të drejtave të huaja, ndërtimi i paligjshëm, dëmtimi i ndërtesave banesore dhe afariste dhe i lokaleve, të vendosurit (shpërngulja) e paligjshme, mashtrimi, mashtrimi i blerësve, mashtrimi gjatë së kredisë apo të volisë tjetër, mashtrim në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane, mashtrimi në sigurime, dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik, blerja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike, mashtrimi kompjuterik, keqpërdorimi i besimit, pranimi i paautorizuar i dhuratave, dhënia e paautorizuar e dhuratave, shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit, shkaktimi i falimentimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorimi i procedurës së falimentimit, dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve, detyrimi, shantazhi, fajdeja, fshehja, pendimi i veprës së krijuar, ndjekja për vepra në mes të afërmve.

Në territorin e Gjykatës Themelore Dibër veprat penale të vjedhjes që ndodhin më së shpeshti janë : Vjedhja, Vjedhja e energjisë elektrike, Vjedhja e rëndë, Mashtrimi. Ndodhin edhe grabitje edhe vjedhje grabitqare, por këto nuk janë në kompetencat e gjykatës themelore Dibër për shkak se dënimi për këto vepra është më së paku 5 vjet burgim, Gjykata Themelore Dibër është me kompetencë të zvogëluar dhe i trajtojnë çështjet që shqiptohet dënimi me më së

⁴⁶ Po aty kreu XXIII.

shumti 5 vjet burgim. Rastet e grabitjes dhe vjedhjes grabitqare deri në dhjetor të vitit 2019 janë dërguar në Gjykatën Themelore Gostivar, prej 1 janarit të vitit 2020 këto raste dërgohen në Gjykatën Themelore Kërcovë, për shkak se kjo Gjykatë është me kompetencë të zgjeruar.

1.1 Vjedhja neni 235 i kodit penal : Ai i cili nga tjetëri do të merr send të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë atë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Në paragrafin .2 thuhet se nëse vlera e sendit të vjedhur është më e vogël dhe kryeresi ka shkuar kah ajo që ta përvetësojë sendin me ashi vlere, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

Paragrafi.3. ai i cili nga pylli i huaj dot merr drurë, sasia e të cilëve është më e madhe se një metër kub me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 4 thuhet se nëse vepra nga paragrafi 3 të këtij neni është kryer me qëllim që druri i prerë të shitet apo nëse vepra është kryer në pyje në rajone të mbrojtura, nëpyje të mbrojtura apo pyje tjera me qëllime të posacme kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Paragrafi 5. Tentativa për veprat nga paragrafët 1 2 3 dhe 4 është e ndëshkueshme.

Paragrafi 6. Ndjekja për veprën nga paragrafi 2 të këtij neni ndërmerret me padi private.

paragrafi 7. Nëse veprën nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.

Nga kjo vërejmë se ligjvënësi si vepër penale të vjedhjes e konsideron marrjen e një sendi të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë atë, pra objekt mbrojtës është pasuria e huaj luajtshme, e ka potencuar edhe nëse vlera është më e vogël, dënimi do jet më i vogël, gjithashtu në paragrafin 3 e inkriminon edhe vjedhjen e drunjve, duhet theksuar se ndër veprat penale më të shpeshta në praktikën gjyqsore në Gjykatën Themelore Dibër është vjedhja e drunjve nga pylli i huaj, vërejmë se ligjvënësi e potencon sasinë e drunjve , domethënë sasia më e madhe se një metër kub do dënohej me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet, gjithashtu vërejmë se ligjvënësi si rrethanë rënduese tek vjedhja e drunjve e sheh qëllimin pse është vjedhur druri, p.sh. në paragrafin 4 thuhet “nëse vepra nga paragrafi 3 të këtij neni është kryer me qëllim që druri i prerë të shitet”, gjithashtu vërejmë se ligjvënësi e ndëshkon edhe tentativën për veprat nga paragrafët 1,2,3,4, gjithashtu vërejmë se ligjvënësi e parashikon edhe personin juridik ku në paragrafin 7 thuhet “Nëse veprën nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë”.

1.2 Neni 235a Vjedhja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror.

Paragrafi 1. ai që me lidhje të pa pëlqim të operatorit adekuat të sistemit, me marrje përpara të pajisjes për matje, me mënjanimin, paaftësimin, tejkalimin, ndryshimin dhe përdorim të njëjtë me pajisje për matje ose në mënyrë tjetër pa autorizim do të shfrytëzojë energji elektrike,

energji për ngrohje ose gaz natyror, me qëllim që për vete apo për tjetrin do të fitojë dobi të kundërligjshme pasurore do të dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me dënim me gjobë. Paragrafi 2 Nëse vlera e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror të vjedhur është më e madhe, kryerësi do të dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe me dënim me gjobë.

paragrafi 3 Tentativa për veprat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është e ndëshkueshme.

paragrafi 4 Nëse veprën e kryen personi juridik do të dënohet me dënim me gjobë.

Nga neni 235 vërejmë se ligjvënësi e ka inkriminuar në kodin penal edhe vjedhjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror, vërejmë se veprimet për tu ndeshur me këtë vepër penale janë shfrytëzimi i energjisë elektrike me lidhje të papëlqim të operatorit adekuat të sistemit, me marrje përpara të pajisjes për matje, me mënjanimin, paaftësimin, tejkalimin, ndryshimin dhe përdorim të njëjtë me pajisje për matje ose në mënyrë tjetër pa autorizim, gjithashtu e potencon me qëllim që për vete ose për tjetrin do fitojë dobi të kundërligjshme pasurore përcakton dënim me burg deri në tre vjet dhe dënim me gjobë, gjithashtu e parasheh si rethanë rrënduese nëse vlera e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror të vjedhur është më e madhe, dënimi është më i madh, gjithashtu e ndëshkon edhe tentativën për këtë vepër penale, gjithashtu e parashikon edhe personin juridik, si kryerës i kësaj vepre do dënohej me gjobë.

1.3 Neni 236 Vjedhja e rëndë (1) Nëse vjedhja është kryer:

1) me thyerje ose me thyerje me dhunë në hapësira të mbyllura, me evitim të pengesave, ose në mënyrë tjetër, me evitim të pengesave më të mëdha

2) nga ana e më shumë personave të bashkuar për kryerjen e vjedhjes,

3) në një mënyrë të pacipë,

4) nga ana e personit i cili në vete ka pasur ndonjë armë ose mjet të rezikshëm, mjet për sulm ose mbrojtje,

5) gjatë një zjarri, përmbytjeje ose një aksidenti të ngjashëm dhe

6) me shfrytëzimin e paaftësisë ose fatkeqësinë e një tjetri, nëse objektet kanë vlerë më të madhe, kryesi do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet, dhe nëse sendet kanë vlerë të konsiderueshme, kryesi do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

(2) Për vjedhjen e sendeve me vlerë të konsiderueshme, kryesi do të dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.

(3) Për vjedhje të sendeve me vlerë me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet burgim.

(4) Nëse sendi i vjedhur është e mirë nën mbrojtje të përkohshme, trashëgimi kulturore, raritet natyror apo pajisje ose send tjetër me rëndësi të posacme për sigurinë e njerëzve dhe pasurisë dhe sigurisë së komunikacionit publik apo objekt i instalimeve publike ose sende në përdorim të përgjithshëm, kryerësi do të dënohet me më së paku katër vjet burgim.

(5) nëse vlera e sendit të vjedhur nga paragrafi 1 i këtij neni është me e vogël dhe kryerësi ka

shkuar kah ajo që ta përvetësojë sendin me asi vlere, do të denohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Nga neni 236 vërejmë se në paragrafin 1 janë paraparë format e vjedhjes të cilat marrin formën e kualifikuar apo forma të rënda të veprës penale të vjedhjes për shkak të mënyrës dhe rrethanave të kryerjes, ka paraparë bashkimin e disa personave në kryerjen e kësaj veprë menyrën përdorimin e mjeteve të forta për sulm dhe shfrytëzimin e paasftësisë së tjetrit, për këtë vërejmë se ligjvënësi parashikon burgim nga një deri në pesë vjet. Në paragrafin 2 vjedhjet marrin karakter të veprës penale të rëndë për shkak të vlerës së sendit të vjedhur dhe për këtë ligjvënësi ka parapa edhe dënimin më të madh një deri në dhjetë vjet. Në paragrafin 3 gjithashtu vjedhjet marrin karakter të veprës penale të rëndë për shkak të vlerës së sendit të vjedhur, ligjvënësi e potencon “vjedhje me përmasa të mëdha” gjithashtu edhe dënimi është më i madh duke filluar prej tre deri në dhjetë vjet burgim, gjithashtu vërejmë se kryerësi e parashikon edhe nëse vlera e sendit të vjedhur është më e vogël, edhe dënimi do ishte më i vogël.

1.4 Neni 237 Grabitja (1) Ai që me përdorim të forcës apo të kërcënimit të drejtpërdrejtë do të sulmoj ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt, do të marrë ndonjë send të huaj të luajtshëm me qëllim që ta përvetësojë në mënyrë të kundërligjshme do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(2) Nëse vlera e sendit të marrë është me përmasa të mëdha, kryerësi do të ndëshkohet më së paku tetë vjet burgim.

(3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 deri 3 të këtij neni ndonjë personit me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose nëse vepra është kryer në përbërje të grupit, bandës apo nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, ose nëse gjatë kryerjes së veprës në banke, këmbimore, postë apo në vend publik, është kërcënuar jeta apo trupi i dy apo më tepër personave, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

(5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me paramendim i është privuar jeta, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Nga neni 237 vërejmë se veprimet me të cilat kryhet kjo veprë penale Grabitja, janë veprime të cilat në vete paraqesin veprë penale, pra sic e shohim në paragrafin 1 përdorimi i forcës apo kërcënimit të drejtpërdrejtë dhe sulmi ndaj jetës dhe trupit të tjetërkujt, ose marja e sendit të huaj me qëllim përvetësimi i kundërligjshëm, dënimin për këtë veprë ligjvënësi e parashikon më së paku 5 vjet, ligjvënësi e cakton më së paku 5 vjet si pasojë e rrethanave rënduese sic janë përdorimi i forcës apo kërcënimit të drejtpërdrejtë, dhe sulmi ndaj jetës dhe trupit të tjetërkujt gjatë kryerjes së vjedhjes, domethënë me këtë veprë çënohen dhe sulmohen dy vlera të

mbrojtura me ligj – liria dhe pasuria dhe për këtë arsye kjo vepër penale është vepër e përbërë. Ligjvënësi gjithashtu e parashikon edhe nëse vlera e sendit të marrë është më e madhe ose më e vogël, kjo do kishte ndikim në përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë, gjithashtu rrethanë rënduese e shih nëse vepra është kryer në përbërje të grupit, bandës apo nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, ose nëse gjatë kryerjes së veprës në banke, këmbimore, postë apo në vend publik, është kërcënuar jeta apo trupi i dy apo më tepër personave, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim, dhe nëse gjatë kryerjes së kësaj vepre privohet jeta e dikujt ligjvënësi parashikon më së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.

1.5 Neni 238 Vjedhja grabitqare (1) Ai i cili është gjetur në vjedhje, do të përdorë forcë apo kërcënim të drejtpërdrejtë do të sulmojë ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt me qëllim që ta mbajë sendin e vjedhur, do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(2) nëse vlera e sendit të vjedhur është me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me së paku tetë vjet burgim.

(3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 deri në 3 të këtij neni ndonjë personit me dashje i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose nëse vjedhja grabitqare është kryer në përbërje të grupit, bandës ose nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, ose nëse gjatë kryerjes së veprës në bankë, këmbimore, postë, apo në vend publik është rrezikuar jeta apo trupi i dy apo më tepër personave, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

(5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me dashje është privuar nga jeta, kryerësi do të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.⁴⁷

Nga ajo që shohim më lartë neni 238-vjedhja grabitqare vërejmë se vepra penale, vjedhja grabitqare, është vepër e përbërë e cila përbëhet nga vepra penale e vjedhjes, përveç elementeve të veprës penale të vjedhjes përmban edhe elemente të veprës penale të dhunës dhe kanosjes apo sulmit ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt. Tek kjo vepër penale së pari kryhet vepra penale e vjedhjes e pastaj me qëllim që të mbahet pasuria e luajtshme kryhet vepra penale e dhunës apo kanosjes. Gjithashtu vërejmë se ligjvënësi i parashikon rrethanat rënduese të lehtësuese që do ndikojnë në përcaktimin e dënimit të kryerësit të kësaj vepre penale.

1.6 Neni 247 Mashtrimi (1) Ai i cili me qëllim për vete apo për tjetrin që të sigurojë dobi të paligjshme pasurore do të sjell dikën në mashtrim me paraqitje të rrejshme ose me fshehje të fakteve ose do ta mbajë në mashtrim dhe me të do ta shtijë të kryejë apo të mos kryejë dicka që është në dëm të pasurisë së tij apo të huaj, do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse dëmi i bërë është me vlerë më të vogël, kurse kryerësi ka shkuar në të që të fitojë vlerë të tillë, do të dënohet me dënim me gjobë ose burgim deri në një vjet.

⁴⁷ Po aty neni 235-238.

- (3) Nëse dëmi i bërë është me vlerë më të madhe, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (4) Nëse dëmi i bërë tejkalon vlerë të konsiderueshme, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (5) Ai i cili veprën nga paragrafi 1 e ka kryer vetëm me qëllim që të dëmtojë tjetërkënd, do të dënohet me burgim me gjobë ose burgim deri në një vjet.
- (6) Me dënimin nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet ai që me qëllim për vete apo tjetërkënd do të fitojë dobi të kundërligjshme pasurore, do të sjell tjetërkënd në lajthim ose do ta mbaj në lajthim me prezentim të rrejshëm ose me fshehje të fakteve që kanë të bëjnë me garë të kurdisur sportive ose rezultat të kurdisur të lojës sportive dhe me të shtinë të bëj apo mos bëj dicka në llogari të pasurisë së vet apo të huaj.
- (7) Tentativa për veprat nga paragrafët 1 dhe 5 është e ndëshkueshme.
- (7) Nëse eprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.
- (8) Për veprat nga paragrafët 2 dhe 5 ndjekje ndërmeret me padi private.
- Nga ajo që shohim më lartë në nenin 247 për veprën penale mashtrimi vërejmë se mashtrimi është një vepër penale e orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshirë edhe të drejtat dhe interesat pasurore, veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në paraqitjen e rrejshme të fakteve apo duke i fshehur ato, vërejmë se ligjvënësi e parashikon dënimin me gjobë ose me burg, gjithashtu vërejmë se ligjvënësi i ka parashikuar edhe rrethanat lehtësuese dhe rrënduese që do ndikonin në shqiptimin e dënimit, gjithashtu vërejmë se inkriminohet edhe tentativa, dhe kryerja e kësaj vepre nga personi juridik.
- Në vijim do paraqesim të dhëna statistikore në lidhje me veprat penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

2. Statistika në lidhje me veprën penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

Në vijim do të sjellim të dhëna statistikore në lidhje me veprën penale vjedhje neni 235 dhe vjedhje e rëndë neni 236 (vepra këto që janë më të shpeshta dhe trajtohen në rajonin e Dibrës) dhe denimet e shqiptuara për këto vepra në territorin e Gjykatës themelore Dibër për periudhën e studimit 2015-2020.

Tabela nr.1.

Viti 2015		
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	26	54
Të hudhura	4	9
Dënim me kusht	3	3
Dënim me burg	/	16
Dënim me gjobë	1	/
Të panjohur	18	26

Në tabelën e mësipërme kemi paraqitur statistika të mara nga Prokuroria Themelore Publike

Dibër, në lidhje me veprën penale vjedhje nëni 235. Dhe vjedhje e rëndë neni 236 për vitin 2015.

Veprën penale vjedhje n.235 në Dibër për vitin 2015 kemi gjithësej 26 raste, nga këto 26 raste, 4 janë të hudhura nga ana e Prokurorit Publik për munges provash, ndaj 4 personave është ngritur propozim për urdhërdënim ku 3 tre prej tyre u është shqiptuar dënim me kusht, dhe njërit denim me gjobë. Dënim me burg për veprën penale vjedhje në vitin 2015 nuk është shqiptuar ndaj asnjë personi. Raste të pazbuluara me persona të panjohur (numri i përhimtë i kriminalitetit) kemi 18 raste.

Veprën penale vjedhje e rëndë n.236 në vitin 2015 kemi gjithësej 54 raste, të hudhura nga ana e Prokurorit për munges provash kemi 9 raste, denimi me kusht është shqiptuar në 3 raste, dënimi me burg është shqiptuar në 16 raste, dënim me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast. Raste të pa ndricuara deri në fund(numri i përhimtë i kriminalitetit) me persona të panjohur kemi gjithësej 26 për vitin 2015.

Tabela nr.2.

Viti 2016		
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	23	54
Të hudhura	6	3
Dënim me kusht	7	2
Dënim me burg	1	4
Dënim me gjobë	2	/
Të panjohur	7	36
Të mitur	/	3

Në tabelën nr.2. gjithashtu kemi paraqitur të dhëna statistikore të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër në lidhje me veprën penale vjedhje n.235 dhe vjedhje e rëndë n.236 për vitin 2016.

Nga tabela e mësipërme do vërejmë se për veprën penale vjedhje n.235 gjithësej janë regjistruar 23 raste, nga keto 6 padi janë hudhur nga ana e Prokurorit Publik për shkak se nuk ka pasur mjaftueshëm prova, në një rast është ngritur propozim akuzë dhe është shqiptuar dënim me burg. Në 9 raste është ngitur propozim për urdhërdënim nga ana e prokurorit, ku 7 prej tyre janë dënuar me kusht dhe 2 prej tyre u është shqiptuar dënim me gjobë me të holla.Vjedhje të pa ndricuara deri në fund me persona të panjohur për vitin 2016 kemi 7 raste.

Veprën penale vjedhje e rëndë n.236 për vitin 2016 në Dibër janë regjistruar gjithësej 54 raste, nga këto 3 padi janë hudhur nga ana e Prokurorit Publik për mungesë provash, është ngritur propozim akuzë ndaj 7 personave ku 4 prej tyre u është shqiptuar dënimi me burg, kemi propozim për urdhër dënim ndaj 2 personave ku te dy janë dënuar më kusht.Gjithashtu vërejmë se për veprën penale vjedhje e rëndë ne vitin 2016 kanë marrë pjesë edhe 3 persona të mitur, këto raste janë dërguar në Gjykatën Themelore Gostivar për shkak se Gjykata Themelore

Dibër nuk është kompetente për këto raste sepse është me kompetenca të zvogeluara ose të ngushtuara, dhe për këto raste është i paraparë trajtim i posatshëm penalo juridik sipas ligjit për procedurë penale dhe ligjit për drejtësinë e të miturve. Raste të pa zbuluara, të pa ndricara deri në fund për veprën penale vjedhje e rëndë, për vitin 2016 kemi gjithsej 36.

Sic e vërejmë në krahasim me vitin 2015 intesiteti i vjedhjeve është pothuajse i njejtë, për veprën penale vjedhje kemi 3 raste më shumë, për veprën penale vjedhje e rëndë numri është i njejtë vetëm në vitin 2016 kemi më shumë raste të pazbuluara për të cilat vazhdojnë hetimet për gjetjen e kryerësve.

Tabela nr.3.

	Viti 2017	
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	28	47
Të hudhura	7	/
Dënim me kusht	6	/
Dënim me burg	2	15
Dënim me gjobë	/	/
Tëpanjohur	13	30
Të mitur	/	2

Në tabelën nr.3. I kemi paraqitur të dhënat statistikore për veprën penale vjedhje n.235 dhe vjedhje e rëndë n.236 për vitin 2017, gjithashtu të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër.

Nga tabela e mësipërme do vërejmë se për veprën penale vjedhje n.235 në vitin 2017 janë regjistruar gjithësej 28 raste, nga këto të hudhura nga ana e Prokurorit Publik për mungesë provash janë 7 raste. Dënimi me kusht për veprën penale vjedhje në vitin 2017 është shqiptuar ndaj 6 personave, dënimi me burg është shqiptuar në 2 raste, dënimi me gjobë me të holla për veprën penale vjedhje në vitin 2017 nuk është shqiptuar në asnjë rast. Raste të pa ndricuara deri në fund për veprën penale vjedhje në vitin 2017 janë 13 raste.

Për veprën penale vjedhje e rëndë n.236 në vitin 2017 janë regjistruar gjithsej 47 raste, të hudhura nga ana e Prokurorit Publik nuk ka asnjë rast, është ngritur propozim akuzë ndaj 15 personave ku ndaj të gjithëve është shqiptuar dënim me burg, dënimi me kusht dhe dënim me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast, në 2 raste kemi pjesmarjen e personave të mitur ku janë dërguar në Gjykatën Themelore Gostivar sepse këto raste nuk mund të trajtohen në Gjykatën Themelore Dibër ngaqë është me kompetencë të zvogeluar dhe për këto raste është i paraparë trajtim i posatshëm penalo juridik sipas ligjit për procedurë penale dhe ligjit për drejtësinë e të miturve. Në vitin 2017 për veprën penale vjedhje e rëndë kemi 30 raste të pazgjithura me persona të panjohur, hetimet për kapjen e kryerësve vazhdojnë.

Në krahasim me vitin 2016 nuk ka ndonjë dallim të madh, nuk vërejmë ndonjë rënie të numrit të vjedhjeve, për veprën penale vjedhje janë regjistruar 5 raste më shumë, për veprën penale vjedhje e rëndë janë regjistruar 7 raste më pak.

Tabela nr.4.

Viti 2018		
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	18	52
Të hudhura	4	11
Dënim me kusht	5	5
Dënim me burg	/	5
Dënim me gjobë	/	/
Të panjohur	9	31

Në tabelën nr 4 gjithashtu i kemi paraqitur të dhënat statistikore për veprën penale vjedhje n.235 dhe vjedhje e rëndë n.236 të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër për vitin 2018.

Nga tabela e mësipërme do vërejmë se për veprën penale vjedhje n.235 në vitin 2018 janë regjistruar gjithsej 18 raste, të hudhura nga ana e Prokurorit Publik për mungesë provash janë 4 raste, në 5 raste është shqiptuar dënimi me kusht, dënimi me burg dhe dënimi me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast për vitin 2018. Raste të pa ndricuara deri në fund (numri i përhimtë i kriminalitetit) me persona të panjohur për vitin 2018 kemi 9 raste, për të gjitha vazhdojnë hetimet.

Për veprën penale vjedhje e rëndë në vitin 2018 janë regjistruar 52 raste. 11 padi janë të hudhura nga ana e Prokurorit për mungesë provash, në 5 raste është shqiptuar dënimi me kusht, edhe dënimi me burg është shqiptuar në 5 raste, dënim me gjobë nuk ka asnjë rast. Raste të pa ndricuara deri në fund janë gjithsej 31 ku hetimet për zbulimin dhe kapjen e kryesësve vazhdojnë.

Për dallim nga viti 2017 për veprën penale vjedhje janë regjistruar 10 raste më pak, për veprën penale vjedhje e rëndë ka 5 raste më shumë, raste të pa zbuluara për veprën penale vjedhje në vitin 2018 ka 4 raste më pak kurse për veprën penale vjedhje e rëndë 1 rast më shumë, ku hetimet nga bashkëpunimi i ngushtë Prokurori Polici vazhdojnë.

Tabela nr5.

viti 2019		
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	16	42
Të hudhura	7	4
Dënim me kusht	2	4
Dënim me burg	1	2
Dënim me gjobë	/	/
Të panjohur	6	31
Të mitur	/	1

Në tabelën nr5. gjithashtu kemi paraqitur të dhëna statistikore për veprat penale vjedhje n.235 dhe vjedhje e rëndë n.236 të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër për vitin 2019. Nga tabela e mësipërme do vërejmë se për veprën penale vjedhje gjithësej janë regjistruar 16 raste, 7 padi janë hudhur nga ana e Prokurorit Publik për mungesë provash, janë ngritur 3 propozimakuza pranë Gjykatës Themelore Dibër në të cilat njëri është dënuar me burg dhe 2 të tjerë u është shqiptuar dënimi me kusht, dënim me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast. Raste të pa ndricuara deri në fund të kryera nga persona të panjohur janë gjithësej 6 raste ku hetimet vazhdojnë.

Për veprën penale vjedhje e rëndë janë regjistruar gjithsej 42 raste, 4 padi janë hudhur nga ana e Prokurorit për mungesë provash, dënimi me kusht është shqiptuar në 4 raste, dënimi me burg është shqiptuar në 2 raste, dënim me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast, vërejmë se një person i mitur është pjesmarës në këtë vepër penale, kjo lëndë është dërguar në kompetencën e prokurorisë themelore Gostivar sepse këto raste nuk mund të trajtohen në Gjykatën Themelore Dibër ngaqë është me kompetencë të zvogluar dhe për këto raste është i paraparë trajtim i posatshtëm penalo juridik sipas ligjit për procedurë penale dhe ligjit për drejtësinë e të miturve.31 raste janë të pa ndricuara deri në fund me persona të panjohur ku hetimet vazhdojnë.

Në krahasim me vitin 2018 për veprën penale vjedhje janë regjistruar 2 raste më pak, për veprën penale vjedhje e rëndë janë regjistruar 10 raste më pak, raste të pa zbuluara për veprën penale vjedhje ka 3 më pak kurse për veprën penale vjedhje e rëndë numri është i njëjtë me 31 raste, në vitin 2019 në 1 rast ka rezultuar pjesmarës personi i mitur.

Tabela nr6.

	viti 2020	
	Vjedhje n.235	Vjedhje e rëndë n.236
Gjithsej	6	6
Të hudhura	/	/
Dënim me kusht	2	1
Dënim me burg	/	2
Dënim me gjobë	/	/
Të panjohur	4	3
Të mitur	/	/

Në tabelën nr6. Gjithashtu kemi paraqitur të dhëna statistikore të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër për veprat penale vjedhje n.235 dhe vjedhje e rëndë n.236. për vitin 2020.

Nga tabela e mësipërme do vërejmë se deri tani 20 qershor 2020 për veprën penale vjedhje janë regjistruar gjithsej 6 raste, ndaj 2 personave është ngritur propozim për urdhërdënim dhe ndaj të dyve është shqiptuar dënimi me kusht, 4 raste janë të pa zbuluara dhe ende hetimet vazhdojnë.

Për veprën penale vjedhje e rëndë deri tani 20 qershor 2020 gjithashtu kemi 6 raste, në 3 raste është ngritur propozimakuze ku 2 janë dënuar me burg, 1 personit i është shqiptuar dënimi me kusht, 3 raste janë të pa zbuluara ku hetimet vazhdojnë.

Në vijim do ti paraqesim të dhëna statistikore për veprën penale mashtrim në territorin e Gjykatës Themelore Dibër për periudhën e studimit 2015 - 2020.

Tabela nr 7.

Mashtrimi						
	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej	8	6	1	5	4	/
Të hudhura	5	3	/	3	3	/
Dënim me kusht	1	/	/	1	1	/
Dënim me burg	2	1	1	1	/	/
Dënim me gjobë	/	2	/	/	/	/
Të panjohur	/	/	/	/	/	/

Në tabelën nr7. Janë paraqitur statistika për veprën penale mashtrimi neni 247 vepër e cila hyn në seksionin e krimeve kundër pasurisë në territorin e Gjykatës Themelore Dibër të marra nga Prokuroria Themelore Publike Dibër për periudhën e studimit 2015-2020.

Për veprën penale mashtrimi neni 247 për vitin 2015 janë regjistruar gjithsej 8 raste, 5 nga këto

janë të hudhura nga ana e Prokurorit për mungesë provash, në 2 raste është ngritur propozimakuze, të dyve ju është shqiptuar dënimi me burg, ndaj 1 personi është ngritur propozim për urdhërdënim dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, raste të pandricuara për veprën penale mashtrimi në vitin 2015 nuk ka.

Në vitin 2016 për veprën penale mashtrimi janë regjistruar gjithsej 6 raste,3 nga këto janë të hudhura nga ana e Prokurorit për mungesë provash, në 1 rast është ngritur propozimakuze dhe i është shqiptuar dënimi me burg, ndaj 2 personave është ngritur propozim për urdhërdënim, të dy janë denuar më gjobë me të holla, raste të pazbuluara nuk ka për vitin 2016.

Në vitin 2017 është regjistruar vetëm 1 rast për veprën penale mashtrimi, është ngritur propozimakuze dhe i është shqiptuar dënimi me burg. Duket se në vitin 2017 janë shënuar më pak raste nga dy vitet e kaluara.

Në vitin 2018 janë regjistruar gjithsej 5 raste,nga të cilat 3 janë hudhur nga ana e Prokurorit për mungesë provash, ndaj 2 personave është ngritur propozimakuze ku njërit i është shqiptuar dënimi me burg dhe tjetrit dënimi me kusht.

Në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 4 raste, 3 prej këtyre janë hudhur për mungesë provash ndaj 1 personi është ngritur propozimakuze dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, raste të pazbuluara nuk ka. Në vitin 2020 deri më sot nuk ka asnjë rast të veprës penale mashtrimi, kjo është e gjitha sa i përket kësaj veprë në rajonin e Dibrës për periudhën e studimit, në vitin 2017 kemi patur më pak raste, vërejmë shumë kallzime të hudhura nga ana e Prokurorit për mungesë provash.

Nga tabelat e mësipërme vërejmë se vepra më e shpeshtë në grupin e veprave penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës është vepra penale vjedhje e rëndë e inkriminuar në nenin 236 të kodit penal të Republikës së Maqedonisë së veriut,kjo për shkak se gjatë vjedhjes veprimet e kryerësve bien ndesh me paragrafet e nenit 236 , domethënë vjedhjet kanë ndodhur me thyerje me dhunë në hapësirat e mbyllura, me evitim të pengesave, nga ana e më shumë personave të bashkuar për kryerjen e vjedhjes të cilët kanë pasur mjet të rezikshëm sulmi, dhe shuma e vjedhur ka qenë e konsiderueshme.

Gjithashtu vërejmë se në vitin 2016 dhe 2017 pjesmarës në veprën penale vjedhje e rëndë kanë qenë edhe persona të mitur gje që konsiderohet tepër shqetësuese.

Gjithashtu vërejmë se kemi një numër të madh të rasteve të pazbuluara deri në fund me persona të panjohur që hetimet vazhdojnë akoma, gjë që është tepër shqetësuese dhe sfida më e madhe e organeve kompetente për zbardhjen e këtyre rasteve.

Kapitulli III

1Shkaqet apo faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në veprat penale të vjedhjes në rajonin e Dibrës.

Në vijim do të paraqiten dhe analizohen faktorët më të shpeshtë që i shtyjnë kryerësit të mirren me veprat penale të vjedhjes në territorin e Dibrës.

Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në përgjithësi i ndajmë në objektiv(të jashtëm) dhe subjektiv (të mbrendshëm).

2. Faktorët e jashtëm.

Sipas mendimit të disa kriminologëve si p.sh. Cesare Lombroso, ndikimin më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë. Sipas tyre, faktorë të jashtëm ose egzogjenë, përbëjnë kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale. Ata ndikojnë drejtpërsëdrejti në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri. Faktorët e jashtëm ose objektivë janë të shumtë dhe secili ka rëndësinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale.

Nga kërkimet empirike kriminologjike, e sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të të dhënave statistikore mbi kriminalitetin në përgjithësi dhe kriminalitetin e vjedhjes në vecanti në shumë vende vërehet se disa

faktorë objektivë apo të jashtëm, kanë një ndikim më të madh se sa faktorët e tjerë.

Kësisoj, si faktorë me ndikim të dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale trajtohen: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë, faktorët ideopolitikë, mikrogruporë, sociopatologjikë dhe të tjerë.⁴⁸

Ndër faktorët objektivë të cilët kanë ndikim në paraqitjen e veprave penale të vjedhjes në Dibër do të veçojë: faktorët ekonomiko shoqërore, tek këta faktor kam vecaur (varfëria, papunësia, krizat dhe depresionet ekonomike) faktoret ideopolitike kam vecuar (arsimimi) ,faktoret mikrogruporë kam vecuar (familja, shkolla dhe ambienti shkollor dhe mjedisi social), faktorët socio patologjikë kam vecuar (bixhozin dhe narkomaninë).

2.1 Varfëria.

Varfëria, konsiderohet si një faktorë objektiv i kriminalitetit i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale vecanërisht vjedhjes . Në literaturën kriminologjike flitet për ndikimin e madh që kanë kushtet e vështira materiale dhe varfëria në paraqitjen e kriminalitetit. Ato janë prezente veçanërisht në kohën e krizave dhe depresioneve ekonomike. Për ndikimin e madh të skamjes dhe të varfërisë në paraqitjen e dukurive negative, ka bërë fjalë edhe filozofi antik Aristoteli i cili ka theksuar se *“varfëria është nëna e kimit, ndërsa begatia nënë e amoralitetit”*.⁴⁹

Është e vërtetë e madhe dhe e pakontestueshme se kushtet materiale, e sidomos skamja,


⁴⁸ Ragip Halili Kriminologjia botimi i shtatë Prishitë 2011 fq.241

⁴⁹ Po aty fq. 247.

ndikojnë fuqishëm në sjelljet dhe në qëndrimet e individëve dhe të grupeve të caktuara. Varfëria dhe skamja mund të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe në qëndrimet e disa individëve, sidomos të disa individëve të cilët edhe ashtu janë zhytur në veprime dhe në sjellje kriminale.⁵⁰

Format më të shpeshta të sjelljeve kriminale të cilat kryhen për shkak të varfërisë dhe kushteve të vështira materiale janë veprat penale të vjedhjes vjedhjet e imëta, grabitjet, mashtrimet dhënia pas bredhjes, vjedhja e rëndë, vjedhja në automjete etj. Për fat të keq në Dibër një numër i konsiderueshëm i popullatës jetojnë në kushte të vështira materiale dhe si pasojë e kësaj këta persona nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat dhe kënaqësitë elementare, dhe kjo i shtyn që të përfitojnë të holla nëpërmjet rrugëve kriminale dhe vjedhjes. Në vijim nëpërmjet grafikoni do të paraqesim shkallën e përqindjes së varfërisë në RMV.

Grafikoni nr1.



Të dhënat e mësipërme janë marrë nga entiteti shtetëror për statistika të RMV dhe e paraqesin shkallën e varfërisë në përqindje. domethënë sic e vërejmë në vitin 2015 shkalla e varfërisë është 21.5 %, në vitin 2016 shkalla e varfërisë është 21.9 % dmth kemi ritje të shkallës së varfërisë në nivel republikan për dallim nga viti 2015, në vitin 2017 shkalla e varfërisë është 22.2 %, është shënuar ritje e shkallës së varfërisë për dallim nga viti 2016, në vitin 2018 shkalla e përqindjes së varfërisë në nivel shtetëror është 21.9%, dmth është ulur për dallim nga viti 2017. Sic e vërejmë shkalla më e madhe e përqindjes së varfërisë për këto 4 vite është në vitin 2017, kjo ka pasur ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale në përgjithësi, dhe në veprat penale të vjedhjes.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Entiteti shtetëror për statistika të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.2 Papunësia.

Papunësia është e ngjashme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe të kyçjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Papunësia si dukuri dhe s problem social, veçmas vjen në shprehje gjatë krizave dhe recesioneve ekonomike. Papunësia ndikon në keqësimin e pozitës materiale të individëve dhe të familjeve. Për shkak të pamundësisë së plotësimit të nevojave elementare për jetesë, të anëtarëve të familjes, për shkak të pamundësisë së shkollimit dhe të mbrojtjes shëndetësore, pason braktisja e shkollës dhe e mësimin, paraqitja e sëmundjeve dhe e sjelljeve kriminale, nga ana tjetër vetë atmosfera e krijuar për shkak të papunësisë ndikon në gjendjen psikike dhe shpirtërore të individëve dhe familjeve të caktuara. Në këtë mënyrë janë të shpeshta konfliktet dhe mosmarrëveshjet në familje, në mes bashkëshortëve, në mes femijëve dhe prindërve dhe dukuri të tjera negative.⁵²

Gjendja e papunësisë manifestohet me mungesë rroge, mungesë të hollash dhe krijon varfëri , dhe si pasojë e kësaj shumë persona për të dale nga gjendja e rrënduar ekonomike apo varfëria fillojnë mirren me vjedhje për të siguruar të holla për ti kënaqur apo plotësuar nevojat elementare. Në vijim do të paraqesim një tabelë në lidhje me familjet të papuna që përfitojnë ndihmë financiare sociale në rajonin e Maqedonisë jugperëndimore ku përfshihen komunat Dibër, Debarcë, Kërcovej, Brod, Ohër, Pllasincë, Strugë, Vevcan, Qendër Zhupë për vitet: 2013, 2014, 2015, 2016 të marur nga enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr. 8.

2013	2014	2015	2016
3132	2883	2837	2795

⁵³

Për vitin 2013 përfitues të ndihmës financiare sociale në rajonin e maqedonisë jugperëndimore kanë qenë 3132 familje, për vitin 2014 2883 famije për 2015 gjithsej 2837 familje, për vitin 2016 kanë përfituar ndihmë sociale 2795 familje, sic e shohim papunësia është në nivel të lartë në këtë pjesë të Maqedonisë.

2.3Krizat dhe depresionet ekonomike.

Konsiderohen si faktor me ndikim të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale, ndryshimet e mëdha politike, prishin balancat në shoqëri dhe ekonomi dhe krijojnë kriza në të gjitha institucionet sociale, këto kriza vështirsojnë ekzistencën e popullsisë pasi që vjen deri tek ngritja e çmimeve, shtrejtimi i të mirave materiale etj. Njerëzit fillojnë të hasin probleme me punësimin dhe kështu krijohen strese, pasiguri, varfëri, dhunë, armiqësi

⁵² Ragip Halili Kriminologjia botimi i shtatë Prishitnë 2011 fq .249.

⁵³ Enti Shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

politike dhe si pasojë vjen deri tek paraqitja e sjelljeve asociale dhe ritet numri i vjedhjeve.⁵⁴

2.4 Arsimimi.

Është një faktor me rëndësi në formimin dhe në ngritjen e personalitetit të njeriut për një jetë më të sigurt dhe më të suksesshme. Një kohë të gjatë është menduar se arsimimi është mjet i fuqishëm për parandalimin e sjelljeve antishoqërore dhe kriminale.⁵⁵

Personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore. Atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe për t'i gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për ç'arsye ata nuk janë të aftë t'u rezistojnë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të mjedisit shoqëror.

Në një shoqëri të arsimuar dhe të kulturuar kriminaliteti mund të pakësohet pasi që personat e arsimuar janë të edukuar, të paisur me dije, nuk kanë vese të këqija dhe sjellja e tyre zakonisht është në pajtim më ligjin. Janë të rrallë personat e arsimuar të cilët kryejnë vepra penale pasi që arsimimi e senzibilizon njeriun, ato janë të vetëdijshëm për pasojat që mund të sjell kryerja e veprës penale dhe prandaj qëndrojnë larg këtyre veprimeve. Mirëpo ka edhe disa raste ku arsimimi mund ti aftësojë personat të cilët janë të prirur për kriminalitet pasi që me ndihmën e njohurive që posedojnë dhe profësionit ata i kryejnë veprat penale më lehtë dhe me më pak vështirësi. Në shumë vende të botës gjithashtu edhe në vendin tonë veprat penale kryhen nga persona me shkallë të ulët të arsimimit dhe analfabetë, mirëpo ka raste ku këto vepra kryhen edhe nga persona të arsimuar dhe të edukuar, prandaj ky faktor mund të ketë edhe ndikim pozitiv edhe negative në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Shpeshherë në literaturën kriminologjike, për t'u dëshmuar roli dhe rëndësia që ka arsimimi dhe dituria, përmendet një mendim i shkrimtarit të madh francez, **Viktor Ygos: "Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu"**.⁵⁶ Në vijim do të paraqitet një tabelë në lidhje me përgatitjen arsimore të të riturve të dënuar për krime kundër pasurisë në republikën e Maqedonisë se Veriut për vitet 2017 – 2018.

Në vijim do paraqitet një tabelë me të dhënat statistikore në lidhje me përgaditjen arsimore të të riturve të dënuar për krime kundër pasurisë në RMV për vitet 2017-2018.

Tabela nr.9.

	2017	2018
totali	2 427	2339
Pa arsim	119	175
Arsim i papërfunduar	109	152
Shkollë fillore	526	517
Shkollë të mesme	688	696
Arsim të lartë	74	70

57

⁵⁴ Ragip Halili Kriminologjia botimi i shtatë Prishtinë 2011 fq. 246.

⁵⁵ Po aty fq. 260.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Enti Shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në këtë tabelë janë paraqitur të dhënat statistikore në lidhje me përgaditjen arsimore të të riturve të dënuar për krime kundër pasurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për vitet 2017-2018 të marra nga Enti Shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kryerës të pa arsimuar për vitin 2017 kemi gjithësej 119 persona, në vitin 2018 kemi gjithësej 175 kryerës të paarsimuar 56 më shumë për dallim nga viti 2017. Me arsim të papërfunduar për vitin 2017 kemi gjithësej 109 kryerës të dënuar, në vitin 2018 kemi 152 kryerës të dënuar me arsim të papërfunduar 43 më shumë për dallim nga viti 2017. Me shkollë fillore në vitin 2017 kemi 526 kryerës të dënuar kurse në vitin 2018 kemi gjithësej 517 kryerës të dënuar domethënë 9 më pak. Më shkollë të mesme në vitin 2017 kemi 688 të dënuar, kurse në vitin 2018 kemi 8 më shumë ku gjithësej janë 696. Me arsim të lartë për vitin 2017 kemi gjithësej 74 persona të dënuar, kurse për vitin 2018 kemi 70 të dënuar dmth 4 më pak. Të paidentifikuar në vitin 2017 kemi 911 kryerës të dënuar , kurse në vitin 2018 gjithësej 729. Pra nga kjo tabelë vërejmë se numri më i lartë i kryerësve të veprave penale kundër pasurisë në RMV është nga kryerës me shkollë të mesme, dhe me shkollë fillore kjo për arsye se atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe për t'i gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për ç'arsye ata nuk janë të aftë t'u rezistojnë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të mjedisit shoqëror, numri më i vogël është i kryerësve me arsim të lartë, kjo për shkak se ata janë më të vetëdijshëm për pasojat që mund të sjell vepra penale, dhe mund të jenë të punësuar dhe nuk kanë nevoj të miren me vepra penale për përfitime materiale.

2.5 Profesionit .

Profesionit- Gjithashtu konsiderohet si një nga faktorët i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Për dallim nga rastet tjera kur kriminaliteti paraqitet si pasojë e varfërisë, e papunësisë, e migrameve etj, kriminaliteti sipas profesionit ka të bëjë me aftësinë e disa personave të cilët e keqpërdorin vendin e punës, detyrën zyrtare dhe njohurit e tyre profesionale për të kryer vepra penale, personat të cilët më shpesh paraqiten si kryerës të veprimeve kriminale duke shfrytëzuar vendin e punës janë: personat që punojnë si kontabilistë, mjekët, furnizuesit etj, ato zakonisht bëjnë mashtrime, falsifikime dhe asgjësime të dokumenteve, dhe punë të ndryshme antiligjore, pra kryejnë akte kriminale. Këto praktika i kanë njëllosur aftësitë profesionale e intelektuale, i bëjnë njerëzit pesimistë, dhe gjallërojnë korrupsionin, pra gjitha këto përbejnë në tërësi një faktor madhor në kriminalitet.⁵⁸

2.6 Familja.

Familja si bashkësi dhe institucion i veçantë shoqëror, gjithmon ka pas dhe tani ka detyrë zakonishtë të rëndësishme dhe të shumfishta në formimin, edukimin, ngritjen zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet e sisdomos fëmijëve dhe të rinjve për të mirat e njerëzimit dhe armatosje me dije e njohuri kundër kriminalitetit. Në familje zakonisht krijohen kushte që fëmijët dhe të rinjtë të formohen dhe aftësohen për jetë si personalitete të pavarur, urë e lidhës se individit me botën e jashtme me ambientin ku jeton dhe vepron njeriu. Familja,

⁵⁸ Po aty fq. 252.

varësisht nga të qenët i kushtëzuar nga rrethanat a nga shkaqët e caktuara dhe nga shkalla e realizimit të funksioneve të ndryshme që ka, nga ajo varet edhe suksesi apo mosuksesi i formimit dhe zhvillimit normal të anëtarëve të rinjë të familjës. Familjët me raporte normale dhe familjet e shëndosha, këto detyra dhe funksione i kryejnë me sukses. Mirëpo, disa familje, sidomos të ashtuquajtura “familje problematike dhe familje të shkatërruara”² shpesh herë këto funksione nuk i kryejnë si duhet dhe bëhen burim i shumë dukurive negative dhe sjelljeve kriminale. Lidhur me rëndësin dhe rolin e familjes në formimin e personalitetit të njeriut dhe zhvillimit normal dhe harmonik të tij, që nga koha e fëmijërisë e deri në moshën e shtyrë në literaturë shpesh përmendet një mendim – sentencë e shkrimtarit të madh Leon Tolstojit të shkruar në romanin e tij “Ana Karenina”, “se të gjitha familjet fatlume i ngjajnë njëra tjetrës, ndërsa familjet fatkeqe janë si të tilla në mënyrën e vet” Të familjet e tilla, në këtë mënyrë dëshirohet fuqishëm të tregohet roli i familjes në shoqëri dhe rëndësia e marrëdhënieve të mira dhe të shëndosha në familje për gjëndjen e mirë materiale dhe shpirtërore të anëtarëve të familjes e sidomos të fëmijëve dhe të rinjëve gjatë funksionit të vet të formimit dhe të ngritjes së anëtarëve të vet, e gjithë këtë familja e arrinë duke u kujdesur për marrëdhënie dhe raporte normale, në mes të anëtarëve të familjës, në mes prindërve dhe fëmijëve, në mes burrit e gruas, gjegjësisht bashkëshortëve.⁵⁹

Persona që vijnë nga familje deficiente, problematike, të degraduaranë të gjithë Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjithashtu edhe në Dibër janë të prirur të miren me sjellje devijante dhe shpesh herë i hasim si pjesmarrës në veprat penale të vjedhjes.

2.7 Shkolla dhe ambienti shkollor.

Gjithashtu është një faktor me rëndësi të madhe në zhvillimin, aftësimin dhe edukimin e individit pas familjes. Ambienti shkollor u mundëson fëmijëve që të mësohen si të sillen në familje dhe në shoqëri, ato në shkollë fitojnë dituri, përparojnë me njohuritë e arritjeve shkencore e kulturore etj. Arsimimi ka rëndësi të madhe në zhdukjen e sjelljeve negative në shoqëri, mirëpo ka raste kur edhe në shkollë paraqiten probleme që ndikojnë në menyrë negative të sjelljet e fëmijëve dhe konsiderohen si faktor kriminogjen. Në shumë vende të botës, sidomos në ato të pazhvilluara nëpër shkolla programet e arsimimit nuk i kanë në nivel të duhur, kanë mungesa të mjeteve dhe gjithë këto ndikojnë që të bie niveli i arsimimit dhe edukimit në tërësi dhe kështu nxënësit fillojnë të braktisin orët mësimore dhe kthehen kah veprimet dhe sjelljet delikvente.⁶⁰

Në vijim do të paraqes një tabelë në me të dhënat statistikore lidhje me numrin e përgjithshëm të nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

⁵⁹ <http://juridiksi.e-monsite.com/blog/analiza-dhe-opinione/familja-faktor-me-rendesi-ne-aftesimin-e-personalitetit-kunder-kriminalitetit.html>

⁶⁰ Ragip Halili Kriminologjia botimi i shtatë Prishtinë 2011 fq.283.

Tabela nr10.

	2017/2018
Numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm	422
Nxenesit që braktisën shkollën në vitin e parë	161
Nxenesit që braktisën shkollën në vitin e dytë	123
Nxenesit që braktisën shkollën në vitin e tretë	77
Nxenesit që braktisën shkollën në vitin e katër	38

Në këtë tabelë kemi paraqitur statistika të numrit të nxënësve që braktisin shkollën per vitin 2017 -2018, të marra nga enti shtetëror për statistika i RMV.

Numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm për këto dy vite është 422, në vitin e parë e kanë braktisur shkollën gjithsej 161 nxënës, në vitin e dytë e braktisën arsimin e mesëm 123 nxënës, në vitin e tretë e braktisën 77 nxënës, kurse në vitin e katërt e braktisën shkollën 38 nxënës, sic e shohim numri më i madh i nxënësve që braktisin arsimin e mesëm është shënuar në vitin e parë, kjo është një fakt tepër shqetësues për shkak se fëmija i paarsimuar është i prirur që të mirret me kriminalitet.

2.8 Mjedisi social.

Edhe mjedisi social është një faktor që ka ndikim në personalitetin e njeriut, pasi qe një kohë të gjatë të jetës personi e kalon në mjedis shoqëror. Mjedisi social mund të konsiderohet si faktorët i cili ka ndikim më të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale se sa familja dhe shkolla. Sepse fëmijët të miturit dhe të rinjtë një kohë të konsiderueshme të aktivitetit të tyre të lirë e kalojnë jashtë shtëpisë, ne rrugë, në lagje të caktuar. Aty kanë rast të kontaktojnë, të shoqërohen me moshatarë të tyre të cilët në pjesën më të madhe janë korrektë dhe kontaktet e tyre janë të mirëseardhura. Mirëpo shpeshherë ndodh që fëmijët dhe të miturit kontaktojnë dhe me persona të tjerë që janë problematikë dhe të rrezikshëm të cilët ndikojnë negativisht.⁶¹ Kështu ndodh që edhe fëmijët e tjerë duke u shoqëruar me ta të mësojnë sjelljet dhe rugën devijante. Këta fëmijë problematik shpesh herë i hasim si pjesmarës në veprat penale të vjedhjes dhe jo vetëm.

2.9 Bixhozi.

Bixhozi është një lojë fati e cila ndryshe quhet edhe lojë hazarde, lojë me rrezik, lojë me zare etj Edhe bixhozi luan nje rrol shume te rrendesishem ne paraqitjen e kriminalitetit vecanerisht kriminaliteti të vjedhjes . Bixhozi është një lojë fati ku personat dëshirojnë që me pak angazhime dhe te holla te fitojnë shume para, dhe kjo behet shprehi dhe dalengadale kalon në

⁶¹ Po aty fq. 286.

sëmundje, varshmeri dhe patologji. Ne fillim kjo sëmundje ka të bëjë vetëm me personin që luan bixhoz, më pas ajo shëndrrohet në sëmundje dhe problem familjar dhe social. Si pasojë e kesaj viktimat e sëmundjes të bixhozit në të shumtën e rasteve mbesin pa të holla dhe janë të prirur të përfshihen në kriminalitet për sigurimin e të hollave për të ushtruar veprimtarinë e bixhozit. Mirren me vjedhje plackitje grabitje e deri të krimet më të rënda.⁶²

3. Narkomania.

Narkomania paraqet dukuri negative e cila manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike.⁶³ Prania e saj e madhe në shoqërinë bashkëkohore, e sidomos marja masovike e të miturve dhe të rinjve me të paraqet rrezik për mbarë shoqërinë njerëzore. Sipas të dhënave statistikore ndërkombëtare dhe nacionale të cilat përcjellin dukuriunë e narkomanisë, sot flitet për shifra prej miliona njerëzish të cilët përdorin drogën dehëse dhe janë bërë viktimë prej saj.⁶⁴

Personat që mirren me drogë mirren me veprime të ndaluara dhe kriminale, ato në të shumtën e rasteve jepen pas kryerjes së krimeve të vjedhjes, plackitjes e thyerjes nëpër dyqane kjo për shkak se droga krijon varshmëri tek këta persona dhe në momentin që mbesin pa të ju duhet që të sigurojnë të holla për ta blerë, dhe kjo i shtyn që të hollat të sigurojnë nëpërmjet vjedhjeve. Në territorin e gjykatës Themelore Dibër numërohen një numër i madh vjedhjesh, vjedhje me thyerje nëpër shitore, vjedhje në automjete nga persona konsumues të substancave narkotike.

4. Të dhëna hulumtuese mbi punimin, disa aktgjykime nga Prokuroria Themelore Publike Dibër.

Në vijim do të paraqesim raste nga praktika gjyqësore të veprave penale vjedhje, vjedhje e rëndë, dhe një kallëzim të hedhur poshtë nga ana e prokurorit për mungesë provash, si dhe të shohim aktgjykimet të marrura nga Prokuroria Themelore Publike Dibër, do të elaborojmë aktgjykimet si dhe do të analizojmë çështjet procedurale, llojet e sanksioneve dhe masat e tjera të shqiptuara në aktgjykim.

Në rastin e parë do të paraqesim një aktgjykim për veprën penale vjedhje nen. 235 të marrë nga Prokuroria Themelore Publike Dibër, aktgjykimi K.nr.15/2014. Do të bëhet një analizë këtij aktgjykimi, do analizohen çështjet procedurale, lloji i sanksionit të shqiptuar, dhe profili i kryerësit.

⁶² Po aty fq. 317.

⁶³ Ragip Halili Kriminologjia botimi i shtatë Prishtinë 2011 fq. 307

⁶⁴ Po aty fq. 313.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË!

GJYKATA THEMELORE NË DIBËR si gjykatë penale e shkallës së parë përmes gjykatëses Jelena Martinoska , si gjykatëse individuale , me procesverbaliste Dijona Jajaga , në lëndën penale kundër të akuzuarit F....s P..... nga f . M.... - Durres R. e Shqipërisë , për veprën penale - Vjedhje sipas nen 235 paragraf 1 të Kodit Penal , sipas aktakuzës KO.nr. 110/2013 të datës 01.10.2013 të PTHP në Dibër , pas shqyritimit kryesor të mbajtur gojor dhe publik në prani të Prokurorit Themelor Publik Petko Vasilevski dhe të akuzuarit , dhe në mungesë të përfaqësuesit të Myftinisë të Bashkësisë Muslimane në Diber , sot me datë 18.03.2014 , solli dhe shpalli publikisht këtë :

AKTGJYKIM

I AKUZUARI :

F.... P.... nga babai L.... dhe nëna L..... , lindi . C.... , i lindur më 24.04.1980 në f. m..... - Komuna Peshkopi . Republika e Shqipërisë , jeton në f. Komuna Durrës , Republika e Shqipërisë , me arsim tetëvjeçar të kryer , i papunë , shqiptar . shtetas i Republikës së Shqipërisë , i dënuar me Aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër K.nr.14 / 13 të datës 28.03.2013 , për veprën penale Vjedhje e rëndë sipas nen 236 paragraf 1 p . 1 të KP , me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 - një viti , për veprën penale - Vjedhje e rëndë sipas nen 236 paragraf 1 . p .1 të KP , me Aktgjykim të Gjykatës Themelore Diber K.nr.26 / 13 të datës 28.03.2013 . me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 - një viti , për veprën penale Vjedhje e rëndë sipas nen.236 paragraf : 1 të KP . dhe Aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër kr.30 / 13 datë 30.04.2013 me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 - tetë muaj . për veprën penale Vjedhje e rëndë sipas nen 236 paragraf . 1 p.1 të KP . realizohet procedurë për vepra të tjera penale , mbrohet nga burgu .

SHPALLET FAJTOR

PËR ARSYE SE :

Me datë 16.05.2011 me qëllim që të marrë sende të huaja të tundshme dhe të njejtat t'i përvetësojë në mënyrë të kundershtueshme , ka hyrë në pjesën e pandërtuar të oborrit të xhamisë " Teqe " që gjendet në nr . " Liman Kaba " , dhe nga një paletë druri ka marrë 25 thasë cimento të bardhë markë " Titan " në vlerë prej nga 400,00 denarë për thes ose gjithsej 10.000,00 denarë , vlerë me të cilën e ka dëmtuar Myftininë pranë Bashkësisë Islame të RM. Me veprimet e lartpërmendura i akuzuari F.... P.... nga f komuna Durrës R e Shqipërisë , ka kryer një veprën penale - Vjedhje sipas nen 235 paragraf . 1 të KP .

Per kete arsye gjykata në pajtim me nen . 1,4,32,33,34,35 , 39 dhe nen 235 paragraf . 1 të KP , e

DËNON

Me denim me burg në kohëzgjatje prej 3 - tre muaj .

DETYROHET : I akuzuari F.... P.....nga f Komuna Durres R. Shqipërisë që të paguajë paushalin penal ne vlerë prej 2.000,00 denarë , në afat prej 15 dite , pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me nen 89 parag 2 p.6 te LPP , në llogarine 10.....095. që i takon Buxhetit te RM , banka e pranuesit - BP e RM . shfra e te hyrave 72...32. programi 20. llogaria e shfrytëzuesit buxhetor - njësia përdoruese631-16 , ndërsa një kopje nga virmani për shpenzimet paushale të paguara të dorezohet ne Gjykatën Themelore Dibër , ndërsa për dëmkerkese nuk eshte vendosur pasiqe Myftinin e Bashkësisë Islame në Dibër , nuk paralajmëroi dërkërkesë kundër të akuzuarit , në pajtim me nen . 102 te LPP .

Arsyetim

Prokuroria Themelore Publike në Dibër kësaj gjykate i parashtrori propozim - akuzë nën KO.nr. 110/2013 datë 01.10.2013 , kundër të akuzuarit F.... P.... nga f Komuna Durrës R. e Shqipërisë , për vepër penale - Vjedhje sipas nen.235 parag.1 te KP . sipas të ciles eshte sjelle Aktgjykim i kesaj gjykate nën k. nr. 80/2013 date 22.10.2013 , me te cilin ne pajtim me nen 368 parag.1 p.1 te LPP . i akuzuari eshte liruar nga akuza , por pas aktgjykimit lirues të sjelle PTHP në Dibër ka deponuar ankesë sipas të cilës Gjykata e Apelit ne Gostivar , me Aktvendim KZH.nr.24 / 14 date 12.02.2014 , e ka miratuar ankesën , aktgjykimi Eshte shfuqizuar dhe lenda eshte kthyer në rigjykim , e rievidentuar nën Kinr.15 / 14 .

Ne shqyrtimin kryesor datë 18.03.2014 . përfaqësuesi i akuzës Prokurori Publik në Dibër . Petko Vasilevski mbajti qëndrim si në akuzën e parashtruar dhe në fjalën perfundimtare të dhënë në shqyrtimin kryesor date 22.10.2013 , sipas lendes K.nr.80 / 13 , në te cilen mbajti qendrim si ne akuzën e parashtruar deri në shqyrtimin kryesor , pasiqë konsideron se nga provat e nxjerra në shqyrtimin kryesor , a veçanërisht nga ekspertiza me shkrim e gjurmëve te peshtymes nga mbetjet e cigareve nen nr 22.7-61432 / 1 date 20.05.2013 te Sektorit për Krimteknike pranë MPB të RM , rrjedh se i akuzuari F P e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet , ndërsa mbrojtja e të akuzuarit se pse eshte gjetur mbetja e cigareve ne vendin kryerjes se veprës penale , është pasiqë ka kaluar rastesisht , për çka mbrojtja e tille sipas Prokurorit Publik eshte dhene me qellim që t'i shmanget përgjegjësisë penale dhe prandaj propozon që i akuzari te shpallet fajtor dhe te dënohet me sanksion penal te parashikuar për atë vepër penale , dhe gjate kesaj gjykata të ketë parasheh se i akuzuari F.. P.. esht kryerës i shpeshtë i veprave të këtilla penale , për të cilat kjo gjykatë i ka shqiptuar dënime me burg .

I akuzuari F... P... , në mbrojtje të tij theksoi përsëri mban qëndrim si në mbrojtjen e dhënë tanimë , nuk e pranon veprën penale për të cilën ngarkohet , shpreh pakënaqësi nga Aktgjykimi

i shkallës së dytë , prandaj sa do që të dënohet , mund t'i shqiptohet dënim me burg prej 10 vjet , por eshte kategorik se veprën penale nuk e ka kryer . është i revoltuar që duhet të vuajë dënim me burg për vepër që e ka kryer person tjetër dhe nëse i shqiptohet dënim me burg , ai do të vuajë burgun për person tjetër , i cili me cimenton e vjedhur ka ndërtuar shtëpi .

Kjo gjykatë pas nxjerrjes së provave të propozara me dëgjim të të akuzuarit F... P... , me lexim të Ekspertizës të gjurmëve të pështymës të mbetjve të cigareve te përgaditur nga Sektori për Krimteknikë pranë MPB te RM nr.22.7-61431 / 1 datë 20.05.2013 , me lexim të Proceverbalit për kqyrje në vendngjarje me nr . evidentues 454 date 26.09.20213 . të përpiluar nga SP Dibër dhe kqyrje fotodokumentacionin nr.31.3.7-98 të përpiluar nga KTS pranë NKRR në SP Dibër , dhe duke i vlerësuar të gjithë këto prova në kuptim të nen.15 të LPP . e konstatoi gjendjen faktike vijuese :

I akuzuari F... P... ka lindur në vitin 1980 në f Peshkopi R. e Shqipërisë , ndërsa jeton në f Komuna Durrës R. e Shqipërisë , ka kryer shkollimin tetëvjeçar , nuk eshte i punësuar dhe me Aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër K.nr.14 / 13 të datës 28.03.2013 , për vepër penale Vjedhje e rëndë sipas nen.236 parag . I p.I te KP , është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 - një viti , për vepër penale - Vjedhje e rëndë sipas nen.236 parag . 1 p.1 te KP , me Aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër K.nr.26 / 13 të datës 28.03.2013 , me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 - një viti , për vepër penale Vjedhje e rëndë sipas nen.236 parag . 1 të KP . dhe Aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër K.nr.30 / 13 date 30.04.2013 me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 - tetë muaj , për vepër penale - Vjedhje e rënde sipas nen.236 parag . 1 p.1 të KP , zhvillohen procedura edhe për vepra të tjera penale dhe gjendet në vujatje te dënimeve të shqiptuara në EPN Idrizovë në Shkup .

I akuzuari F... P.... , me datë 16.05.2011 , pa u vërrejtë nga askush nga pjesa e pandërtuar e oborrit të xhamisë " Teqe " që gjendet në rr . " Liman Kaba " në Dibër nga një paletë druri ka marrë 25 thasë cimento të bardhë marke " Titan " në vlerë prej nga 400,00 denare për thes ose vlera e përgjithshme e cimentos së marrë është 10.000,00 denarë , vlerë me te cilen e ka dëmtuar Myftininë pranë Bashkësisë Islame të RM .

Gjendjen faktike te mësipërme gjykata e konstatoi nga të gjitha provat e nxjerra në shqyrtimin kryesor , duke i vlerësuar çdo provë në veçanti , por edhe në një tërësi .

Kështu nga ekspertiza e përgaditur nga Sektori për Krimteknikë pranë MPB te RM . vertetohet se ne Sektor janë dorëzuar dy mbetje cigaresh marke " Rodeo " , te gjetura në vendin e vjedhjes pas kqyrjes së vendngjarjes , është kryer ekstraksioni në nje pjese te pjesës mbaruese të mbetjeve të cigareve të dorëzuara dhe ekstraktet e fituara janë analizuar me zbatimin e testeve Phadebas për praninë e gjurmëve të pështymës dhe pas reaksioneve pozitive të fituara , mbetjet e e gjurmëve të pështymës u janë nënshtruar analizave të ADN . Në bazë të rezultateve

te fituara është kryer identifikimi i ADN së materialit biologjik të ekzaminuar dhe gjatë kësaj është vërtetuar se gjurmët e pështymës të lëna në mbetjen e njëres nga cigaret rrjedhin nga personi mashkull , ndërsa gjurmët e pështymës të mbetjes së cigares së dytë rrjedhin nga personi tjetër mashkull dhe janë dorëzuar për identifikim . Pas futjes në koleksionin e profileve për kërkim automatik për ADN profilin e fituar nga gjurma e pështymës e lëna në mbetjen e dytë të cigares është konstatuar përputhshmëri me gjurmën e pështymës të marrë nga brisi i zgavrës gojore të marrë nga i akuzuari F.... P..... (me probabilitetet 99.9999 %) . nëse përjashtohet mundësia për ekzistimin e binjakut njëvezor .

Nga Procesverbali për kqyrjen e kryer në vendngjarje me nr . evidentues 454 date 26.09.2013 , i përpiluar më datë 16.05.2011 në SP Dibër , vërtetohet koha e kryerjes së veprës penale dhe kqyrja e kryer në vendngjarje , sendet që janë marrë , gjurmët e marra nga vendi ngjarjes , ndërsa nga ana e KTS pranë NKKR në SP Dibër është bërë fotodokumentacioni , nga fotografitë e të cilit shihen qartë gjurmët e shputave si dhe dy mbetje cigaresh të gjetura në vendin e vjedhjes së kryer , që ishin lëndë e Ekspertizës të objektit në Teqe .

Nga gjendja e këtyre faktike e konstatuar paraprakisht , gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit F.... P.... , përbahen të gjitha elementet që përbëjnë veprën penale - Vjedhje sipas nen . 235 parag . 1 të KP . pasi që i akuzuari F....P..... , me qëllim që në mënyrë të jashtëligjshme të përvetësojë sende të tundshme , pa u vërrejtë nga askush ka hyrë në oborrin e xhamisë " Teqe " që gjendet në rr . " Liman Kaba " në Dibër dhe në pjesën ku janë kryer punët ndërtimore ka marrë 25 thasë cimento të bardhe marke " Titan " në vlerë prej nga 400,00 denarë për thes ose vlera e përgjithshme e cimentos së marrë është 10.000,00 denarë , vlerë me të cilën e ka dëmtuar Myftininë e Dibrës pranë Bashkësisë Islame të RM .

Gjykata pasi konstatoi ekzistimin e veprës penale dhe fajësinë e të akuzuarit , por nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ekzistimin e veprës penale dhe fajësinë , të akuzuarin F... P.... e shpalli fajtor dhe e dënoi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 - tre muaj , dënim me të cilin mund të pritët se do të plotësohet qëllimi i dënimit në pajtim me nen.32 te KP . Gjate llogaritjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal gjykata kishte parasysh të gjitha rrethanat që janë me ndikim në kuptim të nen.39 te KP , prandaj si rrethana lehtësuese të cilat qëndrojnë në anën e të akuzuarit është vetëm gjendja e tij e rëndë materiale . Nga ana tjetër gjykata i vlerësoi edhe rrethanat rënduese , dhe atë llojin e veprës penale , se i akuzuari është kryerës i më shumë veprave penale , shpeshësinë e këtij lloji të veprave penale , si dhe ndikimin preventiv të tjeret që të mos kryejnë vepra të këtyra dhe vepra të tjera penale .

Gjykata me kujdes dhe në mënyrë kritike e vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarit i cili në mënyrë kategorike pohon se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet , por mbrojtjen e tillë gjykata e hodhi poshtë si të pabaze , kundërthënëse me provat e nxjerra në shqyrtimin kryesor dhe e drejtuar kah ajo që nga vetja të përjashtojë përgjegjësinë penalo juridike .

Gjykata e detyroi të akuzuarin F... P... , nga f Komuna Durrës R. e Shqipërisë , të paguajë shpenzimet penale në vlerë prej 2.000,00 denarë , në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit , në pajtim me nen 89 parag.2 p.6 te LPP , ndërsa për demkërkesën nuk është vendosur , pasi që Myftinia e Bashkësisë Muslimane në Dibër nuk paralajmëroi demkërkesë kundër të akuzuarit në pajtim me nen . 102 te LPP .

GJYKATA THEMELORE DIBËR K.nr.15 / 14 datë 18.03.2014

Procesverbaliste

Diana Jajaga d.v.

GJYKATËS

Jelena Martinoska d.v

UDHËZIM : Kundër ketij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 8 ditë nga dita e pranimit përmes kësaj gjykate drejtuar Gjykatës së Apelit në Gostivar.

Kopje për palët.

Në këtë aktgjykim vërejmë se i pandehuri me qëllim që të mer sende të huaja dhe ti përvetësojë në mënyrë të kundërligjshme ka hyrë në një xhami dhe e ka dëmtuar atë gjithsejt 10.000,00 denarë, vepër kjo që e shpall fajtor të pandehurin për veprën penale vjedhje sipas nenit 235 paragrafi 1 të kodit penal, dhe gjykata e dënnon me burgim në kohëzjatje prej 3-tre muajsh. Këtë dënim Gjykata e bazon në nenet 1,4,32,34,35,39 dhe nenin 235 paragrafi 1 të kodit penal. Sa i përket këtyre neneve neni 1 ka të bëjë me ligjshmërinë në përcaktimin e veprës penale dhe parashikimin e sanksioneve penale ku thuhet se: " Askujt nuk mund ti shqiptohet dënim ose ndonjë sanksion tjetër penal për vepër, e cila para se të kryhet nuk ka qenë e caktuar me ligj apo me marveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut si veprë dhe për të cilën nuk ka qenë i paraparë dënim me ligj". Neni 4 është për sanksionet penale ku thuhet se: "Sanksione penale janë:dënimet, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese."

Neni 32 ka të beje me qëllimin e ndëshkimit ku thuhet: "Përpos realizimit të drejtësisë, qëllimi i ndëshkimit është: 1)pengimi i kryerësit të kryejë vepra penale dhe riedukimi i tij dhe 2) në mënyrë edukative të ndikojë tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale."Neni 34 është për ligjshmërinë në shqiptimin e dënimit ku thuhet: "(1) Kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i caktuar për veprën e kryer penale, por ndëshkim më i butë nga i caktuari mund të shqiptohet vetëm në kushte të parapara me këtë kod. Dhe paragrafi (2) Për vepra penale të

kryera nga leverdija personale mund të shqiptohet dënim me të holla si dënim dytësor dhe kur nuk është caktuar me ligj ose kur është caktuar me ligj se kryerësi do të dënohet me dënim me burg ose me gjobë, kurse gjykata si dënim kryesor do të shqiptojë dënimin me burgim.” Neni 35 i përcakton dispozitat në lidhje me burgimin ku thuhet:”(1)Burgimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë as më i gjatë se 20 vjet. Për veprat penale për të cilët është paraparë edhe dënim me burgim të përjetshëm, mund të shqiptohet dënim me burgim afatgjatë prej 40 vjet. Paragrafi (2) Nëse për vepër penale e kryer me dashje është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 vjetësh, për forma të rënda të asaj veprë mund të caktohet edhe burgim i përjetshëm. Paragrafi (3) Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesor. Paragrafi (4) Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet kryerësit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 21 vjet të jetës. Paragrafi (5) Burgimi shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse deri në 6 muaj edhe në ditë të plota. Paragrafi (6) Kur për veprat penale është paraparë burgim pa theksuar masën më të vogël, kurse masa më e madhe nuk është më shumë se 3 vjet, përpos atij dënimi detyrimisht përcaktohet edhe dënimi me të holla. Paragrafi (7) Burgimi vuhet në institucione për vuajtjen e dënimit të caktuara me ligj.” Neni 39 i përcakton rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit ku thuhet: “Paragrafi (1) Gjykata do të caktojë masën e ndëshkimit kryerësit të veprës penale në kufijtë e caktuar me ligj për atë vepër, duke pasur parasysh përgjegjësinë penale të kryerësit, peshën e veprës dhe qëllimet e ndëshkimit. Paragrafi (2) Gjykata do të ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë, dënimi të jetë më i madh apo më i vogël (rrethanat lehtësuese dhe rënduese), vecanërisht shkallën e përgjegjësisë penale, motivet pse është bërë vepra penale, fuqinë e rrezikimit apo shkatërimin të së mirës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është bërë vepra, kontributin e viktimës në kryerjen e veprës, jetën e mëhershme të kryerësit, kushtet e tij personale dhe sjelljet e tij pas veprës së kryer penale, si dhe rrethanat e tjera që i përkasin personalitetit të kryerësit. Paragrafi (3) Matjen e dënimit, gjykata e bën duke qenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit. Paragrafi (4) Kur gjykata bën matjen e dënimit, dot merr parasysh atë, vallë vepra penale është kryer në përsëritje, në vecanti dot merr parasysh atë, vallë vepra e mëparshme është i llojit të njejtë si dhe vepra e re, a bëhet fjalë për vepër e vazhduar penale dhe a egziston ekskluzivisht shkallë të lartë të kundërligjshmërisë që në korrelacion me rrethanat tjera nën të cilët është kryer vepra penale, e arsyeton shqiptimin e sanksionit të ashpër. Paragrafi (5) Gjatë matjes së dënimit gjykata vecanërisht do ta merr parasysh atë se vepra penale a është kryer kundër personit apo grup personash ose pasurisë, drejtpërdrejtë apo indirekt, për shkak të përkatësisë së gjinisë, racës,ngjyrës, fisit të tij, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale gjendjes shëndetësore , apo të kujtdo qoftë baze tjetër e paraparë me ligj ose me marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare. Paragrafi (6) Gajtë matjes së dënimit me gjobë, gjykata do ta merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit, duke i marr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit, duke i marrë parasysh më pas edhe të ardhurat tjera, për pasurinë e tij dhe për

obligimet e tij familjare.”⁶⁵

Vërejmë se i njejt person është recidivist dhe ka qenë i dënuar 3 tre herë për veprën penale vjedhje sipas nenit 236 paragrafi 1 pika 1 të kodit penal me aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër, dhe atë dy herë i është shqiptuar dënim me kohëzgjatje prej 1-një viti në aktgjykimet K.nr.26/13 të datës 28.03.2013 dhe K.nr.14/13 të datës 28.03.2013 dhe një herë i është shqiptuar dënim me kohëzgjatje prej 8 tetë muaj për v.p. vjedhje e rëndë sipas nenit 236 paragrafi 1 pika 1 të kodit penal në aktgjykimin K.nr.30/13 datë 30.04.2013.

Vërejmë se pas shqiptimit të dënimit prej 3-tre muajsh detyrohet i akuzuari që të paguajë një paushal penal në pajtim me nenin 89 paragrafi 2 p.6 të Ligjit për procedurë penale.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi vërrejmë se Prokuroria Themelore Publike i ka parashtruar gjykatës propozim akuzë kundër të akuzuarit, dhe ndaj tij është sjellë aktgjykim lirues në pajtim me nenin 368 paragrafi 1p.1 të LPP, dhe pas aktgjykimit lirues Prokurori e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës, dhe Gjykata e Apelit në Gostivar e ka miratuar ankesën dhe aktgjykimi është shfuqizuar dhe lënda është kthyer në rigjykim.

Në aktgjykim vërrejmë se prova kryesorë që e vërteton se i akuzuari është kryerës i kësaj vepre penale janë dy mbejte cigaresh të gjetura në vendin e ngjarjes gjatë kqyrjes së vendgjarrjes, dmth u konstatuan gjurmët e pështymës së kryerësit në mbetjet e cigareve nga identifikimi nëpërmjet ADN, dmth mbetja e pështymës e gjetur në mbetjen e cigareve përputhet me brisin e zgavrës gojore të marrë nga i akuzuari.

Nga procesverbali për kqyrjen e vendit të ngjarjes shohim se është vertetuar koha e kryerjes së veprës penale, sendet që janë marrë gjurmët e marra nga vendi i ngjarjes ndërsa nga ana e krimteknikës pranë Stacionit Policor Dibër është bërë fotodokumentacioni , nga fotografitë e të cilit shihen qartë gjurmët e shputave si dhe dy mbetje cigaresh të gjetura në vendin e vjedhjes së kryer , që ishin lëndë e Ekspertizës.

Dmth nga e gjithë kjo gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit përmbahen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje sipas nen 235. Paragrafi 1 të kodit penal.

Sa i përket profilit të kryerësit të kësaj vepre penale në këtë aktgjykim vërrejmë se është person i cili vjen nga zonat rurale, dmth i lindur dhe banues në fshat, sa i përket përgaditjes arsimore shohim se ai është me arsim tetëvjecar të kryer , dmth person i paarsimuar, sa i përket profesionit është person pa profesion dhe i papunë.

Domethënë nga analiza ime personale vij në një konkluzion se faktorët që kane ndikuar që ky person të jetë pjesmarrës në veprat penale të vjedhjes do ti vecoja: varfëria, papunësia dhe arsimimi.

Papunësia dhe varfëria janë të lidhura me njëratjetrën, gjendja e papunësisë manifestohet me mungesë të ardhurash dhe personi zhytet në varfëri dhe nuk ka mundësi që ti kenaqë apo ti plotësojë nevojat e veta elementare dhe si pasoj e kësaj e vlerësoj se personi në fjalë është

⁶⁵ Afrim Osmani – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime botimi i dytë - Furkan 2015 nenet 1,4,32,34,35,39

përfshirë në kriminalitet.

Sa i përket arsimimit, e kam përfshirë si faktor që ka ndikuar sepse vlerësoj se arsimimi është mjet i fuqishëm për parandalimin e sjelljeve antishoqërore dhe kriminale.

Personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore. Atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe për t'i gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme dhe si pasojë e kësaj përfshihen në sjellje asociale.

Në vijim do të paraqesim rastin e dytë, është një aktgjykim për veprën penale vjedhje e rëndë sipas nenit 236 paragrafi 1 pika 1 të Kodit Penal, aktgjykimi K.nr.33/2016 gjithashtu i marrë nga Prokuroria Themelore Publike Dibër, poshtë aktgjykimit do bëhet një analizë nga ana ime.

Vendimi është i plotfuqishëm
Gjykata Themelore Dibër
29.11.2016

Gjykata Themelore Dibër
Vendimi është i ekzekutueshëm
Me datë 08.12.2016

K.nr.33 / 2016

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË!

GJYKATA THEMELORE NË DIBËR si gjykatë penale e shkallës së parë përmes gjykatësit Oruç Abazovski si gjykatës individual, me procesverbaliste Minushe Ballanca, në lëndën penale kundër të akuzuarit B O nga R. e Shqipërisë, për veprën penale Vjedhje e rëndë sipas nen.236 parag.1 pika 1 te KP, sipas propozimkuzës së parashtruar KO.nr.44 / 2016 date 22.09.2016 te PTHP- Dibër pas shqyrtimit të mbajtur kryesor, gojor dhe publik, në prani të Prokurorit Publik te PTHP - Dibër, Petko Vasilevski, mbrojtësit të të akuzuarit të përcaktuar sipas detyrës zyrtare av. Fitim Kasapi nga Dibra dhe të demtuarit P P dhe në mungesë të të akuzuarit, sot me datë 14.11.2016 solli dhe shpalli publikisht kete:

AKTGJYKIM

I AKUZUARI :

B O, nga babai P..., nena M..., i lindur më 09.08.1991 ne f. Gj.. Peshkopi, R. e Shqipërisë, ku dhe jeton, me kombësi shqiptare, shtetas i R. së Shqipërisë, i dënuar me aktgjykim të Gjykatës

Themelore Diber K.nr.50 / 10 me dënim me burg prej 1 - një viti për vepër penale Vjedhje e rëndë , mbahet procedurë për vepër tjetër penale , i pakapshëm për organet e ndjekjes .

SHPALLET FAJTOR

PËR ARSYE SE :

Me date 16.08.2013 në orën 03,00 ne bashkëkryerje me nje person tjetër te panjohur dhe me qëllim që në mënyrë të paligjshme të marrë sende te huaja te tundshme dhe të njëjtat në mënyrë të jashteligjshme t'i përvetësojë me dhunë është futur në shtepine e te demtuarit P... P.... nga Dibra që gjendet ne rr . Velko Vllahiviq nr.. ne menyre qe , se pari me përdorim te nje sendi të përshtatur metalik me dhunë e ka hapur dhe tërësisht e ka larguar dritaren e vogel prej alumini nga banjoja nga ana e pasme e shtëpisë , Eshte futur mbrenda ku ka kërkuar tërë shtepine dhe ka përmbysur një pjesë të sendeve shtëpiake , që në fund nga xhepat e pantallonave të të dëmtuarit që gjendeshin në dhomën e gjumit ka marrë dy celularë , një markë " Samsung " në vlerë prej 12.000,00 denarë dhe tjetrin " Ajfon -3 " në vlerë prej 12.000,00 denarë , dhe 1.800,00 denarë ose në vlerë totale prej 25.800,00 denarë .

Me veprimet e lartpërmendura i akuzuari B.. O.... nga R. e Shqipërisë , ka kryer vepër penale Vjedhje të rëndë sipas nen . 236 parag . 1 p . 1 të Kodit Penal ,

Gjykata në bazë të rregullave sipas të cilave i akuzuari dënohet dhe me zbatim të dispozitave nga nen.4 . 7 , 32 , 33 , 34 , 35 dhe 39 te Ligjit për ndryshim të KP (G. Zyrtare e RM nr.28 date 06.02.2014) dhe në pajtim me Ligjin për Përcaktimin e Llojit dhe Matjes së Lartësisë së dënimit nga nen.15 , 102 , 105 , 110 , 114 dhe 399 te LPP , të akuzuarin e :

DËNON

ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 2 - DY VJET E 2 - DY MUAJ .

DETYROHET i akuzuari B.... O..... që në pajtim me nen . 102 parag.2 p.6 dhe 7 dhe nen 105 të LPP , të paguajë në emër të paushalit penal shumë prej 2.000,00 denarë , në dobi të mjeteve buxhetore të gjykatës , si dhe detyrohet që të kompenzojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 2.000,00 den për avokatin e angazhuar sipas detyrës zyrtare , në afat prej 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit .

DETYROHET i akuzuari B.... O..... që te dëmtuarit P..... P..... nga Dibra t'i kompenzojë kërkesën pronësore juridike - demin në shumë prej 25.800,00 denarë , në afat prej 30 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me nen . 110 parag ! dhe 2 të LPP .

Arsyetim

Prokuroria Themelore Publike - Dibër i parashtroi kësaj gjykate propozimkuzën KO . nr . 44/2016 date 22.09.2016 kundër të akuzuarit Bl..... Os.... nga R e Shqipërisë , i cili është kryerës i veprës penale Vjedhje e rëndë sipas nen.236 parag.1 p.1 te KP , dhe sipas këtij propozimi është evidentuar lenda penale K.nr.33 / 16 .

Gjykata e miratoi propozimin e Prokurorit Publik të PTHP - Dibër , që i akuzuari të gjykohe në mungesë , në pajtim me nen.365 parag.3 te LPP , duke pasur parasysh se i akuzuari gjendet jashtë , në R. e Shqipërisë dhe është i pakapshëm për organet e ndjekjes , gje që gjykata e vertetoi nga njoftimi i SP Dibër nr . regj.32.5.5 . - 1617 / 2 date 04.11.2016 , pastaj UD Kryetari i Gjykatës , në pajtim me nen.74 parag.5 te LPP me aktvendim K.nr.33 / 16 date 14.11.2016 të akuzuarit i caktoi mbrojtës sipas detyrës zyrtare dhe ate av . Fitim Kasapi nga Dibra.

Në seancën e mbajtur kryesore dhe publike . Prokurori Publik lexoi përmbajtjen e aktakuzës të parashtruar kundër të akuzuarit , dhe në fjalën përmbyllëse theksoi se nga provat e nxjerra në shqyrtimin kryesor , dhe veçanërisht nga ekspertiza e përpiluar nga ana e Sektorit për Ekzaminime Krimo - Teknike dhe Ekspertiza pranë MPB të RM nr . DKT- 1726/2013 padyshim u vërtetua se kryerës i kësaj veprë penale është i akuzuari , prandaj i propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i përcaktohet sanksioni penal që parashihet për këtë vepër penale . Gjithashtu , i propozon gjykatës që ta detyrojë të akuzuarin që të dëmtuarit t'i kompenzojë kërkesën pronësore juridike në vlerë prej 25.800,00 denarë , si dhe gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit penal , gjykata te ketë parasysh faktin se ky i akuzuar tanimë është i dënuar me aktgjykim të Gjykatës Themelore Dibër K.nr.50 / 10 për vepër penale Vjedhje të rëndë dhe është i dënuar me denim me burg në kohëzgjatje prej 1 - një viti si dhe se kundër të njëjtit vazhdon procedurë e re penale për vepër të njëjtë penale .

I dëmtuari P..... P..... paralajmëroi kërkesë pronësore - juridike në shumë prej 25.800,00 denarë , dhe i u bashkangjiti ndjekjes penale kundër të akuzuarit .

Mbrojtësi i të akuzuarit i caktuar sipas detyrës zyrtare av . Fitim Kasapi në fjalën e tij përmbyllëse theksoi : se nga provat e nxjerra në shqyrtimin kryesor të sotëm i propozon gjykatës që gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i lartë ose më i ulët .

Në shqyrtimin kryesor , me propozim të Prokurorit Publik pranë PTHP nxorën provat dhe atë : me dëgjim të të dëmtuarit P..... P..... i pyetur në cilësinë e dëshmitarit dhe nga provat me shkrim dhe atë , u bë kqyrje në fotodokumentacionin e përpiluar nga persona zyrtar pranë SP - Dibër nr.31.3.7-137 , me lexim të procesverbalit për kqyrje në vendngjarje të përpiluar nga

persona zyrtar të SP - Dibër me nr . evidentues 440 datë 24.09.2013 , u lexua ekspertiza nr . DKT - 1726 / 2013 e Sektorit për Ekzaminime Krimo Teknike dhe Ekspertiza pranë MPB të RM , dhe duke i vlerësuar provat e nxjera ndaras dhe si një e tërë , në pajtim me nen.399 te LPP vertetoi këtë gjendje faktike :

I akuzuari B..... O..... është në moshë prej 25 vjet , me vendbanim të përhershëm në P..... , R. e Shqipërisë , është i dënuar , zhvillohet procedure për vepra tjera penale dhe eshte i pakapshëm për organet e ndjekjes . I akuzuari : Me datë 16.08.2013 në orën 03,00 në bashkekryerje me nje person tjetër të panjohur dhe me qëllim që në mënyrë të paligjshme të marrë sende të huaja të tundshme dhe të njëjtat në mënyrë të jashtëligjshme t'i përvetësojë me dhunë eshte futur në shtëpinë e të dëmtuarit P..... P..... nga Dibra që gjendet në mr . Velko Vllahiviq nr.42 në mënyrë që , së pari me përdorim të një sendi të përshtatur metalik me dhunë e ka hapur dhe tërësisht e ka larguar dritaren e vogël prej alumini nga banjoja nga ana e pasme e shtëpisë , Eshte futur mbrenda ku ka kerkuar tërë shtëpinë dhe përmbysur nje pjese te sendeve shtëpiake , qe fund nga xhepat e pantallonave të të dëmtuarit që gjendeshin në dhomën e gjumit ka marrë dy celularë një markë " Samsung " në vlerë prej 12.000,00 denare dhe tjetrin " Ajfon - 3 " ne vlere prej 12.000,00 denare , dhe 1.800,00 denare ose në vlerë totale prej 25.800,00 denare .

Gjendjen faktike si me larte gjykata padyshim e vertetoi nga provat e nxjera ne shqyrtimin kryesor dhe atë : Nga deklarata e të dëmtuarit P..... P..... i pyetur në cilësi të dëshmitarit dhe nga provat me shkrim dhe atë : nga kqyrja në fotodokumentacionin e perpiluar nga persona zyrtar pranë SP - Dibër nr.31.3.7-137 , nga kqyrja në procesverbalin për kqyrje në vendngjarje të perpiluar nga persona zyrtar të SP - Dibër me nr evidentues 440 datë 24.09.2013 , nga ekspertiza nr . DKT - 1726 / 2013 të Sektorit për Ekzaminime Krimo - Teknike dhe Ekspertiza pranë MPB te RM , me të cilat prova u vërtetua koha , vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale në fjalë .

Nga deklarata e të dëmtuarit P..... P..... i pyetur në cilësi të dëshmitarit vërtetohet se dëshmitari - i dëmtuari ditën dhe kohën kritike , pasi gruan dhe djalin e ka dërguar te prindet e saj , rreth orës 23,00 është kthyer në shtëpi dhe pas një ore është shtrirë në dhomën e gjumit dhe pas një kohë ka ndje se në dhomë ka një zhurmë dhe përmes pasqyrës së madhe ka vërejtur dy persona në dhomë , është trembur pasi që njëri person qëndronte mbi të , ndërsa tjetri kërkonte nëpër fiokat e dollapit , ka arritur të ngrihet dhe me zë të lartë ka bërtitur , të dy personat kanë nisur të ikin kah dalja e shtëpisë dhe kanë ikur nëpër rrugën dhe pasi ka kërkuar nëpër shtëpi ka vërejtur se nga xhepat e pantallonave të tij i kanë marrë dy telefona celulare , një marke " Samsung " dhe tjetri " Ajfon 3 " , te dy në vlerë prej nga 12.000,00 dhe gjithashtu i kanë marrë 1.800,00 enarë dhe e kanë dëmtuar në vlerë totale prej 25.800,00 denarë . Në pyetjen e Prokurorit Publik deklaroi se personat nuk i njeh , dhe se në shtëpi janë futur nga ana

e pasme nëntë mënyrë që së pari kanë hypur në një karike prej druri me dhunë e kand hapur dritaren prej plastike në banjën poshtë , dhe pastaj janë futur në shtëpi.

Nga kqyrja ne fotodokumentacionin nr.31.3.7-137 me 34 fotografi të përpiluar nga personat zyrtare në SP Dibër vërtetohet pamja e përgjithshme e vendngjarjes me date 16.08.2013 , respektivisht pjesa e përparme e oborrit dhe shtëpisë pronë e Q.... P..... që gjendet në rr . " V.... VI..... " në të cilën me forcë kanë hyrë persona të panjohur të cilët në kërkim e sipër në ambientet e shtëpisë janë vërejtur nga djali i pronarit të shtëpisë , pjesa e pasme e oborrit dhe shtëpia pronë e Q....i P..... prej ku kryerësit me dhunë janë futur në pjesën e brendshme të shtëpisë , duke hapur paraprakisht dritaren e tualetit në katin përdhese të shtëpisë , dritarja e hapur e tualetit ne katin përdhese , në oborrin e shtëpisë janë gjetur këpucë dhe një çantë tualeti e zbukuruar , të cilat janë përpunuar në krim teknike , nga dritarja e hapur plastike janë gjetur dhe janë siguruar gjurmë nga linjat papilare , né grilen metalike afër gardhit të oborit është gjetur një copë fibër tekstili , e siguruar për shkak të vërtetimit të karakteristikave te saj , material i siguruar dhe i marrë për analize , respektivisht janë siguruar bris nga vende për të cilët dyshohet se kanë qenë në kontakt te drejtëpërdrejtë me kryerësit e veprës penale në kontekst te levizjes se tyre gjate hyrjes dhe daljes nga shtëpia dhe oborri pas vjedhjes së kryer . Në pjesën e përparme të oborrit janë gjetur mbetje cigaresh dhe një shtrafciger që janë marrë për të vërtetuar praninë e gjurmëve me prejardhje biologjike me rendesi identifikimi , është përpunuar dera e hyrjes së koridorit ne katin përdhese te shtepise , janë gjetur dhe janë marrë gjurmë nga vijat papilare , pamja e toaletit në katin përdhese ku kanë hyrë në brendësi të shtëpisë dhe gjatë përpunimit të nje kutie prej druri të zbukuruar janë gjetur dhe janë siguruar gjurmë nga vijat papilare , gjatë përpunimit te dhomes së gjumit në kat , në fiokat e vitrinës së vogël me pasqyrë janë gjetur dhe janë marrë gjurmë të vijave papilare nga gishtërinjte dhe pëllëmba e dorës .

Nga procesverbali për kqyrje në vendngjarje të përpiluar nga persona zyrtar pranë SP Dibër me nr . evidentues 440 date 24.09.2013 vërtetohet se me datë 16.08.2013 në shtëpinë private te Q.... P..... nu Dibër në rr . " V....V..... " nr.42 , në orën 09,00 nga personat zyrtar të SP - Dibër eshte bere kqyrja në vendin e ngjarjes , koha ka qenë ditë me kushte të mira për kqyrje , eshte fotografuar vendngjarja dhe janë marrë gjurmë nga vijat papilare dhe brise nga shumë vende dhe kqyrja ka përfunduar në orën 11,00 .

Nga ekspertiza MPB te RM Sektori për ekzaminime krimo - teknike dhe ekspertiza nr . DKT- 1726/2013 vërtetohet se pas përpunimit fotolaboratorik dhe krimo - teknik , në gjurmët e dorëzuara të vijave papilare dhe nga materialet e dorëzuara , është konstatuar se gjatë krahasimit të rregullt të gjurmëve të vijave papilare të siguruara gjatë regjistrimit krimo teknik të cilat paraprakisht janë futur në sistemin për përpunim automatik të gjurmëve të gishtërinjve

dhe pëllëmbës , është vërtetuar se janë nga gishti i mesëm i dorës së djathtë të personit B..... O..... nga babai P.... , nëna M..... , i lindur më 09.08.1991 në f . Gj.... R. e Shqipërisë ku dhe jeton.

Nga njoftimi nr.reg . 32.5.5 / 1617 / 2 date 04.11.2016 vërtetohet se i akuzuari gjendet në R. e Shqipërisë dhe është i pakapshëm për organet e ndjekjes .

Ne raport me vlerësimin juridik të veprës penale u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit B.... O..... nga R. e Shqipërisë përmbahen të gjithë elemente thelbësore të veprës penale Vjedhe e rëndë sipas nen.236 parag . I p.1 te KP , pasi që u vërtetua se i akuzuari me date 16.08.2013 me qëllim që në mënyrë të paligjshme të përvetësojë sende te huaja të tundshme me tejklimin e pengesave të mëdha ishte futur në shtëpinë e P.... P..... që gjendet në rr . " V....V..... " nr..., në mënyrë që së pari me përdorim të një sendi metalik të përshtatur , me forcë e ka hapur dritaren dhe e ka larguar dritaren e vogël prej alumini te tualetit në anën e pasme të shtëpisë , është futur brenda dhe prej xhepave të pantallonave te te demtuarit që gjendeshin në dhomën e gjumit ka marrë dy telefone celularë ne vlerë prej 24.000,00 denarë dhe 1.800,00 denarë para ose vlerë totale prej 25.800,00 denare.

Ne lidhje me thelbin subjektiv te veprës , i akuzuari të njëjtën e ka kryer me paramendim , me vetedije e ka dëshiruar kryerjen e saj dhe eshte pajtuar me shkaktimin e pasojës .

Gjatë përcaktimit te llojit dhe lartësisë së dënimit me burg , gjykata i kishte parasysh ndryshimet nga nen 39 te Kodit Penal (G.Zyrtare e RM nr.28 date 06.02.2014) dhe në pajtim me Ligjin për Përcaktimin e Llojit dhe Matjes së Lartësisë së Dënimit , kështu që gjykata se pari përcaktoi kategorizimin objektiv te vepres penale e cila kategorizohet në kategorizimin horizontal te 29 - të , dhe pastaj sipas kriterit te jetës së mëpërshme të kryerësit të vepërs penale përcaktoi se vepra penale përcaktohet në kategorinë e dytë vertikale , kështu që për veprën konkrete penale ne kategorinë horizontale eshte paraparë dënim me burg prej 1 - nje deri në 5 - pesë vjet , ndërsa sipas kategorisë vertikale në nivelin e dyte per kete vepër penale eshte përcaktuar dënim me burg prej 18- tetëmbëdhjetë muaj deri ne 30 - tridhjetë muaj me vlerë mesatare të përcaktuar prej 24 muaj . Gjukata në bazë të kriterëve të përshkruara nga nen . 10 dhe 11 të Ligjit për Përcaktimin e Llojit dhe Matjes se Lartësisë se Dënimit dhe pasi e përcaktoi kategorinë horizontale dhe vertikale për veprën e kryer penale , i vlerësoi edhe rethanat lehtësuese dhe rënduese , dhe vërtetoi se te kryerësi i veprës penale mbizotërojnë rethanat rënduese pasi që gjatë evoluimit , të akuzuarit i janë llogaritur 0 - zero rethana lehtësuese dhe 28 - njëzetetete rethana rënduese , dhe duke u nisur nga vlera mesatare e vërtetuar e lartësisë së dënimit prej 24 muaj dënim me burg , pas llogaritjes së rethanave rënduese dhe lehtësuese , gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 dy vjet e 2 - dy muaj , duke e individualizuar lartesine e dënimit kah kufiri i sipërmi përcaktuar në Kodin Penal , dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin për përcaktimin e Llojit dhe

Matjes se Lartësisë së Denimit , dënim me të cilin në mënyrë të arseyshme mund të pritët që të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës së përgjithshme .

Në pajtim 102 parag.2 p.6 dhe 7 të LPP , i akuzuari detyrohet që të paguajë në emer të paushalit giyqësor në dobi të mjeteve buxhetore të gjykatës shumë prej 2.000,00 , si dhe në emer të shpenzimeve penale të procedurës për mbrojtësin e angazhuar sipas detyrës zyrtare av . Fitim Kasapi nga Dibra shumë prej 2.000,00 denarë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmerise se aktgjykimit .

Detyrohet i akuzuari që të dëmtuarit P.....t P..... nga Dibra t'i kompenzojë kërkesën pronësoro - juridike - dëmin në vlerë prej 25.800,00 denarë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me nen . 114 parag . 10dhe 2 të LPP .

GJYKATA THEMELORE DIBËR K.nr.33 / 2016 datë 14.11.2016

Procesverbaliste

Minushe Ballanca d.v.

Gjykatës

Oruc Abazovski d.v.

UDHËZIM: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesë në afat prej 8 ditë nga dita e pranimit përmes kësaj siykate drejtuar Gjykatës së Apelit Gostivar .

VËRREJTJE : Paushali të paguhet në llogarinë 1.....630-95 , llogaria e shfrytëzuesit buxhetor 2901000760-601-10 shifra e të hyrave 724-132-20 dhe një kopje e virmanit të dorëzohet në Gjykatën Themelore Dibër - Sektori Penal .

Dorëzim :

- PTHP - Diber ,
- Te akuzuarit
- Avokatit të të akuzuarit av . Fitim Kasapi
- Të dëmtuarit.

Në këtë aktgjykim vërejmë se i akuzuari në bashkëkryerje me një person tjetër të panjohur është futur me dhunë në shtëpinë e të dëmtuarit me qëllim që të marrë sende të huaja të tundshme dhe të njëjtat në mënyrë të jashtëligjshme të përvetësojë vepër kjo që bjen në kundërshtim me nenin 236 paragrafi 1 pika 1 të kodit penal dmth vjedhje e rëndë. Sic e kemi mësuar dhe shpjeguar më lartë vepra penale e vjedhjes përkufizohet si marrje e pasurisë së huaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj për vete apo personin tjetër.

Në nenin 236 paragrafi 1 pika 1 sic e kemi shpjeguar më lartë thuhet: se nëse vjedhja është kryer me thyerje me dhunë në hapësirat e mbyllura me evitim të pengesave ose në mënyrë tjetër me evitim të pengesave më të mëdha. Veprimet që i ka ndërmarë kryerësi i kanë të gjithë karakteristikat që përshkruhen në nenin 236 paragrafi 1 pika 1 të kodit penal sepse i akuzuari

me përdorim të një sendi të përshtatur metalik me dhunë e ka hapur dhe tërësisht e ka larguar dritaren e vogël prej alumini nga banjoja nga ana e pasme e shtëpisë së të dëmtuarit , është futur mbrenda ku ka kërkuar tërë shtëpinë dhe ka përmbysur një pjesë të sendeve shtëpiake , që në fund nga xhepat e pantallonave të të dëmtuarit që gjendeshin në dhomën e gjumit ka marrë dy celularë , një markë " Samsung " në vlerë prej 12.000,00 denarë dhe tjetrin " Ajfon -3 " në vlerë prej 12.000,00 denarë , dhe 1.800,00 denarë ose në vlerë totale prej 25.800,00 denarë . Domethënë këta veprime të kryerësit i kanë karakteristikat e veprës penale vjedhje e rëndë nën 236 paragrafi 1 pika 1 të kodit penal.

Gjithashtu në aktgjykim vërejmë se kryerësi është recidivist, ka qenë i dënuar edhe më parë për veprën penale vjedhje e rëndë me burgim me kohëzgjatje prej 1-një viti.

Nga gjitha veprimet Gjykata kryerësin shohim se i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2-dy vjet e 2-dy muaj, këtë vendim e ka bazuar në nenet 4,7,32,33,34,35 dhe 39 të kodit penal dhe në përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit nga nenet 15, 102,105,110, 114 dhe 399 të Ligjit Për Procedurë Penale.

Vërejmë së Prokurori Publik ka propozuar që i akuzuari të gjykohet në mungesë duke u bazuar në nenin 365 paragrafi 3 të Ligjit Për Procedurë Penale ku thuhet se I pandehuri mund të gjykohet në mungesë vetëm nëse është në arrati apo nuk është në dispozicion të autoriteteve shtetërore, dhe ka arsye veçanërisht të rëndësishme për ta provuar mungesën e tij. Dhe Gjykata e ka vërtetuar se është i pakapshëm për organet e ndjekjes nga njoftimi i Stacionit Policor Dibër dhe ka miratuar propozimin e Prokurorit.

Në lidhje me thelbin subjektiv të veprës, i akuzuari veprën e ka kryer me paramendim, nga veprimet e tij vërehet se e ka kryer me vetëdije të plotë, ka dëshiruar kryerjen e saj dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së dënimit gjykata është bazuar në ligjin për Përcaktimin e Llojit Dhe Matjes së Lartësisë së Dënimit dhe i ka marrë parasysh të gjitha rethanat lehtësuese dhe rënduese.

Provat që kanë provuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale në këtë aktgjykim janë deklarata e të dëmtuarit dhe provat me shkrim kqyrjen në fotodokumentacionin e përpiluar nga ana e personave zyrtarë të stacionit policor Dibër, kqyrjen në procesverbalin për kqyrje në vendin e ngjarjes, nga ekspertiza e Sektorit për Ekzaminime Krimo – Teknike dhe Ekspertiza pranë MPB të RM. Në fotodokumentacion vërtetohet pamja e përgjithshme e vendit të ngjarjes, dhe nga dritarja dhe disa sende të tjera janë gjetur dhe janë siguruar gjurmë nga linjat papilare.

Sic e kemi mësuar në lëndën Kriminalistika metoda e cila mirret me studimin e vijave papilare është Daktiloskopia e cila është metodë e studimit, e krahasimit dhe e klasifikimit të vijave papilare me qëllim identifikimi të personave në rradhë të parë të kryerësve të krimit në bazë të karakteristikave individuale që ekzistojnë në vijat papilare kreshta në lëkurë, tek figura papilare

e cdo gishti është karakteristikë se nuk ka figura papilare identike, nuk ndryshojnë gjatë gjithë jetës së njeriut dhe rigjenerohen në rast dëmtimi.

Në vijim do të paraqes një Aktvendim për hudhjen poshtë të një kallëzimi penal të parashtruar nga ana e Policisë Dibër për veprën penale vjedhje, pasi nuk egzistojnë baza të dyshimit se i denoncuari e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Këtë aktvendim e kam marrë nga Prokuroria Themelore Publike Dibër dhe e kam përfshirë në këtë punim për shkak se sic e shohim më lartë tek statistikat për veprat penale vjedhje dhe vjedhje e rëndë në rajonin e Dibrës, kemi shumë kallëzime penale të hudhura nga ana e Prokurorit, dhe e pashë të arsyeshme ta përfshij një shembull në këtë punim.

Prokuroria Themelore Publike

KO.nr.84 / 18

04.01.2019

Dibër

A.

Ne bazë të **nen.288** parag . 1 te LPP . sjell :

AKTVENDIM

HUDHET POSHTË kallëzimi penal i parashtruar nga ana e Stacionit të Policisë Dibër , nr.32.4.8-2561 / 1 datë 23.11.2018 , kundër A.... K.... nga Dibra për veprën e kryer penale **Vjedhje sipas nen.235** parag.3 në lidhje me parag . 1 të Kodit Penal .

Pasiqë nuk ekzistojnë baza të dyshimit se i denoncuari e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet .

Arsyetim

Ne kallëzimin penal të parashtruar nga Stacioni i Policisë - Dibër me nr.32.4.8-2561 / 1 date 23.11.2018 kunder A.... K.....nga Dibra , për vepër e kryer penale Vjedhje sipas nen.235 parag 3 ne lidhje me parag.1 te KP , theksohet se me date 24.08.2018 në kohën e pavërtetuar saktësisht , nga pylli pronë e të dëmtuarit I.... K.... që gjendet në f . Konjarë , i denocuari ka marrë sende te huaja te tundshme - drunj akacje dhe atë 5m3 me çka të dëmtuarin e ka dëmtuar në shumen 10.000,00 denarë , Pas shqyrtimit te kallezimit penal dhe akteve të bashkangjitura në të , pas dëgjimit të të denoncuarit A.... K.... në Procesverbalin për ekzaminim të të akuzuarit datë 18.12.2018 , dhe pas degjimit në Procesverbalin për ekzaminim te deshmitarit - te demtuarit I...K... , datë 18.12.2018 , u vërtetua sa vijon : Denoncuesi I... K... ka pyllin e vet me drunj akacje që gjendet ne f Konjare . Dibër , me date 24.08.2018 ka konstatuar- ka parë se në pyllin e tij janë prerë dhe një pjesë janë marrë drunj akacje dhe atë ne sasi prej 5m3 , ndersa para se ta konstatoje - sheh kete , duke shkuar rrugës për ne f . Konjare e ka parë të denoncuarin A.... K....

me automjetin e tij marke Honda i cili vinte nga drejtimi i pyllit te tij dhe te njejtin e ka ndaluar dhe e ka pyetur se ku ka qene dhe se në automjet i denoncuar ka pasur edhe sharrë motorike dhe prandaj mendon se drunjte nga pylli i tij i ka prerë me mënyrë të kundërligjshme dhe një pjesë edhe i ka marre i denoncuari A.... K.... . Nga biseda e kryer me të denoncuarin A.... K... me datë 18.12.2018 në Procesverbalin për ekzaminim të të akuzuarit deklaroi se lidhur me këtë ngjarje penalo - juridike për të cien eshte denoncuar , deklaroi se nuk ka prerë kurfare drunj në pyllin e denoncuesit pastaj deklaroi se ditën e 24.08.2018 kur denoncuesi levizte me traktor e ka ndaluar dhe e ka pyetur se ku ka qenë me automjetin , i njejtin deklaroi se ka qenë në pyllin e personit N.... K.... i cili ka pyll në atë pjesë te fshatit dhe e ka parë që të njëjtin ta merr me qira , pasatj deklaroi se ai nuk i ka prerë drunjte në pyllin e denoncuesit .

Nga biseda e kryer me denoncuesin I.... K.... me datë 18.12.2018 në Procesverbal per ekzaminim të deshmitarit - demtuarit , i njejtin deklaroi se me date 24.08.2018 ai me traktorin e tij ka shkuar në f . Konjare qe te punoje në tokat e tij dhe duke shkuar rrugës për te fushat e tij e ka takuar te denoncuarin me automjetin marke Honda dhe e ka ndaluar dhe e ka pyetur se ku ka qenë pasiqë ka dyshuar dhe e ka njohur qe i njejtin vjedh drunj , por në momentin kur e ka ndaluar i njëjti në automjet nuk ka pasur drunj dhe nuk e ka parë se i ka ngritur drunjte nga pylli i tij .

Nga gjendja e ketille e vërtetuar me veprimet e ndërmarra hetimore , dëgjimin e të denoncuarit dhe degjimin e denoncuesit si dëshmitar - i dëmtuar , si prova , si dhe mospasja e provave tjera verbale dhe materiale , nuk mund te vërtetohet se i denoncuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet , dhe me kete nuk ka baza për dyshim se është kryerës i veprës penale për te cilen akuzohet , prandaj u morr vendimi si në dispozitivin e ketij aktvendimi.

**Prokurori Themelor Publik
Neat Croj**

Një kopje e këtij aktvendimi të dorëzohet në **Stacionin e Policisë në Dibër** dhe të **dëmtuarit I.. K... rr . " A... Z.... " nr.10 Dibër** me çka do të llogaritet se janë informuar për vendimin e kallezimit penal .

Domethënë sic e kemi mësuar në lëndën E Drejta e Procedurës Penale “Kallëzimi penal është akt të cilin, sipas rregullit, mund ta paraqesë i dëmtuari ose cilido nga qytetarët dhe, për veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, duhet ta paraqesin organet shtetërore, në rend të parë policia, kur egziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale. Kallëzimi i drejtohet prokurorit publik kompetent(ndonëse dhe kallëzimi penal i qytetarit i adresuar policisë, gjykatës ose prokurorit publik jokompetent merret dhe menjëherë i dorëzohet prokurorit publik

kompetent)”.⁶⁶

“Prokurori Publik, pasi ta pranojë kallëzimin penal, cmon bazueshmërinë e tij dhe varësisht nga situata mund të vendosë: 1. Ta hedhë poshtë kallëzimin penal. 2. Të kërkon informata plotësuese. 3. Merr urdhër për zbatimin e hetimeve kundër personit të caktuar.

Nëse kallëzimi penal konkludohet se nuk ka të bëjë me veprën penale, nëse vepra penale është parashkruar ose është përfshirë në amnisti ose falje, nëse egzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen ose nuk egziston dyshim i bazuar se i paraqituri e ka kryer veprën penale, Prokurori Publik e hedhë kallëzimin penal me aktvendim. Aktvendimi për hedhjen poshtë të kallëzimit i dërgohet të dëmtuarit me këshillë se mundet që në afat prej tetë ditësh të parashtrojë ankesë te prokurori më i lartë publik, kurse parashtuesi i kallëzimit njoftohet për arsyet e hudhjes poshtë. Prokurori më i lartë publik duhet të vendosë për ankesën e të dëmtuarit në afat prej 30 ditëve nga pranimi i saj, ai mund me aktvendim ta vërtetojë aktvendimin për hedhjen poshtë të kallëzimit ose ankesën ta pranojë ose ta obligojë prokurorin publik më të ulët që ta vazhdojë procedurën”.⁶⁷

Në rastin që e kemi shpalosur kemi të bëjmë me hudhjen e një kallëzimi penal nga ana e Stacionit të Policisë Dibër për veprën e kryer penale Vjedhje sipas nen.235 parag.3 në lidhje me parag . 1 të Kodit Penal pasi që nuk ekzistojnë baza të dyshimit se i denoncuari e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet .

Prokurori Publik e ka marrë vendimin për hudhjen poshtë të këtij kallëzimi për shkak se ka pasur mungesë provash verbale, materiale dhe fakte relevante, vetëm është ndëgjuar i denoncuari dhe denoncuasi, në këto kushte nuk ka baza për dyshim se është kryerës i veprës penale për të cilën akuzohet, dhe kallëzimi penal hudhet poshtë. Aktvendimi është i bazuar në nenin 288 paragrafi 1 të Ligjit Për Procedurën Penale që ka të bëjë me rrethanat për hudhjen e kallëzimit që i kam spjeguar më lart.

Kapitulli i IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale të vjedhjes.

Në vazhdim do të meremi me shqyrimin e disa faktorëve kryesorë që i kam vecuar për ndikimin e tyre në parandalimin e veprave penale të vjedhjes. Në këtë drejtim do të flitet për rolin shkollës, familjes , rolin e mjeteve të informimit , rolin e organizatave joqeveritare , rolin e policisë, rolin e prokurorisë dhe gjykatës në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Me parandalimin e kriminalitetit në praktikën e politikës kriminale bashkëkohore, merren shumë organe shtetërore, shoqëri dhe institucione, si forca të posaçme preventive, të cilat konsiderohen si bartës të kësaj veprimtarie. Në procesin e luftimit preventiv të kriminalitetit është me rëndësi të madhe të përcaktohen prerazi dhe konkretisht rolet, detyrat dhe qëllimet e

⁶⁶Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli E drejta e Procedurës penale e Republikës së Maqedonisë Shkup 2017 fq.124

⁶⁷ Po aty fq. 224.

subjekteve të caktuara të aktivitetit parandalues.⁶⁸

Për ta penguar dhe parandaluar kryerjen e veprave penale të vjedhjes pikë së pari duhet të studiohen dhe analizohen me përpikmëri faktorët që ndikojnë në paraqitjen e kësaj vepre penale, gjë që e kam bërë më lartë në kapitullin 3 të këtij punimi.

2. Roli i shkollës në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Shkolla trajtohet si një institucion që ka forcë të madhe ndikuese, jo vetëm në aspektin e edukimit dhe të ngritjes kulturore, por edhe në aspektin e zhvillimit emocional dhe intelektual në formimin e tërësishëm të strukturas së personalitetit të njeriut. Në këtë aspekt, ajo ka përparësi të jashtëzakonshme dhe mundësi të pakufizuar, sepse ka kontakte me pjesën më të madhe të rinisë, që nga rinia e hershme e deri në moshën e pjekurisë. Pasi fëmijët qëndrojnë për një kohë të gjatë në shkollë, arsimtarët kanë rast t'i vërejnë pa vështirësi simptomat e papërshtatshmërisë, kurse në raste të veçanta edhe mund të përcaktojnë parashikimin e trajtimit individual të tyre që i shfaqin karakteristikat e papërshtatshmërisë në sjelljet e veta. Për këtë arsye, shkolla është në gjendje t'i korigjojë devijimet psikike e të tjera të të rinjve të caktuar dhe t'i orientojë drejt.⁶⁹

Shkolla si institucion edukativo – arsimor, pra luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e veprave penale të vjedhjes, pasi që edukatorët apo mësuesit dhe profesorët në institucionet arsimore kanë një ndikim të madh të nxënësit për ti edukuar dhe për ti larguar nga sjelljet antishoqërore me anë të programeve arsimore të cilat zbatohen në këto institucione arsimore. Pra, shkollat janë ata të cilat kanë një rol të veçantë në uljen e numrit të sjelljeve kriminale.

3. Roli i familjes në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Familja është grup themelor i shoqërisë që, varësisht prej zhvillimit shoqërorë-ekonomik mbledh rreth vetes njerëz të lidhur me martesë dhe pasardhësit e tyre eventualisht një rreth më të gjërë ose më të ngushtë njerëzish të një gjaku ose me lidhje të tjera, të cilët bashkohen me qëllim që t'i kënaqin nevojat e veta të ndryshme biologjike, (lindjen dhe rritjen e fëmijëve) ekonomike, sociale, edukative, emotive etj. Familja, si bashkësi shoqërore, paraqet faktorin më me rëndësi në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut. Familja, si institucion i veçantë shoqërorë, përherë ka pasur dhe tani ka funksione dhe detyra të shumfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos fëmijëve dhe të rinjëve. Ajo paraqitet si bashkësi shoqërore, njësi shoqërore, si grup parësor shoqëror, me të cilin njeriu, prej lindjes e deri në vdekje, gjendet dhe qëndron, duke pasur kujdesin dhe mbykëqyrjen e anëtarëve të vet. Familja është bashkësi shoqërore, e cila mbron dhe orienton anëtarin e vet, sidomos fëmijët dhe të rinjtë. Është e ditur se familja paraqet fuqinë më të rëndësishme shoqërore për edukimin e drejtë dhe orientimin jëtesor të të rinjtë. Ajo si instrument më i lartë i kontrollit shoqëror është në gjendje të kujdeset vazhdimisht për fëmijet dhe të rinjtë, të forcojë stabilitetin e tyre psikologjik e të zhillojë tek ata ndjenjën e përgjegjësisë. Kështu familja manifestohet njëkohësisht edhe si fuqi e madhe në prevencionin e

⁶⁸ Vesel Latifi, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.179

⁶⁹ Po aty, fq.198

veprave penale.⁷⁰ Domethënë në familjet e plota, të shëndosha, të rregullta kujdesen për njëritjetrin, edukojnë njëritjetrin dhe fëmijët, dhe ka rrolin më të madh në parandalimin e veprave penale të vjedhjes dhe sjelljeve të ndryshme kriminale.

4. Roli i mjeteve të informimit në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Në drejtim të aktivizimit të opinionit për luftë kundër kriminalitetit rol të rëndësishëm luan edhe informimi i drejtë i qytetarëve në lidhje me sjelljet kriminale në një mjedis të caktuar. Arritja e informimit të qytetarëve në lidhje me këto bëhet në mënyra të ndryshme si mjetet e informimit publik (radio, televizion, filmi, shtypi etj). Roli i tyre është i madh pasi që ato paraqesin një roltë rëndësishëm edukativ. Me qëllim të nxitjes së efekteve pozitive të qytetarëve shtypi nuk duhet të bjerë nën ndikimin e efekteve sensacionale por duhet të jep informata të sakta dhe objektive qoftë në lidhje me kriminalitetin si dukuri por edhe në rastet e posaçme të aktivitetit kriminal. Vetëm me informime të sakta do të zgjohej interesimi pozitiv ndërsa qytetarët përngazhim në dhe rëndësinë e prevencionit shoqëror kundër kriminalitetit.⁷¹ Me të drejtë mund të thuhet se njohja dhe informimi janë kushte të domosdoshme për aftësimin e qytetarëve, të organeve shtetërore dhe të institucioneve për kryerjen e punëve të tyre shoqërore. Arritja e sukseseve të tilla në aspektin e informimit të qytetarëve në lidhje me këto dukuri bëhet në mënyra të ndryshme, ndër të cilat më të rëndësishme janë mjetet e informimit publik (shtypi, radioja, televizioni, filmi etj.). Mjetet e komunikimit masiv në botën bashkëkohore, janë bërë mjete të fuqishme të ndikimit dhe orientimit të opinionit brenda një vendi apo opinionit ndërkombëtar. Për organizimin e aksioneve shoqërore kundër kriminalitetit është më se e nevojshme njohja e karakteristikave të tyre etiologjike, fenomenologjike dhe karakteristika të tjera në mjedisin e caktuar. Çdo aksion supozon një njohuri të caktuar për lëndën e vet e cila shërben si orientim udhëheqës dhe praktik, nëse dëshirohet të shmangen proceset stihike dhe pasojat e tyre. Që të mund të ndërmerret aksioni efikas shoqërorë, është e domosdoshme depërtimi njohës për karakterin rrënjes, shkakut dhe kushteve të kriminalitetit me suazat e dhëna kohore dhe hapësirë.⁷²

Pra edhe mediat e shkruara dhe elektronike kanë një rrol shumë të rëndësishëm në parandalimin e veprave penale të vjedhjes apo sjelljeve devijante, mediat e shkruara dhe elektronike kanë mundësinë dhe fuqinë të ndikojnë dukshëm në minimizim të veprave penale, pasi që me njoftime dhe lajme të ndryshme ato janë shumë më afër qytetarit i cili mund të informohet në çdo kohë për çdo aktualitet në çdo sferë. Mendoj se në vendin tonë, roli mediave të shkruara dhe elektronike nuk ka shumë efikasitet për të ndikuar në parandalimin e kriminalitetit për shkak se më shumë rëndësi u kushtojnë programeve që nuk kanë asnjë ndikim pozitiv tek shikuesit. Ndonjëherë i japin rëndësi rëndësi programeve që ndikojnë negativisht si psh filma me përmbajtje joedukative. Thënë shkurt mjetet e informimit në vendin tonë, kryesisht shqiptare lënë për të dëshiruar.

⁷⁰ Po aty fq.195

⁷¹ <https://www.slideshare.net/dritashala/politika-kriminale-17453261>

⁷² Vesel Latifi, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011 fq.225

5. Roli i organizatave joqeveritare në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Organizatave joqeveritare janë organizime të financuara dhe të mbështetura nga faktorë të ndryshëm joqeveritar e që janë të paramenduara të krijohen për të zgjidhur një problem shoqëror, individual, grupor ose më të gjerë; për të marrë pjesë në jetën publike; për të shfrytëzuar burimet për arritjen e një qëllimi të caktuar.

Në lidhje me karakteristikat e organizatave joqeveritare, mendohet se dominojnë këta përcaktorë: ato janë formalisht të institucionalizuara; janë joqeveritare, janë jofitprurëse; vullnetare dhe, natyrisht, vetëqeverisëse. Ndërsa, sa i përket funksionit të tyre, ai shtrihet në: shoqërimin e qytetarëve në shoqërimin politik të qytetarëve politizimi në mbledhjen e informacioneve në arsimimin e njerëzve për fusha të caktuara në përfaqësim dhe në shtrirjen e ndikimit dhe të mbikëqyrjes. Kështu p.sh organizata joqeveritare me seli në një shtetë tjetër zakonisht paraqiten në shtetin tjetër si organizata joqeveritare ndërkombëtare, mirëpo veprimtaria e tyre në shtetin tjetër varret në shkallë të madhe nga mardhënjet ndërkombëtare të atyre shteteve. Raste të ndalimit apo të mos lejimit të hyrjes në shtetin e vet për shkak të mbështetjeve indirekte qeveritare. Varësisht nga financimi dhe veprimtaria e tyre ato mbështeten apo edhe ndalohen nga qeveritë shtetërore në territoret ku ato veprojnë.⁷³ Cdo vend e ka rregulluar funksionimin e këtyre organizatave me legjislacionin vendas, në Republikën e Maqedonisë së Veriut puna në lidhje me organizatat joqeveritare është e rregulluar në nenin 73 dhe 74 të Ligjit për shoqata dhe fondacione.

Sipas ligjit për shoqatë dhe fondacion, organizatat mund të fitojnë status me karakter publik nëse kryejnë veprimtari me karakter të interesit publik, zbatojnë programe dhe projekte në nivel qëndrorë ose lokal, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me drejtorinë shtetërore dhe organet e komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, si dhe shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve.⁷⁴ Veprimtaritë me karakter publik janë: zhvillimi i demokracisë, shoqëritë civile dhe të drejtat e njeriut, - ndihmë dhe mbrojtje të personave me hendikepe fizike dhe psikike, personat me pengesa të zhvillimit dhe socializimin e tyre, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjtë, mbrojtjen e personave të marginalizuar dhe socializimin e tyre, mbrojtjen nga keqpërdorimi i drogës, sëmundjet ngjitëse seksuale, delikuencën e të miturve, alkoholizmi, prostitucionin dhe tregtinë me njerëz, shëndetësi, zhvillimin në shëndetësi dhe kujdesin mjekësorë, art, kulturë dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore, sporti amator, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm, zhvillimin lokal dhe infrastrukturor, shkencë, arsim dhe trajnime në procesin arsimor, zhvillimin e etikës dhe moralit, ndihmë humanitare dhe sociale, zbutjen e varfërisë, menaxhimi me fatkeqësitë e papritura, mbrojtja dhe kujdesi i kafshëve, mbrojtjen e konsumatorëve, zhvillimin e bamirësisë dhe vullunterizmit, dhe aktivitete tjera me karakter publik të percaktuara me këtë ligj.⁷⁵ Domethënë me vetë faktin se këta organizata janë të krijuara për të zgjidhur probleme të ndryshme shoqërore individuale ose grupore, kanë rrol parandalues edhe në veprat penale të vjedhjes.

⁷³ https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Organizata_joqeveritare

⁷⁴ Ligji për shoqata dhe fondacione i Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁷⁵ Neni 73 dhe 74 i Ligjit për shoqata dhe fondacione i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6. Roli i Policisë në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetërorë. Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqërorë në të gjitha tipet historike shoqërore dhe në të gjitha vendet në botë. Në të gjitha vendet, duke llogaritur edhe shoqëritë bashkëkohore, policia, përveç në aspektin formal, ka të njejtat përcaktime shoqërore dhe përafërsisht kryen të njejtat funksione dhe detyra.⁷⁶

Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale; gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin e personave dhe të sendeve (marrja e shenjave të gishtërinjve, marrja e materialit biologjik për analizë të ADN-së etj.) ofron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve, jep të dhëna nga evidencat e caktuara etj.⁷⁷

Detyra e Policisë së jurispodencës është që sipas detyrës zyrtare ose me urdhër të prokurorit publik të ndërmer masa dhe aktivitetet qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, parandalimit të pasojave të mëtutjeshmetë veprave penale, kapjes dhe denoncimit të kryerësve të tyre, sigurimit të provave dhe masave dhe aktivitetet tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale. Ajo zbaton hetimin dhe veprime të urdhëruara nga gjykata dhe prokuroria publike. Detyrat e sipër caktuara i kryejnë eprorët dhe nëpunësit e policisë së jurispodencës.⁷⁸

Republika e Maqedonisë së veriut e ka ligjin për policinë dhe sipas nenit 3 të ligjit për polici, funksioni themlor i policisë është mbrojtja dhe rrespektimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së veriut, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, mbrojtja e rendit juridik, parandalimi dhe zbulimi i veprave penale, ndërmarrja e masave për ndjekjen e kryerësve të atyre veprave, identifikimi dhe kërkimi direkt dhe në mënyrë të tërthortë të perfitimit pasurorë me kryerje të veprës penale, mbajtjen e rendit dhe qetësisë, rregullimin dhe kontrollin e trafikut rrugor, kontrollin për lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve, kontrollime doganore dhe mbykëqyrje doganore, ofron ndihmë dhe mbrojtje qytetarëve në rast nevojë, siguron persona dhe objekte të caktuara dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.⁷⁹ Domethënë vlen të theksohet se policia ka një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të vjedhjes, njëkohësisht kapjen e kryerësve të tyre, mjafton që të jenë të pregaditur profesionalisht, ta kryejnë punën me ndërgjegje, tju ndihmojnë qytetarëve, të ndalohej marja e rryshfetit dhe korrupsioni brenda

⁷⁶ Vesel Latifi, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011 fq. 112

⁷⁷ Ejup Sahiti & Ismail Zejneli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë Shkup 2017 fq.93, 94.

⁷⁸ Po aty fq. 94.

⁷⁹ Ligji për Policinë i Republikës së Maqedonisë së Veriut neni 3.

polici, ka rrol shumë të rëndësishëm dhe duhet të jetë shumë e kujdesshme dhe vigjilente sepse kallëzimet më të shpeshta bëhen në polici.

7. Roli i Prokurorisë në parandalimin e veprave penale të vjedhjes.

Prokuroria është institucion klasik i judikaturës penale, i cili paraqitet qysh para 150 vjetësh, me qëllim që t'u kundervihet rreziqeve dhe veprimeve inkuizitore, që ka mbrojtur po në ato duar – në duart e gjykatësve – ndriçimin e veprave penale dhe gjykimin sipas tyre.

Në të drejtën e Republikës së Maqedonisë prokuroria publike është organ shtetëror i unisuar dhe i pavarur, i cili ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave tjera ndëshkuese dhe kryen punë të tjera të parashikuara me ligj. Prokuroria publike i kryen funksionet e veta në bazë të kushtetutës dhe ligjit (neni 106 i Kushtetutës së RMV). Mbështetur në nenin 39 të Ligjit për procedurë penale, e drejtë dhe detyrë themelore e prokurorit publik është ndjekja e kryerësve të veprave penale. Në kuadër të realizimit të kësaj të drejte dhe detyre prokurori publik ka mundësi të ndërmer një varg veprimesh konkrete, dmth duhet të ndërmerr masat e nevojshme lidhur me zbulimin e veprave penale dhe gjetjen e kryerësve të këtyre veprave penale dhe të inicojë procedurën penale, në procedurë parahetimore, nën kushtet e përcaktuara me ligj, jep urdhëra për zbatim të masave të posacme hetimore, zhvillon hetimin e veprave penale, ngritë dhe përfaqëson aktakuzë apo propozimakuzë në gjykatë kompetente, bën ankesë kundër vendimeve gjyqësore që nuk kanë formën e prerë dhe paraqet mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Përvec funksionit të hetimit dhe të ndjekjes së veprave penale në procedurë penale në planin e gjerë të luftës kundër kriminalitetit, prokuroria publike ka të drejtë dhe për detyrë ti përcjell dhe ti studiojë marrëdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e funksionit të tyre dhe, për vrojtimit e veta, ta njoftojë Kuvendi ne Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të jep propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforcimin e sundimit të ligjit. Prokuroria publike gjithashtu ka të drejtë dhe për detyrë që ta informojë opinionin lidhur me gjendjen e kriminalitetit dhe për problemet dhe dukuritë tjera me rëndësi të përgjithshme, të cilat i ka vërejtur në punën e vet. Informimi mund të bëhet edhe për rastet konkrete në të cilat vepron, por në kufijtë ligjor dhe në harmoni me interesat e procedurës.

Rregullimi i prokurorisë publike bazohet në disa parime të vecanta: 1. parimi i hierarkisë, 2. parimi i devolucionit, 3. Parimi i substitucionit dhe 4. Parimi i vendosjes në mënyrë monokrate Në vargun e organizimit të prokurorive publike në RMV i hasim këto lloje të prokurorisë: Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokuroritë publike të larta, që themelohen për teritor të një gjykate të apelit, Prokuroritë publike themelore, të cilat formohen për rajon të një apo më shumë gjykatash themelore, dhe Prokuroritë publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.⁸⁰ Prokuroria e Dibrës hyn tek prokuroritë

⁸⁰ Ejup Sahiti & Ismail Zejnli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë Shkup 2017 fq. 91, 92, 93.

publike themelore, të cilat formohen për rajon të një apo më shumë gjykatash themelore. Prokuroria ka një rrol kyç në parandalimin e veprave penale të vjedhjes, vpera penale e vjedhjes është dukuri e dëmshme dhe e rrezikshme për shoqërinë, dhe sic e vërejmë më lartë prokuroria është institucion që është krijuar për tu kundërvënë dhe eliminuar këto dukuri të dëmshme dhe të rrezikshme për shoqërinë.

8. Roli i gjykatës në parandalimin e veprave të vjedhjes.

Gjykatat janë organe shtetërore të pavarura të cilave u përket pushteti gjyqësor. Gjykatat mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat e subjekteve juridike dhe sigurojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale, ajo në procedurë penale ushtron funksionin e gjykimit mirëpo funksioni i saj nuk kufizohet vetëm me funksionin e gjykimit, si organ i pavarur gjykon në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

Sipas nenit 22 të Ligjit mbi gjykatat të RMV pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative, dhe Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është gjykata më e lartë në Republikë dhe ajo siguron zbatimin unik të ligjeve nga ana e gjykatave.

Gjykatat themelore krijohen për një ose më shumë komuna dhe kanë kompetencë lëndore themelore ose të zgjeruar. Gjykata në Dibër është Gjykatë me kompetencë lëndore themelore.⁸¹

Gjykatat themelore me kompetencë lëndore themelore për njësitë për të cilat janë themeluar, sipas nenit 30 të Ligjit mbi gjykatat, janë të autorizuar të vendosin në shkallë të parë për vepra penale dhe për kundërvajtje edhe atë : për vepra penale për të cilat me ligj është paraparë dënim me burg deri në pesë vjet si dënim kryesor , nëse për disa vepra penale nuk është e paraparë kompetenca e ndonjë gjykate tjetër, për veprat penale për të cilat me ligj të veçantë është paraparë kompetenca e gjykatës me kompetenca themelore, të realizojnë hetime dhe veprime hetimore për veprat penale nga kompetencat e veta.⁸² Domethënë edhe gjykata ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e veprave penale të vjedhjes, sepse nëse do kishim mosefikasitet të gjyqësisë, nuk do mund të luftohej kriminaliteti.

⁸¹ Po aty fq. 68

⁸² Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë së Veriut neni 30

9.Të dhëna hulumtuese mbi punimin, statistika të mara nga enti shtetëror për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vijim do të paraqesim të dhëna statistikore të përgjithshme në lidhje me veprat penale të vjedhjes,në lidhje me kryerësit dhe dënimet e shqiptuara për këto vepra në RMV të marra nga enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr.11.

2017			
	Të dënuar	Dënime kryesore	Masa alternative
Vjedhja e energjisë elektrike	627	53	574
Vjedhje	495	173	322
Vjedhja e rëndë	699	401	298
Grabitje	39	32	7
Vjedhje grabitqare	8	7	1

Në këtë tabelë kemi paraqitur statistika të përgjithshme për veprat penale të vjedhjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë: të dënuar gjithsej për këto vepra, sa prej tyre u është shqiptuar një nga dënimet kryesore, dhe sa prej tyre u janë shqiptuar masa alternative, për vitin 2017.

Nga tabela e mësipërme vërejmë se për vjedhje të energjisë elektrike në vitin 2017 kemi gjithsej 627 të dënuar, nga këto ndaj 53 personave janë shiptuar dënime kryesore dhe ndaj 574 personave janë shqiptuar masa alternative. Për veprën penale vjedhje janë dënuar gjithsej 495 persona, ku ndaj 173 prej tyre janë shqiptuar dënime kryesore dhe ndaj 322 prej tyre janë shqiptuar masa alternative. Për veprën penale vjedhje e rëndë kemi gjithsej 699 të dënuar, ku ndaj 401 prej tyre është shqiptuar një nga dënimet kryesore dhe 298 prej tyre janë shqiptuar masat alternative. Për veprën penale grabitje kemi gjithsej 39 të dënuar ku ndaj 32 prej tyre janë shqiptuar dënime kryesore dhe 7 prej tyre janë shqiptuar masat alternative. Për veprën penale vjedhje grabitqare në vitin 2017 kemi gjithsej 8 të dënuar, ku 7 prej tyre u është shqiptuar dënim kryesor dhe ndaj njërit është shqiptuar masë alternative.

Sic e shohim ndër veprat penale të vjedhjes më e theksuara për vitin 2017 në RMV është vepra penale vjedhje e rëndë me gjithsej 699 të dënuar gjithashtu vërejmë se numri më i madh i dënimeve kryesore të shqiptuara për veprat penale të vjedhjes është për veprën penale vjedhje

e rëndë, me gjithsej 401 dënime kryesore. Për masat alternative vërejmë se më së shpeshti shqiptohen në raste të vjedhjes së energjisë elektrike, ku nga 627 të dënuar 574 prej tyre u është shqiptuar një nga masat alternative. Numri më i vogël i pjesmarjes tek veprat penale të vjedhjes vërejmë se është vepra penale vjedhje grabitqare me gjithsej 8 raste ku 7 prej tyre është shqiptuar dënimi me burg dhe ne 1 rast masë alternative.

Tabela nr. 12.

	2018		
	Të dënuar	Dënime kryesore	Masa alternative
Vjedhja e energjisë elektrike	536	36	500
Vjedhje	430	168	262
Vjedhja e rëndë	793	502	291
Grabitje	46	39	7
Vjedhje grabitqare	12	8	4

Në tabelën nr.12. gjithashtu kemi paraqitur statistika të përgjithshme për veprat penale të vjedhjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë të dënuar gjithsej për këto vepra, sa prej tyre u është shqiptuar një nga dënimet kryesore, dhe sa prej tyre u janë shqiptuar masa alternative, për vitin 2018.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se për veprën penale vjedhje e energjisë elektrike kemi gjithsej 536 të dënuar, ku ndaj 36 prej tyre është shqiptuar dënim kryesor, dhe ndaj 500 prej tyre janë shqiptuar masa alternative. Për veprën penale vjedhje kemi gjithsej 430 të dënuar, ku ndaj 168 prej tyre është shqiptuar dënim kryesor, dhe ndaj 262 prej tyre është shqiptuar masë alternative. Për veprën penale vjedhje e rëndë kemi gjithsej 793 të dënuar ku ndaj 502 prej tyre është shqiptuar dënim kryesor, dhe ndaj 291 prej tyre është shqiptuar masë alternative. Për veprën penale grabitje kemi gjithsej 46 të dënuar, ku ndaj 39 prej tyre është shqiptuar dënim kryesor, dhe ndaj 7 prej tyre masë alternative. Për veprën penale vjedhje grabitqare, kemi gjithsej 12 të dënuar, ku ndaj 8 prej tyre është shqiptuar dënimi kryesor, dhe ndaj 4 të tjerëve masë alternative.

Sic e shohim nga tabela numri më i madh i të dënuarve për vitin 2018 për veprat penale të vjedhjes në RMV, është regjistruar për veprën penale vjedhje e rëndë, me gjithsej 793 të dënuar, gjithashtu shohim se për këtë vepër kryesisht shqiptohen dënimet kryesore, ku janë

shqiptuar në 502 raste. Gjithashtu vërejmë se për vjedhje të energjisë elektrike kryesisht sqiptohen masa alternative, ku nga 536 të dënuar ndaj 500 prej tyre janë shqiptuar masat alternative. Numri më i vogël i rasteve është shënuar për veprën penale vjedhje grabitqare, ku janë regjistruar gjithsej 12 të dënuar ku ndaj 8 prej tyre është shqiptuar dënim kryesor, dhe ndaj 4 masë alternative. Në krahasim me vitin 2017 intesiteti i veprave penale të vjedhjes është pothuajse i njejtë, vepra penale më e shpeshtë në të dy vitet është vjedhja e rëndë , gjithashtu edhe numri më i madh i dënimeve kryesore është shqiptuar për këtë vepër në të dy vitet, numri më i madh i masave alternative është shqiptuar për veprën penale vjedhje e energjisë elektrike, në të dy vitet, dhe numri më i vogël i rasteve është regjistruar për veprën penale vjedhje grabitqare në të dy vitet.

Në vijim do të paraqitet një tabelë me statistikat në lidhje me shqiptimin e dënimeve kryesore për personat e ritur, për veprën penale vjedhje në RMV për vitet 2017-2018

Tabela nr.13.

Vjedhje	2017	2018
Të burgosur gjithsej	85	88
Burg i përjetshëm	-	-
Burg 20 vjet	-	-
Burg nga 10-15 vjet	1	-
Burg nga 5 -10 vjet	-	-
Burg nga 3-5 vjet	1	-
Burg nga 2-3 vjet	4	1
Burg nga 1-2 vjet	22	8
Burg nga 6 muaj deri në 1 vit	27	31
Burg deri në 6 muaj	30	48
Dënime me gjobë gjithsej	88	79
Gjobë deri në 5000 denarë	3	7
Gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë	3	1
Gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë	42	38
Gjobë mbi 30001 denarë	40	33

Në tabelën nr.13. i kam paraqitur statistikat në lidhje me shqiptimin e dënimeve kryesore për personat e ritur, për veprën penale vjedhje në RMV për vitet 2017-2018.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se në vitin 2017 për veprën penale vjedhje kemi gjithsej 85 të burgosur, nga këto ndaj 1 personi është shqiptuar dënim me burg nga 10 deri më 15 vjet, burgu nga 3 deri 5 vjet është shqiptuar gjithashtu ndaj 1 personi, në 4 raste është shqiptuar burgu nga 2 deri 3 vjet, në 22 raste është shqiptuar burgu nga 1 deri 2 vjet, dënim me burg nga 6 muaj deri në 1 vit është shqiptuar ndaj 27 personave, kurse dënimi me burg në kohëzjatje prej 6 muaj është shqiptuar ndaj 30 personave. Dënime me gjobë për vitin 2017 janë shqiptuar

gjithsej 88 dënime dhe atë: gjobë deri në 5000 denarë është shqiptuar në 3 raste, gjobë nga 5001 deri në 10000 denarë gjithashtu është shqiptuar ndaj 3 personave, ndaj 42 personave është shqiptuar dënimi me gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, dhe ndaj 40 personave është shqiptuar dënim me gjobë mbi 30001 denarë, burgim i përjetshëm, burgim me kohëzjatje prej 20 vitesh dhe burgim me kohëzjatje nga 5 deri me 10 vjet nuk është shqiptuar në asnjë rast gjatë vitit 2017 për veprën penale vjedhje. Sic e vërejmë nga tabela numri më i madh i dënimeve me burg të shqiptuar është dënimi me kohëzjatje deri në 6 muaj, kurse sa i përket dënimit me gjobë kemi më shumë gjopa të shqiptuara nga 10001 deri me 30.000 denarë. Sa i përket viti 2018 të burgosur gjithsej për veprën penale vjedhje kemi 88 persona në 1 rast është shqiptuar burgim me kohëzjatje nga 2 deri 3 vjet, ndaj 8 personave është shqiptuar burgim nga 1 deri në 2 vjet, në 31 raste është shqiptuar dënimi me burg nga 6 muaj deri në 1 vit, dhe ne 48 raste është shqiptuar dënimi me burg në kohëzjatje 6 muaj, burgim i përjetshëm, burgim me kohëzjatje 20 vjet burgim nga 10 deri më 15 vjet, burgim nga 5 deri më 10 vjet dhe burgim nga 3 deri më 5 vjet nuk është shqiptuar në asnjë rast për vitin 2018 për veprën penale vjedhje . Dënime me gjobë për vitin 2018 kemi gjithsej 79, gjobë dëri në 5000 denarë është shqiptuar ndaj 7 personave, gjobë nga nga 5001 deri më 10.000 denarë është shqiptuar në një rast, ndaj 38 personave është shqiptuar dënim me gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, kurse në 33 raste është shqiptuar dënim me gjobë mbi 30001 denarë. Gjithashtu vërejmë se edhe në vitin 2018 njejtë si në vitin 2017 numri më i madh i dënimeve me burg është burgimi në kohëzjatje prej 6 muaj, gjithashtu edhe për dënimet me gjobë njejtë si ne vitin 2017 numri më i madh i të dënuarve është me gjobë nga 10001 deri më 30,000 denarë.

Tabela nr.14.

Vjedhje e rëndë	2017	2018
Të burgosur gjithsej	368	466
Burg i përjetshëm	-	-
Burg 20 vjet	-	-
Burg nga 10-15 vjet	-	-
Burg nga 5 -10 vjet	4	2
Burg nga 3-5 vjet	27	12
Burg nga 2-3 vjet	53	30
Burg nga 1-2 vjet	118	118
Burg nga 6 muaj deri në 1 vit	102	169
Burg deri në 6 muaj	64	135
Dënime me gjobë gjithsej	31	29
Gjobë deri në 5000 denarë	2	1
Gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë	3	1
Gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë	4	22
Gjobë mbi 30001 denarë	22	5

Në tabelën nr.14. i kam paraqitur statistikat në lidhje me dënimet kryesore ndaj personave të rritur për veprën penale vjedhje e rëndë për vitet 2017-2018 në RMV.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se në vitin 2017 për veprën penale vjedhje e rëndë kemi gjithsej 368 të burgosur, ndaj 4 të dënuarve është shqiptuar dënim me burg në kohëzjatje nga 5 deri në 10 vjet, ndaj 27 të tjerëve është shqiptuar dënimi me burg me kohëzjatje nga 3 deri në 5 vjet, ndaj 53 personave është shqiptuar burg me kohëzjatje nga 2 deri në 3 vjet, ndaj 118 personave është shqiptuar burg nga 1 deri 2 vjet, në 102 raste është shqiptuar burg me kohëzjatjenga 6 muaj deri në 1 vit, dhe burgu deri në 6 muaj është shqiptuar ndaj 64 personave, burgu i përjetshëm, burg me kohëzjatje 20 vjet dhe burg me kohëzjatje nga 10 deri më 15 vjet nuk është shqiptuar në asnjë rast për vitin 2017 për veprën penale vjedhje e rëndë. dënime me gjobë kemi gjithsej 31 dënime, ku 2 prej tyre janë dënim me gjobë deri në 5000 denarë, ndaj 3 personave është shqiptuar gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë, në 4 raste është shqiptuar gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, në 22 raste është shqiptuar gjobë mbi 30001 denarë. Sic e vërejmë nga tabela, ndaj numrit më të madh të të dënuarve është shqiptuar dënimi me burg nga 1 deri 2 vjet me 118 të dënuar , kurse numri më i madh i gjobave është dënimi me gjobë mbi 30001 denarë.

Në vitin 2018 numri i përgjithshëm i të burgosurve është 466, ku prej tyre ndaj 2 personave është shqiptuar burg nga 5 deri në 10 vjet, ndaj 12 të tjerëve është shqiptuar burg nga 3 deri 5 vjet, ndaj 30 personave është shqiptuar burg nga 2 deri 3 vjet, ndaj 118 personave është shqiptuar burgim nga 1 deri në 2 vjet , ndaj 169 personave është shqiptuar burg nga 6 muaj deri në 1 vit dhe ndaj 135 personave është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzjatje prej 6 muajsh, , burgu i përjetshëm, burg me kohëzjatje 20 vjet dhe burg me kohëzjatje nga 10 deri më 15 vjet nuk është shqiptuar në asnjë rast në vitin 2018 për veprën penale vjedhje e rëndë. Dënime me gjobë për vitin 2018 për veprën penale vjedhje janë shqiptuar gjithsej 29 dënime, ku 22 prej tyre janë dënuar me gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, 5 prej tyre u është shqiptuar gjobë mbi 30001 denarë, ndaj 1 personit është shqiptuar gjobë deri në 5000 denarë dhe ndaj 1 tjetrit gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë. Sic e vërejmë nga tabela ndaj numrit më të madh të të dënuarve me burg për vitin 2018 është shqiptuar burg nga 6 muaj deri në 1 vit me 169 raste, 67 raste më shumë për dallim nga viti 2017, kurse sa i përket dënimit me gjobë në numrin më të madh të rasteve është shqiptuar gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë.

Tabela nr.15.

Vjedhje e energisë elektrike	2017	2018
Të burgosur gjithsej	10	6
Burg i përjetshëm	-	-
Burg 20 vjet	-	-
Burg nga 10-15 vjet	-	-
Burg nga 5 -10 vjet	-	-
Burg nga 3-5 vjet	-	-
Burg nga 2-3 vjet	-	-
Burg nga 1-2 vjet	2	-
Burg nga 6 muaj deri në 1 vit	1	-
Burg deri në 6 muaj	7	6
Dënime me gjobë gjithsej	38	19
Gjobë deri në 5000 denarë	6	1
Gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë	4	5
Gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë	25	12
Gjobë mbi 30001 denarë	3	1

Në tabelën nr.15. i kam paraqitur statistikat në lidhje me dënimet kryesore ndaj personave të rritur për veprën penale vjedhje e energjisë elektrike për vitet 2017 – 2018, në RMV.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se të burgosur gjithsej për vitin 2017 kemi 10 persona, 2 prej tyre u është shqiptuar dënimi me burg nga 1 deri 2 vjet, njërit i është shqiptuar burg me kohëzjatje nga 6 muaj deri në 1 vit, dhe ndaj 7 të tjerëve është shqiptuar burg me kohëzjatje 6 muaj, burg i përjetshëm, burg 20 vjet, burg nga 10-15 vjet, burg nga 5 -10 vjet, burg nga 3-5 vjet, burg nga 2-3 vjet nuk është shqiptuar ndaj asnjë personit për veprën penale vjedhje e energjisë elektrike për vitin 2017. Dënime me gjobë janë shqiptuar gjithsej 38, ku 6 me gjobë deri në 5000 denarë, 4 me gjobë nga 5001 deri më 10.000 denarë, 25 me gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, dhe 3 me gjobë mbi 30001 denarë. Numrit më të madh të të burgosurve ju është shqiptuar dënimi me burg deri në 6 muaj, kurse me gjobë ndaj numrit më të madh të të dënuarve është shqiptuar dënim me gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë.

Në vitin 2018 dënimi me burg është shqiptuar në 6 raste, ndaj të gjashtëve është shqiptuar dënim me burg me kohëzjatje deri në 6 muaj, nga dënimet tjera me burg nuk është shqiptuar asnjëri. Dënimi me gjobë është shqiptuar gjithsej në 19 raste, ndaj njërit është shqiptuar gjobë deri në 5000 denarë, ndaj 5 personave gjobë nga 5001 deri më 10.000 denarë, ndaj 12 të tjerëve gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë, dhe ndaj 1 personi gjobë mbi 30001 denarë. Për dallim nga viti 2017 kemi 4 raste më pak të dënimit me burg, dhe 20 raste më pak të

dënimit me gjobë, numri më i madh i të dënuarve është gjoba nga 10001 deri më 30.000 denarë.

Tabela nr .16.

Grabitje	2017	2018
Të burgosur gjithsej	32	39
Burg i përjetshëm	-	-
Burg 20 vjet	-	-
Burg nga 10-15 vjet	3	5
Burg nga 5 -10 vjet	7	5
Burg nga 3-5 vjet	9	10
Burg nga 2-3 vjet	7	3
Burg nga 1-2 vjet	1	5
Burg nga 6 muaj deri në 1 vit	4	7
Burg deri në 6 muaj	1	4
Dënime me gjobë gjithsej	-	-
Gjobë deri në 5000 denarë	-	-
Gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë	-	-
Gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë	-	-
Gjobë mbi 30001 denarë	-	-

Në tabelën nr.16. i kam paraqitur statistikat në lidhje me dënimet kryesore ndaj personave të rritur për veprën penale grabitje, për vitët 2017-2018, në RMV.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se në vitin 2017 kemi gjithsej 32 të burgosur për veprën penale grabitje, 3 prej tyre u është shqiptuar dënimi me burg nga 10 deri 15 vjet, ndaj 7 personave është shqiptuar burgu nga 5 deri 10 vjet, ndaj 9 të tjerëve është shqiptuar burgu nga 3 deri 5 vjet, ndaj 7 personave është shqiptuar burgu nga 2 deri 3 vjet, burgu nga 1 deri në 2 vjet është shqiptuar ndaj 1 personit, ndaj 4 të tjerëve është shqiptuar burg nga 6 muaj deri në 1 vit, burgu deri në 6 muaj është shqiptuar vetëm në 1 rast.

Në vitin 2018 për veprën penale grabitje janë burgosur gjithsej 39 persona, 5 prej tyre u është shqiptuar burgu nga 10 deri në 15 vjet, 5 të tjerëve burgu nga 5 deri 10 vjet, ndaj 10 personave është shqiptuar burgu nga 3 deri 5 vjet, ndaj 3 të tjerëve burgu nga 2 deri 3 vjet, burgu nga 1 deri 2 vjet është shqiptuar ndaj 5 personave, burg nga 6 muaj deri në 1 vit është shqiptuar në 7 raste, burg deri në 6 muaj është shqiptuar në 4 raste. Për dallim nga viti 2017 kemi 7 raste më shumë të dënimit me burg, dënimi me gjobë nuk është shqiptuar në asnjë rast për këto dy vite për shkak se për veprën penale grabitje kodi penal nuk parasheh dënim me gjobë.

Tabela nr. 17.

Vjedhje grabitqare	2017	2018
Të burgosur gjithsej	7	7
Burg i përjetshëm	-	-
Burg 20 vjet	-	-
Burg nga 10-15 vjet	1	1
Burg nga 5 -10 vjet	3	-
Burg nga 3-5 vjet	2	2
Burg nga 2-3 vjet	-	-
Burg nga 1-2 vjet	-	1
Burg nga 6 muaj deri në 1 vit	-	1
Burg deri në 6 muaj	1	2
Dënime me gjobë gjithsej	-	-
Gjobë deri në 5000 denarë	-	-
Gjobë nga 5001 deri me 10.000 denarë	-	-
Gjobë nga 10001 deri më 30.000 denarë	-	-
Gjobë mbi 30001 denarë	-	-

Në tabelën nr.17. i kam paraqitur statistikat në lidhje me dënimet kryesore ndaj personave të rritur për veprën penale vjedhje grabitqare , për vitët 2017-2018, në RMV.

Nga tabela e mësipërme do të vërejmë se në vitin 2017 për veprën penale vjedhje grabitqare janë burgosur 7 persona, ku ndaj 3 prej tyre është shqiptuar dënimi me burg me kohëzgjatje 5 deri 10 vjet, ndaj 2 te tjerëve burgu nga 3 deri 5 vjet, ndaj 1 personit burgu nga 10 deri 15 vjet, dhe ndaj 1 personi burgu deri në 6 muaj.

Në vitin 2018 gjithashtu dënimi me burg është shqiptuar në 7 raste, në 1 rast është shqiptuar burg nga 10 deri 15 vjet, në 2 raste burg nga 3 deri 5 vjet, në 1 rast burg nga 1 deri 2 vjet, më 1 rast burg nga 6 muaj deri në 1 vit dhe burgui deri në 6 muaj është shqiptuar në 2 raste. Sic e vërejmë nga tabela për të dy vitet nuk ka asnjë dënim me gjobë të shqiptuar për shkak se për veprën penale vjedhje grabitqare kodi penal i RMV nuk e parasheh dënimin me gjobë.

PËRFUNDIM

Në këtë punim shkencor është studiuar për një çështje konkrete e njohur dhe shumë e përhapur për opinionin sic është vepra penale e vjedhjes, është bërë një sqarim se cka janë krimet kundër pasurisë, është sqaruar objekti mbrojtës, figura ligjore, teoritë për kryerjen e veprave penale të vjedhjes, gjithashtu është bërë një analizë në lidhje me aspektet krahasimore me vendet fqinje janë analizuar karakteristikat dhe vecorit kryesore të veprave penale të vjedhjes në përgjithësi, dhe në rajonin e Dibrës në vecanti.

Ndër synimet kryesore të këtij punimi ka qenë studimi i shkaqeve dhe faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e veprave penale të vjedhjes, nga të dhënat statistikore për veprat penale të vjedhjes në Dibër vërejmë se nga viti në vit nuk kemi ulje të rasteve të vjedhjes, gjë që unë e shoh tepër shqetësuese pasi pasojat tek viktimat që kanë pësuar nga vepra penale e vjedhjes janë të rrënda.

Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave penale të vjedhjes janë të shumtë, që i kam trajtuar në këtë punim, në mesin e tyre bën pjesë edhe papunësia, e cila është në një nivel shumë të lartë në RMV dhe në qytetin e Dibrës në vecanti, dhe paraqitet si një ndër faktorët më të zëshëm në paraqitjen e veprave penale të vjedhjes, Prandaj, institucionet shtetërore duhet të jenë të alarmuara nga faktet në terren, me qëllim që të ndërmarrin masa të përkatëse me të cilat do të ulen niveli i papunësisë, pasi shumë persona në Dibër jetojnë në varfëri të skajshme, pa pasur mundësi të tjera të inkuadrohen në grupe të ndryshme, si pasojë e kësaj detyrohen të kryejnë veprat penale të vjedhjes për ti kënaqur apo për ti plotësuar nevojat apo kënaqësitë e veta.

Në luftën kundër veprave penale të vjedhjes duhet të inkuadrohen të gjitha institucionet, organizatat joqeveritare, mjetet e informimit, shkolla familja e sidomos e policia, gjykata, prokuroria, që i kam trajtuar në kapitullin e fundit të këtij punimi si faktorë kyc për parandalimin e kryerjes së kërtre veprave penale.

Normalisht që ka mangësi në të gjitha institucionet sa i përket parandalimit të vjedhjeve por vërejtja ime më e madhe është për policinë, pasi nga hulumtimet e bëra rezulton se në qytetin e Dibrës përgaditja profesionale e policëve që mbykqyrin dhe patrollojnë terrenin për të vepruar me urgjenca është e ulët, dhe gjithashtu mungon organizimi i veprimeve operative të karakterit represiv, dhe kjo shfryëzohet nga vjedhësit. Për mendimin tim efikasiteti i dobët i punës së policëve është nepotizmi dhe korrupsioni në përzgjedhjen e kandidatëve për policë pasi që nuk respektohen kriteret dhe kushtet ligjore për seleksionim.

LITERATURA

I - Libra

- Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.
- Ismail Zejneli E DREJTA PENALE- PJESA E POSAÇME, Tetovë, 2007.
- Ismet Elezi E drejta Zakonore Penale Shqiptare.
- Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.
- Ejup Sahiti&Ismail Zejneli, “ E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Kosovës” Prishtinë, 2017.
- Ismet Salihu E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009.
- Vllado Kambovski – Ismail Zejneli E drejta Penale pjesa e përgjithshme Tetovë 2018.
- E drejta penale e përgjithshme. Prof, Ismet Salihu, botimi i katërt 2010, Prishtinë.
- E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982.
- Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli E drejta e Procedurës penale e Republikës së Maqedonisë Shkup 2017.
- Vesel Latifi, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011.
- Vesel Latifi Kriminalistika Prishtinë 2011.
- G.Kaiser.
- L.Glick.
- M.Singer.

II - Burime Tjera

- <https://ëëë.kultplus.com/tag/kanuni-i-leke-dukagjinit/>
- https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.ëordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf.
- <https://ëëë.kultplus.com/tag/kanuni-i-leke-dukagjinit/>
- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë botim i qendrës së botimeve zyrtare Tiranë Gusht 2017.
- Afrim Osmani – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime botimi i dytë - Furkan 2015.
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË 1 KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.
- Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Organizata_loqeveritare
- Neni 73 dhe 74 i Ligjit për shoqata dhe fondacione i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Ligji për Policinë i Republikës së Maqedonisë së Veriut neni 3
- <https://vdocuments.site/mirsad-abazoviq-politika-e-luftimit-te-kriminalitetit.html>
- Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë së Veriut neni 30.